



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 31 TETOR, 4 NËNTOR DHE 5 DHJETOR 2024**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 31. OKTOBRA, 4. NOVEMBRA I 5. DECEMBRA 2024. GODINE**

**TETOR/NËNTOR/ DHJETOR - OKTOBAR/NOVEMBAR/ DECEMBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për zëvendësimin e deputetëve në komisione parlamentare,
4. Propozim-Vendimi për hartimin e Nismës legislative të qytetarëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-295 për krypto-asetet,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues,
8. Shqyrtimi i propozimit të gjashtë (6) deputetëve nga GP të PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
9. Zgjedhja e tre (3) drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut,
10. Emërimi i anëtarit në Këshillin Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga radhët e studentëve,
11. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-317 për aderim në “Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështje civile apo tregtare”,
12. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-318 për aderim në “Konventën për marrjen e provave jashtë vendit në çështje civile apo tregtare”,
13. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-319 për aderim në “Konventën për zgjedhjen e marrëveshjeve gjyqësore”,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-312 për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-315 për banim social dhe të përbalueshëm,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-316 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
20. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur,
21. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-034,

22. Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,
23. Shqyrtimi i Propozimit të shtatë (7) deputetëve nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë për shkarkimin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bahrim Shabani,
24. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023,
25. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023,
26. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2023,
27. Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar për procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për nxënësit e nivelit të Arsimit fillor dhe Arsimit të Mesëm të Ulët për vitin shkollor 2023/2024 për periudhën kohore prej 4 korrik 2024 deri në përfundim të mandatit të tij.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Predlog PG Vetevendosje o zameni poslanika u parlamentarnim skupštinskim komisijama,
4. Predlog-Odluke za izradu Građanske zakonodavne inicijative od strane Vlade Republike Kosovo,
5. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-288 o zaštiti potrošača,
6. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-295 o kriptovaluti,
7. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-265 o registru stvarnih vlasnika,
8. Razmatranje predloga šest (6) poslanika PG PDK za razrešenje članova Borda Radiotelevizije Kosova,
9. Izbor tri (3) direktora Borda operatora sistema, prenosa i tržišta javnog preduzeća, transmisije i tržišta,
10. Imenovanje člana Državnog saveta za kvalitet Kosovske agencije za akreditaciju, iz reda studenata,
11. Razmatranje N/zakona br. 08/L-317 o pristupanju “Konvenciji o priznavanju i izvršenju stranih presuda u građanskim ili privrednim pitanjima”,
12. Razmatranje N/zakona br. 08/L-318 o pristupanju “Konvenciji o izvođenju dokaza u inostranstvu u građanskim ili privrednim pitanjima”,
13. Razmatranje N/zakona br. 08/L-319 o pristupanju “Konvenciji o rešavanju sudskih sporova”,
14. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-312 o zabrani upotrebe energetske piće za lica ispod osamnaest (18) godina,
15. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-315 o socijalno-pristupačnom stanovanju,

16. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-320 o obaveznom zdravstvenom osiguranju,
17. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-322 o Državnom Birou za proveru i oduzimanje neopravdane imovine,
18. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-316 o izmenama i dopunama Zakona br. 08/L-036 o slanju van zemlje Kosovskih bezbednosnih snaga,
19. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-321 o izmeni i dopuni Zakona br. 06/L-032 o računovodstvu, finansijskom izveštavanju i reviziji,
20. Razmatranje izveštaja sa preporukama o nadzoru nad sprovođenjem Zakonika br. 06/L-006 o pravosuđu za maloletnike,
21. Razmatranje izveštaja sa preporukama o nadzoru nad sprovođenjem Zakona br. 05/L-049 o upravljanju zaplanjene i konfiskovane imovine, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 08/L-034,
22. Osnivanje ad hoc komisije za izbor kandidata za člana Odbora Radiotelevizije Kosova, iz albanske zajednice,
23. Razmatranje predloga sedam (7) poslanika iz reda ne većinske zajednice za razrešenje potpredsednika Skupštine Republike Kosovo Bahrin Šabani,
24. Razmatranje Godišnjeg finansijskog izveštaja budžeta Republike Kosovo za 2023. godinu,
25. Razmatranje godišnjeg izveštaja o radu Nacionalne kancelarije za reviziju za 2023. godinu.
26. Razmatranje godišnjeg izveštaja Kosovskog penzijskog fonda štednje za 2023. godinu,
27. Usvajanje budžeta Parlamentarne anketne komisije za postupak subvencionisanja nabavke udžbenika i nastavnih sredstava za učenike na nivou osnovnog i nižeg srednjeg obrazovanja za školsku 2023/2024. godinu, za period od 4. 7. 2024. g. do kraja mandata.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Po e fillojmë seancën, uluni nëpër vendet tuaja!

Përgatituni për votim! Votojmë për prani. 58 të pranishëm me votim, disa s'kanë votuar, kështu që mund ta fillojmë seancën, besoj.

Po, po, se mbi 61 jemi të pranishëm këtu. Jo, sa i përket fillimit të seancave s'duhet kushtëzuar në këtë mënyrë. Tjetër gjë është votimi i ligjeve, tjetër, a po doni të flitni grupet parlamentare?

Vetë ma kërkuat deklarinimin jashtë rendit të ditës në Kryesi.

Urdhëro, zoti Tahiri!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Kjo është praktikë, të cilën ju e keni filluar prej instalimit pas tre vjetësh të teknikës së votimit dhe fillimin e seancës, kuorumin e keni përcaktuar me votim.

KRYETARI: Jo, unë mendoj që seanca duhet të fillojë me prani fizike, sa është prania fizike e deputetëve.

ABELARD TAHIRI: Sot mund ta fillosh edhe në një formë tjetër, mirëpo deri sot kuorumin e keni përcaktuar pikërisht në formën e votimit qysh e kemi bërë edhe tani, e që nuk jeni 61 të pranishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Neni 54, zoti Tahiri, i Rregullores thotë: "Kryesuesi i seancës e hap seancën kur janë të pranishëm shumica e deputetëve të Kuvendit", për fizikisht e ka fjalën. Jo, jo, s'kemi bërë gabim.

Dëgjo, nuk është e mundur të jenë 78 deputetë në sallë, e të mos mund të fillojë seanca. Ky është gabim, çfarë interpretimi është ky i Rregullores. A po doni të flitni? Po s'e kam bërë unë atë, çka është ky interpretim i Rregullores kështu. Kjo është hajgare.

Dëgjo, a ka për të folur grupi i mazhorancës, a doni të flitni?

Deklarimet jashtë rendit të ditës, jemi në pikën e deklarimeve jashtë rendit të ditës, ju lutem!

Kush ka për të folur prej juve? Mirë! Po ju pyes, ja e njëjta është për procesverbale.

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Ju pyes, nëse nuk keni vërejtje, ato miratohen. Miratohen, unë e marr të mirëqenë praninë tuaj fizike këtu, dhe miratohet procesverbali. Nuk keni vërejtje në procesverbal, miratohet procesverbali.

2. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Tash fillojmë, deklaratimet jashtë rendit të ditës, nuk mund t'i bllokoni deklaratimet jashtë rendit të ditës, aq më tepër që m'i keni kërkuar vetë në mbledhje të Kryesisë. Fjolla Ujkani flet prej mazhorancës, e pastaj grupet parlamentare me rend.

FJOLLA UJKANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Një nga përfitimet direkte e të qenët në proces të integritimit në Bashkimin Evropian është edhe pasqyrimi i punës që na bëhet nga Bashkimi Evropian, në secilën fushë e për çdo vit.

Kjo në fakt e lehtëson shumë punën tonë, sepse e shohim progresin, mirëpo edhe vonesat, e edhe ngecjet. Gjatë tre vjetëve të fundit, raportet e Komisionit Evropian kanë theksuar arritje të rëndësishme legjislative të Kosovës në kriteret politike dhe progresin e saj në përmbushjen e standardeve ekonomike dhe të Bashkimit Evropian.

Në agjendën e integritimit evropian, Qeveria jonë është vlerësuar pozitivisht për zbatimin e agjendës për reforma evropiane ERA2, duke arritur mbi 70% zbatueshmëri. Gjithashtu, programi kombëtar për integrimin evropian, i fokusuar në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ka pasur një normë vjetore të zbatimit që kalon 60%.

Komisioni Evropian ka theksuar se Kosova ka arritur dukshëm kapacitetet e saj koordinuese dhe implementuese sa i përket agjendës së integritimit në BE. Në tre vjetët e fundit ne kemi trajtuar me sukses reforma të shumta, të vonuara prej kohësh në lidhje me reformat e acquis të BE-së, të cilat ishin rekomanduar në mënyrë të përsëritur nga BE-ja, që nga viti 2012. Ky raport evidenton përparimin e Kosovës në fusha të rëndësishme, që përfshijnë reformat institucionale, sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe integrimin rajonal.

Pasi të kemi përmbledhur këtë raport, shohim se nuk ka fusha të vlerësuara me regres si në vitet e kaluara. Në shumë fusha ne kemi kaluar një hap më lart në shkallët e progresit, siç janë lufta kundër korrupsionit, reforma e Administratës Publike, politikat ekonomike dhe monetare,

funksionimi i ekonomisë së tregut, arsimi e kultura, politika sociale dhe punësimi, politika e transportit, e plot të tjera.

Një nga arritjet më domethënëse të këtij viti është pa dyshim dhe shumë meritueshëm lëvizja pa viza, e cila tani lejon qytetarët tanë të udhëtojnë lirshëm në vendet e Bashkimit Evropian, që nga janari i këtij viti. Kjo përbën një hap historik për Kosovën drejt integritetit të plotë dhe tregon përkushtimin tonë të palëkundur ndaj standardeve evropiane.

Sa i përket politikës së jashtme, përveç në vetë raportin, edhe në deklaratën e përfaqësuesit të lartë të BE-së, zotit Borell, Kosova lavdërohet për rreshtimin e saj të pazezervë krah politikave të BE-së në raport me luftën e Rusisë në Ukrainë, duke vënë sanksione ndaj Rusisë dhe duke strehuar refugjatë nga Ukraina.

Po ashtu, raporti vlerëson reformat tona në Administratën Publike për transparencë dhe efikasitet. Angazhimi për rritjen e pjesëmarrjes së grave në nivelin lokal, përmes analizave sektoriale dhe kuadrit të buxhetit në përfshirje gjinore, është një shembull i përkushtimit të institucioneve tona për të rritur barazinë dhe për të forcuar demokracinë.

Te sundimi i ligjit në rrugëtimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian, luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar duhen të jenë fusha kyçe ku vlerësohemi për maturitetin evropian. Kemi reduktuar ndjeshëm mbipopullimin e rasteve në gjykata dhe kemi arritur rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë.

Në fushën e zhvillimit ekonomik, raporti thekson qëndrueshmërinë e tregut tonë dhe progresin e përmirësimit të mjedisit të biznesit.

Përkundër sfidave, Kosova vazhdon të ketë rritje ekonomike dhe reforma për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat, rininë dhe të ardhmen e gjeneratave të reja, po japin rezultate të prekshme.

Përfshirja jonë në programin “Evropa Digjitale” është një tjetër arritje, e cila do të nxisë tranzicionin tonë digjital dhe do të përmirësojë qasjen e qytetarëve dhe bizneseve në teknologji.

Së fundmi, raporti vlerëson përpjekjet tona për të adresuar çështjet e ambientit dhe agjendën e gjelbër përmes përparimit në burimet e ripërtëritshme dhe eficiencën e energjisë.

Procesi i anëtarësimit në BE duhet të bazohet në meritokraci, por ne nuk mund të diskutojmë për meritokraci të vërtetë derisa Kosova të vlerësohet zyrtarisht në bazë të kriterëve të Kopenhagës.

Kosova është e vendosur për të ndërtuar një të ardhme evropiane dhe si model i demokracisë në rajon meriton shansin për ta dëshmuar veten.

Ne kemi ndërmarrë hapa të nevojshëm duke shprehur interesin tonë dhe duke paraqitur kërkesën tonë për anëtarësim në BE.

Ne i bëjmë thirrje Këshillit të BE-së që të udhëzojë Komisionin Evropian dhe të vlerësojë gatishmërinë tonë për statusin e kandidatit...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Boqujevc)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoi ta përfundojë fjalën!

FJOLLA UJKANI: Progresi ynë në reforma të brendshme, sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, zhvillimi ekonomik dhe social, liberalizimi i vizave dhe bashkëpunimi rajonal tregon punën tonë të palodhur dhe përkushtimin për të avancuar drejt integrimit evropian.

Heqja e masave ndëshkuese të vendosura nga BE-ja do të ringjallte motivimin tonë dhe do të përshpejtonte më tej reformat tona. Përkushtimi i Kosovës do të forcohet edhe më shumë pasi të arrijë statusin e vendit kandidat, duke e bërë rrugën tonë drejt BE-së më të qartë dhe më të prekshme. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, është Floretë Zejnullahu.

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot jam këtu për të folur për një krizë të madhe që ka rënduar dhe po rëndon mbi gjysmën e Prishtinës. Tashmë prej tri javësh kryeqyteti po përballet me mungesë të ujit të pijshëm për shkak të pranisë së manganit në ujin e Liqenit të Badocit.

Qindra e mijëra qytetarë janë detyruar të blejnë ujë për pije dhe për ushqim çdo ditë dhe këta qytetarë më mirë se gjithkush tjetër po e ndien rëndesën e një keqqeverisjeje dhe dështimeve të kësaj qeverie, e mosveprimin e tyre. Kjo situatë alarmante është pasojë e një neglizhence të qëllimshme, një paafësie, e cila është bërë normë në këtë qeveri që po luan me shëndetin dhe me jetën e qytetarëve të saj. A e keni dëgjuar ndonjë zyrtarë të kësaj Qeverie duke u deklaruar për këtë situatë të rëndë? Natyrisht që jo! Përderisa qytetarët po vuajnë, ata që janë në pushtet

heshtin, sepse në këtë çështje nuk kanë mundësi për përfitime personale, e të paligjshme. Përkundrazi, kur vjen puna te kompanitë private të ambalazhimit të ujit, kur janë miliona euro në pyetje, atëherë Qeveria e Vetëvendosje e Albin Kurti janë prezent kudo.

Me vetëm një vendim korruptiv, Qeveria ua fali mbi 11 milionë euro borxhe këtyre kompanive, duke i pasuruar ata në kurriz të taksapaguesve dhe duke e dëmtuar buxhetin e shtetit të Kosovës. Dhe, tani, qytetarët e lënë pas dore duhet të blejnë ujë pikërisht nga këto kompani, të cilat janë privilegjuar nga ky pushtet. Liqeni i Badocit, i ndotur nga mangani, një ndotës serioz, jashtë normave të lejuara në ujin e pijshëm, po rrezikon shëndetin e qytetarëve. Ky ujë nuk mund të përdoret as për pije, as për ushqim, sepse ekspozimi ndaj tij për një kohë të gjatë mund të shkaktojë probleme shëndetësore.

Në vend që Qeveria të veprojë, të marrë masa parandaluese dhe sanuese të këtij problemi, ajo vazhdon të qëndrojë e heshtur dhe pasive. Ndërkohë që njerëzit vuajnë dhe përballen me rrezikun e ndotjes së ujit, Qeveria nuk ndërmerr asnjë hap të vetëm konkret për pastrimin e Ligjit të Badocit, apo për krijimin e alternativave të tjera për furnizim me ujë të pijshëm për qytetarët e Prishtinës.

Sipas Ligjit për ujërat, kryeministri është kryetar i Këshillit Ndërmnistror për Ujëra dhe si rrjedhojë ai është i detyruar që të vijë në Kuvend dhe të raportojë për këtë situatë. Por, deri më tani nuk kemi pa asnjë lëvizje nga ai, asnjë përgjegjësi të marrë për këtë krizë. E vërteta është e thjeshtë, kjo Qeveri nuk ka interes për qytetarët, por vetëm për përfitime të paligjshme dhe afëra korruptive. Ja veç një fakt për ta përshkruar këtë Qeveri:

Të dashur qytetarë,

Albin Kurti dhe Qeveria e tij kanë shpenzuar mbi 35 milionë euro vetëm për derivate, për xhipat e tij të zinj, ndërkohë që injorojnë krizën e ujit, Qeveria Kurti shpërndanë miliona euro për interesa private, tenderë të dyshimtë dhe miliona euro kontrata njëburimore.

Qeveria e Albin Kurtit është kthyer në një rrjet të kriminalizuar që vetëm pasuron veten dhe njerëzit e afërt, duke e shkatërruar të ardhmen e Kosovës. Ky njeri dhe Qeveria e tij po përvetësojnë miliona euro përmes kontratave të dyshimta. Albin Kurti dhe Qeveria e tij kanë dhënë mbi 275 milionë euro në kontrata njëburimore, para të qytetarëve të Kosovës, që përfundojnë në xhepat e të privilegjuarve.

Përmes tenderëve të errët dhe në dëm të ligjshmërisë, Kurti ka krijuar një sistem të ngritur mbi hajni dhe përfitime personale. Kryemashtruesi Albin Kurti i dha mundësi një hajni tjetër si Naser Hafizi me një pagë prej vetëm 732 euro, të blejë katër banesa për një periudhë mjaft të shkurtër kohore. I njëjti me po atë pagë ka depozituar mbi njëqind mijë euro në bankë. Kjo është vetëm

një nga skandalet që ilustron se ky shtet është i kapur dhe është kthyer në një makineri për përfitime personale.

Nga ana tjetër, përmes Martin Berishajt, Vetëvendosje i tërhoqi mbi një milion euro nga GEN Serbia, duke ndërtuar një rrjet të errët kriminal, që vepron në fshehtësi dhe pa transparencë, ndërsa thyen çdo normë ligjore dhe kushtetuese të këtij vendi.

Kjo Qeveri ka vjedhur edhe në rezerva shtetërore. Lista vazhdon. Mishërimi i këtij rrjeti kriminal që ka degraduar çdo standard të qeverisjes, duke shkelur Kushtetutën dhe ligjet është veç Dejona Mihali.

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi dëshmitarë të një shteti të kapur dhe një Qeverie që mbron hajninë dhe përndjek opozitën dhe mediat.

Prandaj, qytetarë të dashur, është koha që të veprojmë dhe të mos lejojmë që kjo keqqeverisje ta shkatërrojë edhe më tutje të ardhmen e Kosovës.

KRYESUESJA: Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës është Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Kur e dëgjoja fjalimin e përfaqësues së grupit më të madh politik në Kuvend për Raportin e Progresit, thashë mos e kanë ndryshuar me inteligjencë artificiale, sepse unë e kam lexuar një dokument tjetër dhe të dhënat që janë aty janë më shumë se shqetësuese. Njëra nga to që përmendet më së shumti dhe unë kam përshtypjen që në raportet e kaluara nuk ka qenë, është centralizim te pushteti ekzekutiv, pothuajse të të gjitha temave dhe çështjeve. Po ashtu, edhe te reforma në gjyqësor dhe çka është më e dëmshme, te cenimi i lirisë së shprehjes.

Po i veçoj veç e veç dhe besoj që do ta kuptoni saktë edhe përgjigjen se ku jemi si shtet.

Te institucionet demokratike, flet për Kuvendin e Kosovës. thotë: Kuvendi ka hasur në vështirësi në arritjen e kuorumit për vendimmarrje, gjë që ka vonuar legjislacionin dhe funksionet e tjera kyçe. Mosmarrëveshjet politike, mungesa e bashkëpunimit me opozitën, kanë penguar progresin dhe reformat e lidhura me BE-në. Niveli i lartë i vendimmarrjes të centralizuara në ekzekutiv ka dobësuar përfshirjen demokratike dhe rolin e ministrive përkatëse, duke kufizuar shumëllojshmërinë e perspektivave politike në vendimet kyçe.

Kur flet për administratën publike: dobësitë e administratës mbeten të shumta, përkeqësim si pasojë e strukturave të paqarta të llogaridhënies dhe përparim i kufizuar në zbatimin e praktikave

të rekrutimit mbi bazën e meritës, numri i lartë i vendeve vakante ose të përkohshme me ushtrues detyre në pozitat kyçe kontribuon në një mjedis të paqëndrueshëm administrativ.

Kur flet për sundimin e ligjit dhe vështirësitë në gjyqësor: reforma në gjyqësor është penguar nga ndryshimet legjislativë të nxituara dhe pa konsultime të plota. Madje, shkon edhe më larg, ku thotë se: nuk janë marrë parasysh fare rekomandimet e Komisionit të Venedikut, edhe në rastet konkrete siç ishte me Ligjin për Këshillin Prokurorial. Po ashtu nuk janë marrë parasysh as parimet themelore me standardet evropiane. Kur flet për tregun e brendshëm, flet që progresi i kufizuar në fushën e prokurimit publik dhe pavarësisë rregullatore, e ka lënë Kosovën të ndjeshme ndaj parregullsive. Qeveria nuk e ka operacionalizuar plotësisht trupën shqyrtuese të prokurimit, duke e lënë prokurimin publik të hapur ndaj korrupsionit.

Te liria e shprehjes, që kam përshtypjen që kemi marrë goditjen më të madhe që ndonjëherë e kemi pasur, thotë kështu: Kosova edhe pse ka një mjedis pluralist, ndikimi i Qeverisë mbetet shqetësues. Edhe pse rregullimin e mediave thotë e miratuan, por Kuvendi injoroi tërësisht rekomandimet nga BE-ja dhe partnerët ndërkombëtarë, duke aprovuar ligje që mund të kufizojnë pavarësinë e tyre.

Për transmetuesin publik thotë: transmetuesi publik i Kosovës po përballët me paqëndrueshmëri të madhe, me dorëheqjet e fundit të menaxhmentit të lartë dhe anëtarëve të bordit, pavarësia editoriale është komprometuar aq shumë dhe shqetësimet për mungesën e mbrojtjes nga presioni qeveritar vazhdojnë fuqishëm.

Kur flet për transparencën, vetëqëndrueshmërinë financiare të media, thotë: qëndrueshmëria financiare e sektorit të medias është shumë e brishtë, në mungesë të dhënave mbi pronësinë dhe financimin e mediave, sulmet ndaj gazetarëve, marrin vëmendje të pamjaftueshme nga Policia dhe gjyqësori, duke nxitur një klimë të vetëcensurimit dhe duke penguar lirinë e shprehjes.

Qeveria ka dështuar në zbatimin e rekomandimeve të BE-së për të forcuar mbrojtjen e gazetarëve, përfshirë protokollet e sigurisë, mekanizmat e reagimit të shpejtë dhe përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët.

Ndryshimet ligjore mbi Komisionin e Pavarur të Mediave nuk janë në përputhje me standardet e BE-së, duke e kufizuar këtë pavarësi. Përparimi i Kosovës në lirinë e mediave dhe shprehjes mbetet i kufizuar nga ndërhyrjet e mëdha qeveritare, mangësitë ligjore dhe një mjedis kufizues për gazetarët.

Progresi i Kosovës drejt anëtarësimit në BE pengohet nga paqëndrueshmëria politike dhe centralizimi i plotë i pushtetit në ekzekutiv dhe boshllëqet kritike në qeverisje. Veçanërisht,

peizazhi mediatik dhe liria e shprehjes në Kosovë janë të kufizuara nga mungesa e mbrojtjes nga Qeveria, ndërkohë që pavarësia e transmetuesit publik mbetet nën kërcënim serioz.

Mangësitë në reformat ligjore në gjyqësor, prokurim publik, administratë shtetërore dhe luftën antikorruption, menaxhim mjedisor dhe zhvillim rural, tregojnë se Kosovës i duhen reforma gjithëpërfshirëse për një rrugë të qëndrueshme drejt anëtarësimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto janë të dhëna dhe nëse i shtojmë këto të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit fliste për kërcënim serioz në Qeveri, ndërkohë që Komisioni Evropian flet për centralizim të pushtetit, atëherë kjo përkethehet që Kosova, të vetmen rrugë që e ka zgjedhur dhe kjo Qeveri është izolimi, autoritarizmi dhe përpjekja për fundin e demokracisë. Po, kjo normalisht që nuk do të lejohet dhe kjo Qeveri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni që ta përfundojë fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesuese!

Po jam i bindur që kjo nuk do të ndodhë dhe kjo logjikë qeverisjeje, e tillë çfarë ka qenë për katër vjet, do të marrë fund më 9 shkurt. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Fjalën e ka Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: E nderuar kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Media,

Gjithë të pranishëm,

Kaluan katër vjet dhe mund të numërohen të gjitha ato që Qeveria e Kosovës nuk ia ka përmbushur premtimet për qytetarët. Më shqetësuese është sot që rrugët e Kosovës janë bërë rrugë të vdekjes. Po e marrim rrugën për Gjilan. Nuk di sesi dhe çka thotë ministri Liburn Aliu, zv.ministri Durmishi dhe si mund të dalin edhe të krenohen për punën e tyre, kur rrugët tona po marrin jetë. Nuk ka sinjalizim, nuk ka përfundim të asaj rruge dhe është mjerim i punës së Ministrisë përkatëse.

Po e marrim rrugën Dollc-Gjakovë. Më besoni, janë gjashtë-shtatë deputetë që vijnë nga Gjakova. Si ka mund kjo Ministri t'i lë qytetarët e Gjakovës në atë gjendje? Më besoni që pas një muaj që e kanë bërë shtresën e parë, shkoni e shiheni, ta vizitojmë në çfarë gjendje të

mjerueshme e kanë lënë. Më besoni, që do më vinte turp të vijë para deputetëve dhe të rri ministër e t'i lë rrugët në atë gjendje.

Merreni rrugën, sa i përket fillimit a zgjerimit të rrugës për Pejë. Është katastrofë. E kanë ndryshuar trasenë dhe më shtrenjtë po u del zgjerimi i rrugës, dhe tani projekti është ndalur. Pse është ndalur? Sepse, nuk i kanë bërë llogaritë si duhet.

Me çka kjo Ministri duhet të krenohet? Po, për mospunë, po. Edhe atë, po të madhe.

Merreni rrugën për Podujevë. Nuk ka ditë që nuk ka ndeshje, aksidente. Lëre çka kanë bërë, ia kanë hequr edhe dy shiritat, për ta kryer gjoja në afat, por as sot e kësaj dite nuk e kanë bërë.

Merreni rrugën për Mitrovicë. E dinë qytetarët e asaj ane, që duhet diku dy orë vozitje për të shkuar në Mitrovicë. Sa herë kanë premtuar këtu?

Me çka kjo Qeveri duhet të krenohet sot? Po i marrim premtimet. Ku janë 160 çerdhe? Dyzet çerdhe i keni ndërtuar.

Me çka Ministria e Arsimit duhet të krenohet? Çka bën tash kah fundi, i shpall tenderët njëburimorë, thuaja se nuk kemi ne firma tenderuese. A nuk është mjerim kjo.

Ku janë katër mijë banesa për çifte që martohen? Sa i keni ndërtuar? Ku janë katër shtëpi për pleq? Sa i keni ndërtuar? Ku janë sigurimet shëndetësore? Sot vuajnë pacientët për një analgjetik. Këtu nga ministria ka dalë që lista esenciale është e përmbushur qind për qind. As pesëdhjetë, as dyzet për qind. As analgjetik nuk kanë, t'u shkojë një pacient, lëre më të mos flasim për terapi të tjera.

Ku është siguri për policët? Mund të them që pas katër vitesh, kjo Qeveri do të kujtohet për mospunë, për mashtrim e sidomos për ata që na ka larguar edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën!

PAL LEKAJ: Dhe me veprimet e tyre e ka ofruar shumë më tepër, e ka bërë më miqësore Serbinë për faktorin ndërkombëtar dhe ne të kemi sanksione nga veprimet e tyre.

Sot, mund të krenohen edhe të dalin e të thonë, ne në Raportin e Progresit kemi përparime. Por, jeni mashtruar kështu dhe kështu do të vazhdoni, por ju kanë mbetur edhe dy muaj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Haki Abazi.

HAKI ABAZI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë të nderuar,

Të nderuar media,

Mendoj që vetë fakti se shtrohet një prej çështjeve kryesore të përcaktimit politik e orientimit tonë në këtë formë dhe jo nëpërmjet seriozitetit të diskutimit parlamentar, tregon faktin që këtu është në garë se qysh duhet të lexohet raporti për ta rrejtur popullin, si në çdo aspekt tjetër të progresit të paqenë e joekzistent të katërvjeçarit të qeverisjes.

Në fakt, ky raport është vetëm si të them një provokim i mendjes së manipulimit të mëtutjeshëm të qytetarit. Përndryshe, realiteti është shumë më i keq sesa Raporti se çka flet aty. Cilindo sektor, hajde nisim prej raportit të marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës. Vendi kurrë nuk ka qenë më i izoluar. Fatmirësisht që gjendemi të rrethuar prej Shqipërisë, Malit të Zi, Greqisë që patjetër duhet të diskutohet çështja e integritetit evropian edhe nga ana e Brukselit. Përndryshe, nëse e lexoni me kujdes deklaratën e kryekomisioneres, e keni të qartë që jemi në fund të fundit, ashtu siç kemi qenë në fund për viza.

Më vjen keq prej deputetes Ujkani, që e merr mundin të thotë që është sukses liberalizimi i vizave. E kuptoni që jemi njëzet vjet prapa në krejt rajonin me lirinë e lëvizjes. Ky do të duhej të jetë reflektim. Nuk mund të krenoheni me një proces, të cilin e kanë nisur para pesëmbëdhjetë vjetësh, janë kritikuar qeveritë e kaluara për ngadalësinë edhe tash vjen këtu thua që kemi bërë kurorëzim të madh, plus që kjo është dhënë si dhuratë, absolutisht dhuratë për 25 hektarët e Manastirit të Deçanit edhe pranimi të marrëveshjes së Brukselit edhe të Ohrit.

Nuk është dhënë si e drejtë e qytetarëve të Kosovës për shkak se kemi kaluar procesin e transformimit e të reformave brenda. Mjaft më me gënjeshtër! Popullin, duhet dalë e parë në sy për situatën edhe realitetin në të cilin jemi. Jemi me masa. Jemi nën sanksione.

Për politikat zhvillimore, politikat e gjelbra, ende në shishe të plastikës jeni duke pirë ujë. 1 kw nuk është shtuar për 4 vjet të energjisë së rinovueshme. E kuptoni. Pesë herë është shtyrë ankandi për panelet solare, edhe sot as nuk shihet diku në horizont që mund të realizohet ky ankand i energjisë së përtëritshme. Është turp more. Është turp.

Asnjë ministër nuk e keni këtu që të vijë e të japë llogari. Ju, katër herë e keni sabotuar vet Parlamentin. S'jeni të interesuar për debat demokratik të argumentuar në çështje kritike të vendit, e vjen këtu edhe do t'i bëjë publikut lajka kinse paska progres në Raportin e Progresit.

Ju lutem, jeni më keq sesa qeveritë e të tjera. Jeni më keq sesa legjislacioni tjetër. E keni sjellë joseriozitetin e institucioneve në nivelin zero. Hajgare! Po doni t'i flisni Kosovës prej diasporës. Këtu, këtu është jeta e përditshme. Këtu njerëzit ballafaqohem me krimin e mafisë ndërtimore që secilit qytet i është zënë fryma, e ju flisni për arritjet. Cilën arritje?

Nuk ka qytet e zonë urbanë që lejon jetë të denjitetshme për qytetarin e Kosovës. Rrjedhimisht, i keni 200 mijë qytetarë që e kanë lëshuar vendin me potencialin që secili prej tyre kur i jepet mundësia të dalë prej këtij vendi.

Uluni, seriozisht dhe t'i lini këto aspekte toksike të debatit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: I nderuar, regjia ta shtoi një minutë, nuk të ndërpreu. E pate fatin më të mirë se të tjerët. Po de, po ta dhashë një minutë shtesë për ta përmbyllur fjalën. Është me fakte kjo. Vetëm se regjia nuk të ndërpreu para se unë të deklaroj publikisht për ta shtuar një minutë, regjia e shtoi një minutë.

Regjia, e shtoi për shkak që ndërtova precedent të tillë. Po, jo zotëri se e pate një minutë shtesë. Të lutem, shko ulu në vendin tënd! Deputetja në radhë për fjalë është Shqipe Mehmeti-Selimi.

Regjia, ju lutem e printoni pjesën ku ia keni shtuar një minutë pa e deklaruar unë që të mos ia ndërpres fjalën deputetit. Regjia, herën tjetër, ju lutem, të prisni derisa të bëj deklarinimin për t'ia dhënë kohën shtesë, të mos veproni pa qenë e deklaruar nga ana ime. Dhe, të mos krijohen situata të tilla në të ardhmen. Shqipe Mehmeti-Selimi e ka fjalën. Mund të vazhdoni.

SHQIPE MEHMETI-SELIMI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sa herë që flas për Policinë e Kosovës, Forcën e Sigurisë e Sigurisë së Kosovës dhe AKI-në ndjehem krenare për punën e tyre në shërbim të shtetit.

Si qytetarë të këtij vendi, besimin ndaj këtyre institucioneve e kemi të palëkundur ndër vite. Këtë e kemi të bazuar në përkushtimin e tyre profesional e sakrificë në mbrojtje të rendit dhe zbatimit të ligjit, e së fundmi edhe në luftimin e grupeve terroriste në veri të vendit.

Mburremi të gjithë me sukseset e tyre në luftimin e krimit, në kapjen e kriminelëve, në ndërtimin e mirëbesimit mes komuniteteve në bashkëpunim me partnerët, por edhe me prezencën e tyre të fuqishme në çdo cep të territorit tonë.

Megjithatë, sulmet e fundit, qofshin ato nga opozita, gazetarë të disa portaleve apo analistë në studio televizive ndaj policisë, Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe AKI-së, dëmtojnë rëndë reputacionin e këtyre institucioneve të çmuara, ulin moralin e pjesëtarëve të tyre dhe dashur e padashur u shërbejnë interesave kundër shtetit tonë.

Përpjekjet e tyre për të përdorur të dhëna të rreme qoftë mbi largimet e ushtarëve nga ushtria apo imazhit për kequshqyerje apo mungesë të pajisjeve në ushtri dhe polici, apo edhe për të paraqitur kushte të rënda të punës në profesionin e tyre, janë kauza të rreme politike dhe të rrezikshme që mund t'i shërbejnë zbehjes së besimit të qytetarëve ndaj këtyre institucioneve të sigurisë.

Është meritë e pamohueshme e policisë dhe e Forcës së Sigurisë së Kosovës që sot Kosova qëndron në krye të vendeve të Ballkanit Perëndimor për përmasimin e sundimit të ligjit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Sigurisht, ky sukses ndërtohet mbi profesionalizmin e secilës grua e burrë që mbanë uniformën, por edhe mbi guximin politik të kësaj Qeverie për t'u përballur me çdo sfidë dhe për të mbrojtur integritetin e vendit tonë pa asnjë mëdyshje.

Andaj, si asnjëherë më parë, kemi shumëfish më shumë zhvillim të kapaciteteve tona policore dhe ushtarake, si në trajnime profesionale, pajisje të avancuara logjistike e teknologjike, duke e bërë policinë dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës të aftë dhe në kohë me zhvillimet rajonale e ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, sot më mirë se dje, ato janë të specializuara në realizimin e operacioneve komplekse, të gatshme në zbatimin e përgjegjësive të tyre kushtetuese në mbrojtje të rendit dhe të jetës së qytetarëve, por edhe në sovranitet të Kosovës, dhe kurrësi nuk mund të quhet polici e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën. Aha, e kreve. Në rregull. Tani në radhë është Ariana Musliu-Shoshi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Të dashur deputetë,

Të dashur qytetarë,

Të ndërlidhem me fjalimin paraprak kur u fol për krenarinë ndaj FSK-së. Ky pushtet i ka sjell në ditën që, vetëm një fakt dua ta ndaj me ju, dhjetë pjesëtarë të FSK-së kanë dhënë dorëheqje vetëm në muajin tetor. Pra, nga data 1 deri sot që jemi 31 tetor, dhjetë pjesëtarë të FSK-së kanë dhënë dorëheqje.

Të kalojmë në temë për të cilën dua të flas sot dhe shqetësimin që e kam. Aferat dhe skandalet në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk kanë të ndalur. Nga data 2 tetor 2024 kanë humbur 406 pasaporta, 165 letërnjoftime dhe 4 vendime për shtetësi të mërgimtarëve tanë në postën diplomatike të Republikës së Kosovës.

Ky, qytetarë të dashur, nuk është rasti i parë që bashkatdhetarët tanë përballen me probleme të tilla, pra, me pajisje të dokumenteve personale. Të risjellim në vëmendje vonesat e shumta për shkak të mungesës së materialit kanë qenë mjaft evidente dhe në fillim të këtij mandati qeveritar, të cilat kanë shkaktuar probleme të shumta të mërgimtarëve anembanë botës, duke pamundësuar edhe ardhjen e tyre në vendlindje për disa muaj.

Këto vonesa, qytetarë të dashur, kishin vetëm një qëllim, e qëllimi i vetëm është aplikimin e kontratave njëburimore nga kjo ministre e përgjegjshme. Për të qenë më e qartë me ju, kontratat njëburimore janë hajni.

Duhet të theksohet se tenderi për shpërndarjen e këtyre dokumenteve të rëndësishme të qytetarëve tanë që jetojnë në mërgatë, i ishte dhënë një kompanie me çmim shumëfish më të shtrenjtë. Kur them më të shtrenjtë, është konkretisht gjashtë herë më i shtrenjtë. Pra, ofertuesi ka qenë me 233.40 centë si ofertë e parë për shërbim postar diplomatik, ndërsa ka fituar ofertuesi i dytë me 1 mijë e 304 euro e 55 centë.

Humbja e dokumenteve personale nuk është thjesht problem i pajisjes me dokument të identifikimit, por rrezikon keqpërdorimin e identitetit të bashkatdhetarëve tanë, gjë që nuk guxon të ndodh në asnjë mënyrë dhe është e dënueshme me ligj.

Partia Demokratike me shqetësim e ka adresuar këtë problem dhe ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën!

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Partia Demokratike me shqetësim ka adresuar këtë problem dhe ka kërkuar llogaridhënie nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe ka bërë thirrje urgjente që organet e rendit dhe të drejtësisë të merren me këtë çështje, thirrje kjo që fuqishëm e përsërisim edhe sot.

Mësohet se Ministria e Punëve të Jashtme pas këtyre reagimeve ka adresuar kërkesën për shpallje të pavlefshme të rreth 500 dokumenteve për mërgatën tonë dhe më pas u është kërkuar që kjo kërkesë të anulohet.

Sot, me urgjencë kërkojmë llogaridhënie nga kjo Qeveri, pse dhe si u zhdukën dokumentet personale të bashkatdhetarëve tanë? Ku janë këto dokumente? Pse është anuluar kërkesa për shpallje të pavlefshme të këtyre dokumenteve?

Duke e ditur rrezikun për dëmin që mund t'u shkaktohet mërgimtarëve tanë me vjedhje të identitetit, ne me ngulm ftojmë prokurorinë që të hetojë këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më 28 gusht Qeveria e Republikës së Kosovës e mori vendimin për rritjen e pagës minimale në 350 euro.

Fjalët e Albin Kurtit ishin këto: “Me këtë nivel të ri të pagës minimale do të jetë dy euro ora e punës ose 350 euro paga bruto”, dhe, sipas tij, sipas këtij vendimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës nga data 28 gusht do të përfitonin plot 150 mijë punëtorë të sektorit publik edhe privat. Edhe ne edhe ju e dimë, të gjithë, që në sektorin publik nuk ka pasur as para 28 gushtit punëtorë të cilët e kanë pasur pagën nën 350 euro, mirëpo e dimë që të gjithë që ka pasur pagë nën 350 euro sektorin privat.

Dhe, çka po ndodh, të nderuar kolegë deputetë, prej 28 gushtit deri më sot nuk ka studio televizive dhe nuk ja rast ku përfaqësuesve të Lëvizjes Vetëvendosje u është ofruar mikrofoni dhe kamera, e të cilat nuk janë lavdëruar për këtë vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pagës minimale.

Derisa prej datës 16 shtator në oborrin e Kuvendin të Republikës së Kosovës janë 14 gra, të cilat janë në grevë, sepse ato paguhen në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Paga e tyre bruto sipas tyre është 275 euro. Më falni, paga neto, por që nënkupton se as bruto nuk është në nivelin 350 euro/

Tash, çfarë kemi? Këtu kemi disa shkelje. E kemi një kompani private, e cila nuk po e zbaton vendimin e Qeverisë për pagën minimale, por tjetra është që kjo kompani private ka kontratë me shtëpinë e demokracisë, me Kuvendin e Republikës së Kosovës, me ligjvënësit. Domethënë, ne jemi ata, të cilët i bëjmë ligjet dhe duhet të jemi përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe për zbatimin e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Dhe, nga data 16 shtator, domethënë ato gra janë në grevë, në ndërkohë që ne nuk kemi informacion që kësaj kompanie i është shkëputur kontrata. Kjo kompani, duke mos i dhënë shërbime Kuvendit të Republikës së Kosovës, vazhdon ta ketë një kontratë valide me Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Domethënë, nuk mund të lavdëroheni për secilin vendim, e sidomos jo për vendimet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën!

HYKMETE BAJRAMI: ...e sidomos jo për vendimet, të cilat nuk i zbatoni. Është shumë e thjeshtë zgjidhja e kësaj çështje, sepse nuk është thjeshtë çështje private, nuk është çështje e thjeshtë në mes të 14 grave dhe një kompanie private, sepse ajo kompani private paguhet nga një institucion publik dhe, në mungesë të ofrimit të shërbimeve, e pakta çfarë është dashur që të bëhej, është dashur që t'i shkëputet kontrata asaj kompanie, e cila po refuzon, për shkak të mosmarrëveshjeve që i ka me punëtorët, të ofrojë shërbime për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Andaj, duhet të kujdeseni që t'i zbatoni ligjet në fuqi dhe në tenderin e radhës një prej kriterëve duhet të jenë pikërisht edhe kushtet për punëtorët, të cilët kanë për të ofruar shërbime për institucionet publike. Faleminderit!

KRYESUESJA: Dhe, për fund, është deputetja Albena Reshitaj.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot kam dalë të bëj dhe një thirrje për përmirësimin e gjendjes së pensionistëve. Si deputete, si përfaqësuese e popullit ndiej përgjegjësi të ngre edhe një herë zërin për një kategori të ndjeshme të qytetarëve tanë, pensionistët.

Nuk është hera e parë që ngre zërin për pensionistët, për diskriminimin e skajshëm që po ju bëhet atyre. Mirëpo, pas reagimit të fundit të Shoqatës së Pensionistëve kundër rritjes së pamjaftueshme të pensioneve, mendoj që është koha që ne si ligjvënës t'i trajtojmë seriozisht sfidat e tyre. Prej 25 vjetësh, reformat e premtuara në sistemin pensional e social, përfshirë sigurimin shëndetësor, nuk janë realizuar.

Pensionet vazhdojnë të financohen nga buxheti i shtetit, bazuar në një ligj të mangët dhe diskriminues, në vend që të krijohet një sistem kontributiv si në vendet e rajonit dhe më gjer. Nga takimet e shumta që kam me pensionistët, kam kuptuar pakënaqësinë e tyre të thellë ndaj zgjedhjeve ligjore të padrejta dhe mungesës së vullnetit për përmirësimin e gjendjes së tyre. Çështje e ngutshme që duhet të zgjidhet është: harmonizimi i pensioneve me shpenzimet e jetesës.

Të nderuar qytetarë,

Ky obligim ligjor nuk zbatohet duke lënë pensionistët pa mbështetje përballë rritjes së kostos së jetës. Kriteri diskriminues prej 15 vjetësh stazh kontributiv, ky kusht pengon shumë qytetarë që kanë punuar për dekada të marrin pension kontributdhënës, duke i lënë në vetëm 100-120 euro në muaj dhe të gjithë e dimë këtë diskriminim të skajshëm dhe arsyen e këtij diskriminimi të skajshëm. Të gjithë qytetarët tanë e dinë sa diskriminues është ky.

Edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë sjellë zgjidhje deri më sot.

Tjetra, mosvlerësimi i diplomave të marra pas vitit 1999, sipas një udhëzimi administrativ diplomat pas këtij viti nuk pranohen për pensionim, edhe pse ato vlejnë për punësim dhe avancim profesional. Kjo është absurde dhe nënçmuese, duke dëmtuar, jo vetëm qytetarët, por edhe institucionet arsimore të vendit.

Këto situata, të nderuar qytetarë, që mund të quhen edhe absurde, duke u zbatuar tash e shumë vite, kërkojnë zgjidhje të shpejtë dhe me urgjencë, sepse në këto padrejtësi apo zgjedhje joadekuate ndër vite dhe jo humane, po dëmtohet një kategori e ndjeshme e qytetarëve, përfshirë edhe pensionistët me nevojë të veçanta, të cilët për shkak të moshës që kanë ndodh edhe që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën!

ALBENA RESHITAJ: ...të cilët për shkak të moshës që kanë ndodh edhe që po ndahen nga jeta. Pensionistët tanë, prindërit, motrat, vëllezërit tanë kanë kontribuar me dekada në kushte të rënda për ndërtimin e shoqërisë dhe institucioneve. Ata nuk kërkojnë lëmoshë, por zbatim korrekt të ligjeve dhe reforma që garantojnë një jetë të dinjitetshme në përputhje me standardet e rajonit dhe Evropës.

Në emër të respektit dhe mirënjohjes për kontributin e tyre është detyrim yni që t'u ofrojmë mbështetje dhe të drejta të merituar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ka përfunduar koha e deklarimeve nga pjesa e deputetëve, tani është koha e deklarimeve nga ministrat. Fjalën e ka ministri Liburn Aliu.

MINISTRI LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Në lidhje me projektet e infrastrukturës rrugore më duhet të ju njoftoj që në masën dërmuese projektet janë duke shkuar në trendët e veta normale të rregullta. Ka pasur probleme natyrisht nga e kaluara e të gjitha ato. Cilat janë problemet që kanë më së shumti vështirësi është problemi, është rruga e Gjilanit dhe rruga Dollc-Gjakovë.

Kur flasim për rrugën e Pejës, 240 milionë ka qenë i paraparë ndërtimi fillimisht, po realizohet tani me ritme normale të veta dhe ka për të kushtuar diku rreth 90 milionë. Kemi hapur tenderin për pjesën nga Dollci deri në Ramunë, presim procedurat e tenderit që kur ajo të fillojë. Nga pjesa deri në Dollc një nga lotët është ende në OSHP, tri lotet tjera ecin me trendin e vet të rregullt normal.

Për sa i përket rrugës së Podujevës ka qenë rrugë me probleme të shumta nga e kaluara, kemi arritur t'i përmbysim një pjesë të madhe të tyre, ta hapim tenderin prej Bardhoshit e deri në Lluzhan dhe deri në Podujevë që t'i realizojmë edhe pjesët e objekteve, të cilat po shkojnë sipas një trendi normal, katër shiritat gati janë, së shpejti do të asfaltohen të katër shiritat të rruga e Podujevës. Probleme ka të ndryshme të ndërtimit e urave, ndër tjera ka probleme që vijnë edhe nga ndërmarrjet tjera, siç është rasti me KEDS-in, apo me të tjera që i kanë të vendosura shtyllat, të cilat janë probleme brenda suazave normale, e të cilat i kanë edhe projektet normalisht të tjera.

Kur flasim të rruga e Mitrovicës, dua të ju kujtoj që është një ndër rrugët më problematike që i kemi pasur nga 2018-ta është vetëm ky segmenti i fundit, i cili është zvarritur vazhdimisht. Çka po ndodh tash? Pjesa e rrugës deri në Vushtrri është para përfundimit, po përfundohet në mënyrë mjaft të mirë, mjaft të shpejtë. Pjesët e objekteve nga qarkorja prej Vushtrrisë, që lidhet deri në Gojëbulë, po ashtu po vazhdojnë punët në ndërtimin e urave, nënkalimeve të ndryshme dhe po ecën normalisht me trendin e vet.

Shiheni urën në Rogovë, ka qenë projekt mjaft problematik, po realizohet brenda afateve të veta. Shkoni shihini si po vendosen aty trarët, janë kryer edhe shtyllat. Edhe te ura e Badocit, ka qenë urë me probleme, në projektim që në fillim i cili ka qenë problemi, të mos harrojmë rruga e Badocit ka qenë rrugë e cila ka ndodhur befas, pra dëmtimi i saj ka ndodhur i befasishëm. Është bërë projekti, projekti është bërë me gabime, është rishikuar projekti tash po ecën me një trend mjaft të shpejtë dhe po kryhet normalisht sipas afateve të veta.

A ka probleme? Gjithkund ka. Në cilat faza? Edhe në projektim, edhe në mbikëqyrje, edhe në krejt. E kemi shtuar nivelin e mbikëqyrjes dhe po ka edhe cilësi më shumë, edhe shpejtësi më të madhe, por kur flasim për Dollc, Gjakovën, edhe kur flasim për autostradën e Gjilanit, unë dua të ju them që janë dy rrugët me të cilat jemi marrë më së tepërmi nga të gjitha të tjerat. Nuk ka rrugë që e kam vizituar më shumë se autostradën e Gjilanit, por ka probleme të përditshme. Pse?

Sepse, mënyra e kontraktimit dhe e projektimit të tyre ka ndodhur në kohë fushatash, ka ndodhur me probleme, qoftë në projektim, qoftë pa zgjidhjen e problemeve të shpronësimit dhe të cilat sot vazhdojmë t'i kemi si telashe. A ka progres? Ka më të ngadaltë të rasti i autostradës së Gjilanit, por ka progres dhe ta zëmë loti 6 është një ndër lotet më problematike që ka qenë, është duke u zgjidhur problemi i tij, i pjesës së gjurmimeve të një mali të tërë, që ka qenë fare-fare pothuaj as i pafilluar kur kemi ardhur ne.

Por, gjithsesi, megjithatë duhet të them, të pranoj që tek pjesa e autostradës së Gjilanit, progresi i punimeve aty është i ngadaltë, është kontratë e vjetër, çmimet janë ato që janë, që kanë qenë, ka pasur rritje në ndërkohë të çmimeve, ka pasur ndikime nga lufta në Ukrainë. Të gjitha këto kanë qenë zvarritje të shumta të atyre projekteve që janë të trashëguara, por të cilat po i zgjidhim. Kanë qenë dhe janë si litar nëpër këmbë që duhet t'i zgjidhim një nga një.

Më e dhimbshme është pjesa Dollc - Gjakovë, me të cilën për një pjesë, pjesën e fillimit po flas duke hyrë nga Dollci, pjesa e shpronësimeve akoma vazhdon të jetë problem i pazgjidhshëm. Për pjesët tjera mbase do të ketë zgjidhje shkëputja e kontratave, të cilat përherë kemi hezitur, s'kemi dashur t'i shkëputim kontratat e të fillojmë prej fillimit. Jemi përpjekur t'u japim shanse operatorëve që t'i realizojnë ato dhe vjen një moment mbase që edhe duhet të shkëputen, sepse janë kontrata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJ: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën, edhe një minutë!

MINISTRI LIBURN ALIU: ...sikur qysh ka qenë rasti i rrugës së Mitrovicës. Pa ndodh shkëputja e kontratës, nuk do ta kishim këtë progres. Po edhe ai proces i shkëputjes është dashur të ndodhë me auditime e të gjitha me radhë. Tash jemi në një trend normal të zhvillimeve të këtyre rrugëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Kemi disa replika në emër të grupeve, nga Partia Demokratike është Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: Zoti ministër,

Për rrugët Mitrovicë, Podujevë, Gjilan e tjera flet situata e tyre. Rrugën Dollc-Gjakovë e kaloj unë për çdo ditë. Vitin e kaluar kur keni bërë intervenimin e parë domethënë prej Meqës e deri në kodër të Meqës, brenda katër ditëve ka shpërthyer asfalti, është çelur. I keni shtuar edhe 200 metra prej kodrës së Meqës deri në Vraniq komplet, ajo pjesë është çelur gropa-gropa, ka fjetur.

Unë kam marrë ekspertë që m'i kanë gjetur, i kam dërguar dhe jua kam thënë edhe në foltore të Kuvendit çka po ndodh? Baza tha s'është krijuar mirë, shihe kur të bëhet shtresa, merr lagështi, dihet që s'ka bazë dhe komplet janë çelur gropa. I keni mbyllur gropat dhe skaj mbylljeve që i keni bërë hiç pa e niveluar atë asfaltin që e keni vënë, po janë bërë ato kodra të gjuhen në to, janë hapur prapë gropa që janë edhe sot të hapura. Njëjtë është me krejt copat e asfaltit që keni shtruar deri në hyrje të Gjakovës. Çka është edhe më tragjike, rrugët e vjetra që kanë qenë të gjitha janë bërë tash të rrezikshme, të pakalueshme, sepse nuk keni arritur t'i mirëmbani ashtu si duhet dhe si e keni pasur detyrim. Me siguri se ka kompani të mirëmbajtjes, mirëpo në qoftë se ato kanë

marrë ndonjë tender korruptiv, atëherë e kanë të pamundshme, nuk e bëjnë mirëmbajtjen, sepse Bardhyl Çausi i ndjerë thoshte “kur pranon dhuratën, s’ki të drejtë të flasësh”.

Pra, rruga Dollc - Gjakovë në gjithë segmentin e saj, edhe shembja, edhe ato heqjet e betoneve, tregon se këtu nuk ka një strategji të investimit, veç po bëhet punë sa për të bërë. Keni thënë se i keni ndarë 35 milionë, asfalti që po vendoset atje është tragjedi, nuk ka të bëjë me 35 milionë. Prandaj, unë mendoj që duhet të reflektoni më shumë, të mos flisni vetëm çka thuhet në media, por të vini ta përjetoni vetë kalimin nëpër ato rrugë. Është një terrorizim i qytetarëve të atij rrethi që kalojnë në baza ditore. Keni bërë një shembje atje, e keni lëvizur edhe trasenë e hekurudhës.

Ky është një dëm i madh në aspektin strategjik që po...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, replikën e ka Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Ministër, ura te Badoci po shkon sipas planit të juaj, është dashur më shumë se dy vjet e gjysmë për t’u rregulluar ajo urë, dhe besoj që e dini sa fatkeqësitë dhe sa aksidentet po bëhen në rrugën Gjilan - Prishtinë.

Është rruga që e keni devijuar domethënë dhe ajo rruga që është e devijuar është shumë e dëmtuar dhe nuk e di sa duhet kohë për juve një urë afro 40 metra për ta rregulluar më shumë se dy vjet e gjysmë u janë dashur. Unë e di që ka probleme, po ju jeni aty për t’i zgjidhur problemet. Se për autostradën kam bërë pyetje shumë herë këtu në Parlament dhe asnjëherë nuk e kam marrë një datë të caktuar kur do të përfundojë autostrada Gjilan-Prishtinë.

KRYESUESJA: Një kundër-replikë, ministri Aliu.

MINISTRI LIBURN ALIU: Për vërejtjet për rrugën Dollc-Gjakovë, mendoj që një pjesë e madhe e tyre qëndron. Me të gjitha këto, po ju them që jemi duke u marrë. Është projekt i trashëguar, i kontraktuar në të kaluarën, me projekte problematike. Shembjen nuk e kemi bërë ne. Shembja ka ndodhur si rezultat i këtij projekti.

Një pjesë e madhe e këtyre detajeve të projekteve janë ndryshuar. Pjesa objekteve ka filluar të ndërtohet që s’kanë qenë të kontraktuara fare. Një pjesë e shpronësimeve janë kryer, një pjesë nuk mund të kryhen pa u zgjidhur problemet mbase edhe gjyqësore.

Te pjesa e urës së Badocit, pra pjesa e Badocit është duke shkuar në trendin normal tani. Prej momentit kur ka filluar, sapo ka filluar, po shkon duke u kryer dhe mendoj që nuk po mund t'ju jap fjalë as për atë, por në vizitat që i bëj çdo ditë, progresi është. Mbase te rastet e urave, edhe te rasti i urës së Rugovës, edhe te rasti i urës në Badoc, është duke shkuar brenda trendëve normalë, bile pres që të kryhen edhe më herët.

Sa i përket autostradës, nuk mund t'ju jap fjalën, për shkak se për çdo ditë dalin probleme të reja. Por, a ka progres? Ka një progres mjaft të madh. Veç vizitat e mia që i kam bërë së paku një herë në muaj, e mbase edhe më shpesh, nga marsi i këtij viti, trendi i punimeve ka shkuar në mënyrë mjaft të shpejtë krahasuar me vitin e kaluar, sidomos pas stagnimeve të mëdha që i kemi pasur në vitin 2022.

Traseja po hapet në pjesën më të madhe të tij në lot 7, që është një gjërmim jashtëzakonisht i madh, që është pjesa më e madhe e gjërimeve mbase në të gjitha rrugët që i kemi pasur, është para përfundimit, është në ato fazat finale të saj. Ka telashe të ndryshme, del uji, buron uji, duhet sistemuar burimet e ujit që dalin të reja.

KRYESUESJA: Atëherë, me kaq përfundon edhe pjesa e deklarimeve jashtë rendit të ditës nga pjesa e ministrave.

Vazhdojmë me pikat e radhës.

Pasi kemi procese të votimi, kërkoj nga deputetët që të kthehen në vendet e tyre që të procedojmë tutje.

3. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për zëvendësimin e deputetëve në komisione parlamentare

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë tash. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i ka paraqitur disa zëvendësime. Do të jenë zëvendësime nëpër komisione parlamentare, pasi deputetët në fjalë janë larguar nga grupi parlamentar, tash Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka të drejtë t'i bëjë zëvendësimet e këtyre pozicioneve.

Atëherë, Lëvizja Vetëvendosje ka propozuar këto zëvendësime, si në vijim:

Deputeti Nijazi Isaku propozohet anëtar i Komisionit për Buxhet, në vend të deputetit Visar Korenica.

Deputetja Shqipe Meta-Isufi propozohet anëtare në Komisionin për Buxhet, në vend të deputetit Eman Rrahmani.

Deputeti Besim Muzaqi propozohet anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Visar Korenica.

Deputetja Jetmire Vrenezi propozohet anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, në vend të deputetit Drita Millaku.

Si dhe Deputeti Milazim Salihaj propozohet anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, në vend të deputetes Drita Millaku.

Këto janë pesë propozimet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. I zëvendësojmë këta anëtarë, sepse i takon grupit parlamentar ta bëjë këtë.

Përgatituni për votim! uluni nëpër vendet tuaja, të nderuar deputetë. Votojmë tash!

Vetëm 60 deputetë po marrin pjesë në votim. E provojmë edhe një herë. Është mirë edhe opozita të votojë.

Urdhëro, Arben Gashi!

Jo, po vendosni precedent pastaj. Nuk është veç Grupi Parlamentar i VV-së që ka nevojë për zëvendësime.

ARBEN GASHI: Po, faleminderit kryetar!

Pajtohem plotësisht me ty, është e drejtë e partisë që t'i zëvendësojë deputetët në komisione. Është vendosur më herët në legjislaturën e kaluar një precedent i keq prej Lëvizjes Vetëvendosje, kur ne si LDK kemi dashur të zëvendësojmë një deputet për shkak të mungesës shëndetësore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk na keni lejuar.

Gjithsesi, unë mendoj që ju takon juve, është e drejtë e tyre, por meqenëse ne e kemi marrë një deputet nga ju, nuk po duam të ndërhyjmë në çështjet tuaja të brendshme. Ju mbetet juve të zgjidhni.

KRYETARI: Na ke ndihmuar..., bravo të qoftë!

E respektojmë empatinë e LDK-së, kështu që provojmë vetë ta kalojmë këtë.

Edhe një herë, ju lutem, votojmë tash!

PDK-ja a ka këso dhembshurie a jo?

61 deputetë votuan për këtë ndryshim 50, kundër 2, abstenime 9.

Kështu që konstatoj që Kuvendi i zëvendëson këta anëtarë nëpër komisione.

Vazhdojmë tash me pikën:

4. Propozim-Vendimi për hartimin e Nismës legislative të qytetarëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me Ligjin për nismat legislative, është trajtuar hartimi për Projektligjin për parandalimin e vetëvrasjes, mirëpo ne aty në Kryesi siç po ju kujtohet, së bashku me anëtarët e Kryesisë e morëm një vendim, i cili pasi e bëmë një konsultim edhe me grupet parlamentare, znj. Bogujevci e paska kryer këtë diskutim me ta.

Unë po pajtohem me ju që keni marrë vendim shumë të arsyeshëm, pas një diskutimi, megjithatë kjo çështje të kthehet, sepse kemi biseduar edhe me organizatorë dhe, edhe ideja e tyre dhe pas argumenteve që qëndrojnë është që të kthehet kjo, ta trajtojmë edhe një herë dhe të marrë një drejtim të ri, një drejtim tjetër, ashtu qysh insiston organizatori, kështu që kjo është e mundshme.

Ndërlidhet me çështje të procedurave kjo dhe e tërheqim këtë nga rendi i ditës për kohësisht derisa t'ia japim një epilog tjetër.

Kalojmë tash te pika e radhës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar projektligjin, Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij së bashku edhe me amendamente, sepse në këtë projektligj janë propozuar edhe amendamente nga ana e komisionit.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim as me Kushtetutën as me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se ky projektligj dhe amendamentet nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian, kurse Komisioni për Drejtat dhe

Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kryetari i komisionit, zoti Shala a paraqitni ju raportin e komisionit. deputet Shala e ka fjalën.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti vlerësoi se Projektligji nr. 08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit, në bazë të raportit të vet amendamentuesit të datës 2 korrik 2024, si dhe në bazë të raporteve të komisioneve të përhershme, më datën 19. 9. 2024 vendosi t'i paraqesë Kuvendit këtë:

Rekomandim

Të miratohet në shqyrtim të dytë Projektligji nr.08/L-228 për mbrojtjen e konsumatorit me amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Tash ky projektligj i ka 26 amendamente të cilat janë propozuar. Me sa po e shoh këtu të gjitha qenkan nga Komisioni FunkSIONAL. Kështu që, i hedhim bënë votim këto amendamente. Përgatituni për votim.

Të nderuar deputetë,

Kush është për këto amendamente? Votojmë tash! Vetëm 60 vota. Edhe një herë.

Përgatituni për votim. I votojmë të gjitha 26 amendamentet. Votojmë tash! Vetëm 58 tash. Po bie numri.

Votojmë edhe një herë. Janë 26 amendamente, votojmë tash. 61 vota për amendamentet, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kalojnë ato.

Tash e votojmë projektligjin së bashku me amendamente, është Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit. Votojmë tash!

Vetëm 60 deputetë votuan. Votojmë herën e dytë. Votojmë tash. 64 deputetë votuan.

A ta kthejmë prapë, se e dyshimtë kush ka votuar. Do të thotë, konstatoj që votohet projektligji nga ana e Kuvendit, Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit.

Tash e kemi një projektligj tjetër, i cili është:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-295 për krypto-asetet

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar projektligjin. Neve na e ka rekomanduar ta miratojmë këtë projektligj. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm. Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se edhe projektligji edhe amendamentet nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-së, kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Sërish po ia japim fjalën kryetarit të komisionit, ku është trajtuar ky projektligj. Ferat Shala e ka fjalën.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Ekonomi, Industri dhe Ndërmarrësi dhe Tregti ka rekomanduar që miratohet Ligji për krypto-asetet nr.08/L-295 dhe i rekomandojmë Kuvendit ta miratojë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Sa amendamente i ka ky ligj? 17 amendamente dhe më duket që të gjitha qenkan nga Komisioni Funkcional. I hedhim në votim këto. Përgatituni për votim, votojmë tash. Amendamentet e projektligjit janë këto.

Vetëm 59 deputetë votuan. Votojmë edhe një herë, hera e dytë. Votojmë amendamentet, votojmë tash. Vetëm 58. Ju lutem, bisedoni me anëtarët tuaj, mazhoranca, grupi parlamentar nëse ka qëndrime ideologjike për këtë punë. Po de, se... Po, krypto-asetet edhe mund të kenë ndonjë...

Siguroheni që secilit po ju punojnë kartelat. Mund ta vëreni shumë lehtë që s'po punojnë, se nuk mund të votosh. Kështu që, duhet të lajmërohesh nëse s'po mund të votosh. Votojmë tash 17 amendamentet e projektligjit. Votojmë tash.

Regjia, ju lutem ta publikoni edhe pamjen e tabelës së votuesve. 61 deputetë votuan. 59 vota për amendamentet, asnjë votë kundër, 2 deputetë abstenuan. Tash e votojmë projektligjin së bashku me amendamentet, është Projektligji për krypto-asetet. Votojmë tash.

61 vota janë në Kuvend. 58 për, kundër asnjë, 3 deputetë abstenuan për këtë projektligj, kështu që konstatoj që Kuvendi e miratoi Projektligjin për krypto-asetet.

Kemi tash në shqyrtim të dytë një projektligj tjetër, i cili është:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me amendamente më 14 maj, dhe raportin plotësues më 1 tetor.

Në të dyja raportet e këtij Komisioni Funkcional i ka rekomanduar miratimin e projektligjit dhe amendamentet e propozuara. Komisioni për Buxhet ndërkaq ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm, por ky komisionin, flitet për Komisionin për Legjislacion, nuk e ka shqyrtuar raportin plotësues brena afatit të paraparë me Rregullore të Kuvendit.

Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i shkelin parimet bazë të legjislacionit të BE-së. E vlerësime të njëjta ky komision ka edhe për raportin plotësues.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, e ky komision ka vlerësime të njëjta edhe për raportin plotësues.

Sërish po ia jap fjalën, sepse bie në kompetencën e këtij komisioni, deputetet Ferat Shala, kryetarit të komisionit. Urdhëroni, zoti Shala, e keni fjalën!

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni, po ashtu rekomandon miratimin në lexim të dytë të Projektligjit të pronarëve përfitues me amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Këtu tash i kemi 23 amendamente që qenkan propozuar prej anëse së komisionit, të gjitha janë të Komisionit Funkcional. Po i hedh ato në votim. Ta keni vëmendjen, të nderuar deputetë, se po ju lus të votojmë tash! Fillon votimi.

61 deputetë votuan. Të gjitha votat për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohen 23 amendamentet e Komisionit Funkcional. Po e hedh tash në votim projektligjin së bashku me amendamentet. Përgatituni për votim. Votojmë tash.

61 deputetë votuan. 61 vota janë për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues.

Meqenëse ishte një marrëveshje mes grupeve parlamentare, po marrim tash një pushim. Në orën sa mendoni që është më arsyeshme të kthehemi? Në orën 14:00 apo në 14:30? Në orën 14:00. Sido që të pajtoheni. Në orën 14:00, mirë. Vazhdojmë në orën 14:00 me këtë debat. Faleminderit!

* * *

E hënë, më 4 nëntor 2024

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 31 tetor 2024

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi pritur 25 minuta nga koha e nisjes dhe mendoj që nuk mund të presim më shumë, kështu që po e fillojmë.

8. Shqyrtimi i propozimit të gjashtë (6) deputetëve nga GP të PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Të nderuar deputetë,

Më 2 gusht të këtij viti, 6 deputetë nga Grupi Parlamentar i PDK-së e kanë parashtruar mocionin për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së dhe më 9 shtator 2024 i është dërguar për shqyrtim Komisionit FunkSIONAL të Administratës Publike. Komisioni brenda 15 ditëve është dashur të paraqesë raportin me rekomandime. Komisioni FunkSIONAL brenda afatit të paraparë me Rregulloren e Kuvendit nuk paraqiti fare raport për këtë mocion, andaj Kryesia e Kuvendit më 7 tetor e nxori përfundimin, me të cilin kërkon që Komisioni FunkSIONAL ta shqyrtojë mocionin dhe të paraqesë raport.

Komisioni deri më tani nuk ka paraqitur kurrfarë raporti për këtë çështje. Prandaj, duke iu referuar Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, komisioni e shqyrton kërkesën për shkarkim në një procedurë, e cila i garanton personit ndaj të cilit është parashtruar kërkesa për shkarkim të drejtën për t'u informuar me kohë, për t'u pyetur, dëgjuar, për t'u bërë pyetje kërkuesve të shkarkimit, si dhe për t'i paraqitur shpjegimet e tij.

Po ia jap qysh në fillim fjalën parashtruesit të kësaj kërkesë, por kësaj radhe këtë përgjegjësi e ka marrë deputetja Eliza Hoxha, e cila paraqet këtë kërkesë të gjashtë deputetëve të PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Urdhëroni, zonja Hoxha!

ELIZA HOXHA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Veçanërisht të nderuara media,

Kujt i shërben RTK-ja sot dhe a është kjo RTK-ja që Kuvendi i Kosovës si themeltar i saj e dëshiron? Këto janë dy pyetje thelbësore që besoj që do duhej të marrin përgjigje nga prizma të ndryshme për brengën që sot do ta trajtojmë brenda kësaj seance.

Arroganca e numrave në këtë Kuvend, mendjet paranoike dhe njerëzit pa ide, vizion dhe pasion për radiotelevizionin që kanë marrë mandat të si bord nga ky Kuvend na e shpërfaqin në fakt idenë e vërtetë se si Lëvizja Vetëvendosje e dëshiron Radiotelevizionin e Kosovës. Përgjatë këtij mandati kemi qenë dëshmitarë të përpjekjeve të vazhdueshme të qeverisë dhe të shumicës parlamentare për të cenuar lirinë e medias dhe fjalës së lirë dhe kjo është bërë në formë të ndryshme. Këtë e thekson edhe Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian për Kosovën i cili doli para pak ditësh, i cili flet për regres dhe për ndikim politik jo vetëm në fushën e medias, por edhe në sektorët e tjerë.

Përpjekja e Qeverisë për të ushtruar kontroll në media, Kuvendi nuk mori parasysh shumicën e rekomandimeve të BE-së për KPM-në, Kuvendi si themelues i RTK-së nuk ndërmori as hapat e nevojshëm për mbikëqyrjen e drejtë dhe llogaridhënien që bordi duhet ta bëjë, mungesa e transparencës, 72 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, presionin ndaj aktorëve civilë në shërbimin publik janë vetëm disa nga shqetësimet. Ky është vetëm një peizazh i vogël për ta parë gjendjen në të cilën ky pushtet e ka sjellë vendin. Por, megjithatë, sot do fokusohemi vetëm te Radiotelevizioni i Kosovës brenda këtij debati.

Për më tepër dhe për më keq, këto përpjekje në shumë raste dhe kanë marrë formën e vendimeve nga institucionet e dirigjuara dhe të menaxhuara nga njerëz që fshihen nën kapela dhe që në hije dirigojnë institucionet, përfshirë edhe RTK-në. Vendimet dhe veprimet e këtilla kundër mediave e fjalës së lirë janë ngritur në nivele jo vetëm shqetësuese, por të patolerueshme edhe në Radiotelevizionin e Kosovës, duke e përdorur këtë të fundit si transmetues publik për të trilluar shpifje e të pavërteta për mediat e tjera të lira e të pavarura në vendin tonë. RTK dështoi t'u qëndrojë besnik parimeve themelore të gazetarisë dhe të ligjshmërisë, për të verifikuar faktet dhe për të fituar burime të besueshme të lajmeve që i transmeton.

Në këtë mënyrë, lajmet e rreme në RTK, të cilat citonin po ashtu një medium boshnjak, artikulli i të cilit edhe mund të jetë shkruar ndoshta në zyrat e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, përbëjnë cenim direkt të sigurisë dhe jetës së gazetarëve dhe këtyre mediumeve nga njëra anë, por edhe shpërfaqje në anën tjetër fushatën qeveritare kundër mediave dhe fjalës së lirë si vlerë kushtetuese dhe demokratike e shtetit dhe shoqërisë sonë.

Prandaj, pas gjithë kësaj situate, RTK nuk e ka kredibilitetin e transmetuesit publik nëse nuk merren masa ndaj drejtuesve të saj, aq më tepër që nga dita në ditë u ndriçuan shumë rrethana dhe disa nga gazetarët e këtij mediumi e të cilët dëshmuar integritet profesional u distancuan nga lajmet e tilla shpifëse. Lidhur me këtë jemi dëshmitarë se edhe ushtruesja e detyrës, drejtoresha e përgjithshme kishte ofruar dorëheqjen e saj, por as kjo nuk mjafton, sepse ky lajm shpifës që trazoi themelet e fjalës së lirë në Kosovë dhe zgjoi dhe reagime të panumërta nga organizata vendore e ndërkombëtare, ka një adresë të saktë: Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës. Përveç shkeljeve në këtë skandal televiziv, e për të cilin mund të angazhohet edhe prokuroria

kompetente konsiderojmë se duhen marrë masa për shkarkimin individual të secilit anëtarë të Bordit të RTK-së, pasi të njëjtit dështuan për ta mbrojtur RTK-në dhe standardet e kredibilitetit e gazetarisë.

Së fundi, edhe procesi i ushtruesit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm i zgjedhur rishtazi është i jashtëligjshëm, ngase ka kaluar vetëm me gjashtë vota dhe jo me 2/3 e votave që do të duhej bazuar me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës. Bordi me këtë rast ndryshoi statutin dhe Rregulloren, e që në fakt janë akte legislative të nivelit të dytë dhe duhet të jenë në harmoni me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës.

Si deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, propozues të këtij debati, të këtij mocioni, kërkojmë shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, të cilët mbajnë përgjegjësinë kryesore për nënshtrimin e RTK-së ndaj partisë në pushtet, duke u bërë zëri i propagandës së tyre e cila tashmë kontrollohet dhe i shërben edhe agjendave politike kundër kundërshtarëve politikë apo atyre mediatikë.

Ky mocion është propozuar fiks tre muaj më parë, më 2 gusht të vitit 2024, pra në fund të sesionit pranveror dhe brenda kësaj periudhe kanë ndodhur ngjarje e zhvillime të cilat vetëm se e kanë konfirmuar kapjen dhe nënshtrimin e RTK-së duke e kthyer në instrument që i shërben partisë në pushtet dhe jo publikut. Lajmet e rreme dhe shpifëse që RTK i ka transmetuar kundër dy medimeve kredibile në vendin tonë kanë rrezikuar jetën e gazetarëve, po përmend këtu vetëm disa nga ata, si: Ilir Mirena, Vehbi Kajtazi, Berat Buzhala e Lirim Mehmetaj dhe shumë të tjerë, për çka askush deri më sot nuk ka marrë përgjegjësi.

RTK është i publikut dhe i tillë duhet të mbetet, nuk duhet të shndërrohet në instrument të pushtetit për të projektuar, organizuar dhe transmetuar shpifje dhe të pavërteta kundër mediave dhe kolegëve të tyre gazetarë me qëllim që t'i shërbejë partisë në pushtet në betejën e dëshpëruar të saj për të luftuar fjalën e lirë dhe të vërtetën që publiku duhet ta dijë. Ajo duhet të orientohet te vetja, RTK duhet të orientohet te programet e saj më të mira e më të arrira, tek zhvillimi dhe edukimi i përgjithshëm e te gjithëpërfshirja, ashtu se si specifikohen parimet programore të saj me Ligjin për RTK-në në nenin 7.

Një bord, i cili nuk e ka kryer punën e tij primare, funksionin për çka edhe është zgjedhur në këtë Kuvend, e njëkohësisht ka kohë të merret me gazetarë dhe media të tjera të pavarura nuk duhet dhe nuk guxon të qëndrojë aty më. Kjo është fyerje për RTK-në, është fyerje për taksat e Kosovës si financues të saj dhe është fyerje edhe për këtë Kuvend si themelues të saj.

KRYETARI: Tash ia japim fjalën kryetarit të Komisionit së Administratës, Mediave dhe çështjeve të tjera, deputeti Valon Ramadani flet.

VALON RAMADANI: Faleminderit, i nderuar kryetar Konjufca!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të dashur qytetarë,

Media!

Po të kishte opozitë serioze dhe po të ishin prej së vërteti shqetësimet që këta ngritin për Bordin e RTK-së, ky diskutim nuk do të mbahej fare. PDK-ja po do ta shkarkojë një Bord të RTK-së, ku prej shtatë anëtarëve, tre kanë dhënë dorëheqje, ndërsa dy prej tyre u skadon mandati dhe tashmë konkursi është i hapur për ta.

LDK-ja, si zakonisht, është pas PDK-së, pra singeriteti në këtë kërkesë është zero. Dëshirojnë të shkarkojnë ata që kanë dhënë dorëheqje, nuk bëhet opozita kështu, o kolegë. Po e shoh që keni nevojë për vite të tjera të kuptoi se si bëhet opozita, por ne ju mirëkuptojmë, zgjedhjet janë afër e më në fund duhet tentuar të bëhem të zëshëm disi me çfarëdo teme që u vjen ndoresh. Ajo çfarë ne nuk lejojmë ju të bëni, është të shiteni si shenjtorë këtu dhe të ngrini tema, të cilat halli juaj është krejt diku tjetër.

Pra, ata çka sot paraqesin diçka tjetër, te qytetarët paraqesin diçka tjetër. Këtë ju mund ta bëni këtu, ose edhe nuk mundeni, por pastaj juve ju del kjo në shesh, sepse gënjeshtria nuk kalon. Kërkesën e kam paraqitur për një lajm të RTK-së që e ka shpërndarë nga një medium i huaj, i cili hedh dyshime mbi financat e disa medimeve në Kosovë, që transparenca financiare dhe pronësia e mediave në Kosovë përbën problematikë të theksuar, këtë e ka thënë edhe Raporti i Progresit i BE-së i publikuar kohën e fundit.

Dyshimet mbi financimin e mediave nuk janë fake news, janë shqetësim real, në këtë kohë kur në Evropë Rusia po bën luftë reale dhe hibride, ne nuk kemi luksin të jemi demokratik në financimin me origjinë ruse ose serbe. Brenga këtu e PDK-së është se janë përmendur pikërisht mediumet private që ua mbajnë vijën e ua shtyjnë opinionin e tyre, pra politikat e tyre. Për ta zgjidhur këtë problem është fare kollaj, le të hyjë në fuqi Ligji për KPM-në, siç rregullon transparencën financiare, pronësinë dhe gjërat që bien në vend, por ky nuk është aspak halli juaj.

Në fakt, halli i PDK-së nuk është fare as te RTK-ja, e as tek shërbimi që RTK-ja ua ofron qytetarëve. Halli është që këtyre u ka humbur kontrolli mbi RTK-në, që e kanë pasur me vite të tëra. U ka humbur mundësia që aty të keqpërdoret me kontrata, me mediumet që kanë marrë edhe para, edhe lajme nga RTK-ja, e kanë hallin që në RTK punësohet tash me meritokraci, e kanë hallin që moderatorët aty nuk dridhen me mbyllje të syrit. Për të pasur pasqyrë më të qartë të asaj çka ka ndodhur në RTK, po ju kujtoj që më herët në RTK kanë qenë të punësuar mbi 1 100 persona, sot janë vetëm 740. Të gjithë këta kanë qenë militantë partiakë që janë shërbyer për angazhimin e tyre dhe duke u paguar nga taksat e qytetarëve të këtij vendi. Asnjë prej tyre nuk ka bërë ankesë për shqetësimet të këtyre kontratave, për bindjen time, kjo ka ndodhur sepse shumica e tyre as nuk e kanë ditur ku e kanë vendin e punës, e janë paguar për këtë çështje.

Edhe pas largimit të këtij numri kaq të lartë të punëtorëve, RTK ka vazhduar punën e vet pa asnjë mungesë, kjo është dëshmi që ato punësime kanë qenë keqpërdorim i pastër nga ana juaj, e që po shitini se gjoja ju po shqetësoheni për RTK-në. PDK-ja po mundohet që shprehitë e tyre të vjetra t'ia veshin qeverisjes Vetëvendosje, duke akuzuar se kinse kapje e presion politik, duke u munduar që të thoni që edhe ju jeni si ne.

Por, e vërteta është krejt ndryshe, e vërteta është që ne e kemi çkapur RTK-në, e për juve çkapja është kapje, sepse mjafton që të mos e keni të kapur ju, sepse ju nuk jeni mësuar që dikush të jetë në pushtet, e të mos i kapë institucionet, pra sigurisht që me këtë ju mund të shqetësoheni, edhe çuditëni bile. Tash e sa vite RTK ka pasur mundësinë që të punojë lirshëm e pa direktiva. Në krye të saj ka pasur një bord që ka bërë përmirësime, e natyrisht që hapësirë për përmirësime ka ende shumë.

Këto vitet e fundit RTK ka zvogëluar shpenzime enorme të paarsyeshme që kanë ndaluar gjakderdhjen financiare në të dhe pas kaq kohe jo që nuk ka krijuar borxhe të reja, por edhe ka paguar ato të trashëguara që ende përbëjnë rrezik për këtë medium. Të mos harrojmë që Bordi i RTK-së ka gjetur të trashëguara 2 milionë euro. 2 milionë euro borxhe që ju i keni krijuar aty. Merreni me mend, vetëm për mbeturinat në kohën që ju keni qenë në mazhorancë, edhe PDK, edhe LDK, në RTK është paguar mbi 23 mijë euro vetëm për dy kontejnerë të mbeturinave. Ndërsa, sot paguhet vetëm 2 mijë euro.

Pra, po e shihni ku qëndron halli juaj. Kjo çështje dhe të tjera të ngjashme janë ngritur edhe pranë organeve të drejtësisë, por ende asgjë nuk ka lëvizur në zbardhjen e këtyre.

Përderisa programi i RTK-së kërkon ende shumë angazhime në një propozim për të arritur në nivelin që duhet, kjo përbërje e këtij mediumi ka arritur që të realizojë edhe projekte madhështore, siç është Festivali i Këngës së RTK-së, që tani sapo përfundoi edicioni i dytë.

Ky është një hap i rëndësishëm në rritjen e përfaqësimit të vendit tonë në Eurovizion. A keni ndonjë shqetësim edhe për këtë? A ka mundur ndonjëherë drejtimi i PDK-së e LDK-së të sjellë produkt cilësor në RTK?

I keni pasur njëzetedy vjet kohë të tregoni se dini të punoni. Nuk e keni bërë. Sot ankoheni pse të tjerët punojnë. Nuk pranohet kjo, kolegë deputetë.

Një gjë e tillë, një projekt kaq i rëndësishëm siç është Festivali, nuk mund të realizohet vetëm se duke angazhuar profesionistë të shquar të fushave, duke i lënë të lirë në punën e tyre. Duke u ofruar mbështetjen e nevojshme, siç kemi bërë ne, e që juve po ju shqetëson kjo gjë.

Një gjë të tillë e kemi bërë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë me tërë qenien e kapacitetin tonë, për t'u ofruar qytetarëve tanë shërbim sa më cilësor nga transmetuesi publik. Ndoshta kjo ju shqetëson juve, por jo qytetarët. Andaj, diçka që nuk i shqetëson qytetarët, nuk e shqetëson as Lëvizjen Vetëvendosje e as Qeverinë Kurti.

Ju mbani shqetësimet tuaja, shprehini lirshëm ato. Edhe RTK-ja, sikurse edhe mediumet tuaja, do t'i transmetojnë këto fjalimet tuaja, sepse RTK-në nuk e kemi kapur ne, nuk e ka kapur askush, por vetëm e kemi çkapur nga ju. Puna nuk është kapje, puna ka produkt dhe shihet në dritë të diellit. Pra, për këtë arsye, ju shqetësimet tuaja mund t'ia thoni njëri-tjetrit, por ne nuk jemi të interesuar t'i dëgjojmë ato, e besa as qytetarët nuk janë. Prandaj, ne po shkojmë te ta e ju vajtoni mes vete pse nuk e keni të kapur RTK-në.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ju përshëndesim e mirë u takofshim në seancën e radhës.

KRYETARI: Në emër të komisionit, a do të flasësh?

Pasi drejt kaluam te grupet parlamentare, po vazhdojmë me PDK-në. Në emër të grupit, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Faleminderit, kryetar!

Për besë, po të mundja, do t'ia shtoja edhe dhjetë minuta këtij të flasë, këtë margaritar s'duhet hequr prej foltores. Ky është përfaqësuesi më i mirë, më i denjë i kësaj mendësie që e udhëheq sot Republikën e Kosovës.

Ky sot gjithë ditën duhet ta lëmë në këtë foltore, të rrijë, ta shohin qytetarët e Kosovës çfarë mendësie na udhëheq, çfarë mentaliteti, çfarë strukture politike, çfarë mendimi politik. Po, ishte kohë e shkurtër realisht tetë minuta sa doli, është dashur të rrijë e të bëjë replikë edhe pas kësaj.

Shihe, është për besë mjerim ta shohim qysh kryetari i Komisionit për Media në fakt nuk e di as funksionimin bazik të Radiotelevizionit të Kosovës. Anëtarët që kanë dhënë dorëheqje me ligj e kanë të obliguar të rrinë anëtarë të Bordit, edhe ata janë anëtarë funksionalë të Bordit, edhe ata që kanë dhënë dorëheqje, deri në momentin nëse Kuvendi i Kosovës, le të themi, i shkarkon apo u përfundon mandati. Edhe pse kanë dhënë dorëheqje, ata janë në detyrë. Pra, komplet bordi është në detyrë, edhe kryetari. Nëse ju nuk më besoni, hyni edhe në ueb-faqe të Radiotelevizionit të Kosovës, edhe i shihni emrat e tyre. Edhe të kryetarit që ka dhënë dorëheqje, edhe të zonjës tjetër, edhe të anëtarit tjetër. Pra, i keni anëtarë të bordit.

Prandaj, kërkesa e opozitës, që është prej korrikut, e që mazhoranca në çdo mundësi, në çdo mënyrë e ka prolonguar të mos vijë në votim, pra ka qenë pikërisht të ndodhë kjo prerje. Që ky bord të shkarkohet dhe Kuvendi i Kosovës ta emërojë një bord tjetër. Ne si opozitë, po ashtu jemi të vetëdijshëm që nuk i kemi as numrat dhe nuk mund ta emërojmë një bord të ri ne, por prapë është përgjegjësi e pushtetit kjo çështje, mirëpo të njëjtit nuk i kemi parë të arsyeshme që të mos reagojmë karshi atyre skandaleve të rënda, të cilat kanë ndodhur dhe kanë buruar pikërisht nga Radiotelevizioni i Kosovës, e që në fakt kanë rrezikuar jetën e diku gjashtëdhjetë gazetarëve në vendin tonë.

Edhe sikur të mos kishin ndodhur komplet krejt këto abuzime të tjera që i kemi parë prej Radiotelevizionit të Kosovës si i ndërpret seancat e jashtëzakonshme kur flet opozita, qysh i qet në një kanal periferik. Pra, qysh kur është Kryeministri dhe në të njëjtën kohë e kemi edhe seancën, përparësi ka Kryeministri dhe jo Kuvendi i Kosovës si institucioni më i lartë në një republikë parlamentare siç është Republika e Kosovës.

Radiotelevizioni i Kosovës është institucion që është i themeluar me ligj nga Kuvendi i Kosovës dhe përderisa jemi republikë parlamentare, përderisa s'e ndryshojmë sistemin, pra Kuvendi i Kosovës vazhdon të jetë institucioni më i rëndësishëm në vendin tonë dhe normalisht prioritet në transmetime për Radiotelevizionin e Kosovës do të duhej ta kishte Kuvendi, jo një ministër, jo Kryeministri, jo dikush tjetër. Megjithatë, kjo është më pak e rëndësishme.

Ajo që është më e rrezikshme, më e dëmshme dhe më e rënda, është pikërisht pra lajmi të cilin e transmeton Radiotelevizioni Kosovës nga një portal, pra prej Republika Serbe. Të jemi të qartë, pra lajmi që i nxjerr dy mediume që janë bashkëpunëtorë të regjimit të Vuçiqit e të Radojçiqit, me të cilin këta e kemi parë çfarë koordinimi dhe çfarë dashurie kanë pasur ndër vete. Lajmi na vjen prej Republika Serbe që këto mediume tona kinse qenkan argatë të Serbisë dhe të Vuçiqit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të bësh bashkëpunëtorë të regjimit dikë, në këto rrethana, në Republikën e Kosovës, ta bësh bashkëpunëtorë të Vuçiqit e të Radojçiqit, është t'ia kërcënosh direkt jetën nëse s'ke fakte për diçka të tillë.

Ne kemi fakte që e kemi parë znj. Kusari-Lila çfarë dashamirësie dhe çfarë afërsie ka me Radojçiqin, po nuk e kemi parë asnjë gazetar të Kosovës që ka një relacion të tillë me personat në fjalë. Pra, të nxirret një portal, të nxirret lajmi i një portali nga Republika Serbe, ku dy mediume i bën bashkëpunëtor të Serbisë, të UDB-së e Vuçiqit, për besë është skandaloze. Nga ai moment, në një rrethanë normale, në një shoqëri demokratike, ata s'do të duhej të vazhdonin as edhe një ditë të vetme punën e tyre në Radiotelevizionin e Kosovës.

Prej njëmbëdhjetë anëtarëve, d.m.th. që kryetari i Komisionit nuk e di as sa janë, prej tyre tre kanë dalë të jenë më të përgjegjshëm, e kanë ofruar dorëheqjen e tyre, por prapë janë në detyrë, sepse ligji e thotë ashtu.

Këtë e bën akoma më skandaloze faktin që ne nuk e kemi thënë as si opozitë, as mediat, e thotë vetë drejtori i Radiotelevizionit të Kosovës, zyrtari i Lëvizjes Vetëvendosje, e involvon Agjencinë Kosovare të Inteligjencës në një lajm të tillë. Thotë pra që lajmi ka ardhur informata nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës. Pra, këto çështje nuk i kemi thënë ne, as nuk kemi aluduar ne si opozitë. Pra, kjo ka ardhur prej pushteti, pra që në këtë rast është involvuar Agjencia Kosovare e Inteligjencës.

Çka ndodh më tutje? Agjencinë Kosovare të Inteligjencës e kemi të involvuar edhe në pretendimet e disa gazetarëve të tjerë, të cilët janë kritikë ndaj abuzimeve të pushtetit. Duke pasur parasysh krejt këtë situatë, normalisht ne nuk kemi ende asnjë qëndrim të qartë e të prerë nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës dhe cila është, a është e vërtetë që janë të involvuar në raste të tilla apo jo.

Nuk kisha dashur asnjëherë në jetën time të jetë diçka e tillë e vërtetë. Mirëpo, para fakteve, ne nuk mund të heshtim. Pra, sot ende nuk e kemi të qartë në rast se agjentët e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës janë të involvuar në përcjelljen e gazetarëve në vendin tonë dhe në prodhimin e këtij lajmi skandaloz, që prapë po e them, ua rrezikon jetën gjashtëdhjetë gazetarëve në vendin tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këtyre pretendimeve duhet vendosur një kapak. Kapaku është vetëm një hetim i thellë mbi punën e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Nëse diçka e tillë është e vërtetë, atëherë normalisht kjo agjenci tash e tutje nuk mund të funksionojë kështu. Nuk është fundi i botës. Ne në vitin 2021, nëse dikush e përcjell pak këtë sferën tjetër të sigurisë, në vitin 2021 ka ndodhur riorganizimi i Agjencisë së Inteligjencës në Austri, në një vend shumë të konsoliduar. Nëse ka involvime të tilla, kjo agjenci nuk mund të vazhdojë kështu.

Në anën tjetër, unë e kam edhe një çështje tjetër, që po dua t'u adresohem sot partnerëve tanë strategjikë. Pra, në këtë rast ambasadave të QUINT-it në vendin tonë. Unë për shkak të përvojës sime institucionale, pra gjashtëmbëdhjetë vjet përvojë pune në institucione, tetë prej tyre në Zyrën e Kryeministrit, kam goxha njohuri qysh është themeluar, qysh është ndërtuar puna e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Jo për përmbajtjen e tyre, mirëpo për ndërtimin e kësaj strukture.

Ne jemi të vetëdijshëm se si Kosovë nuk kemi arritur asnjë prej institucioneve të sigurisë t'i ndërtojmë vetë, as Policinë, as Ushtrinë, as AKI-në. Për Polici e Ushtri kemi më shumë

informacione, sepse kanë qenë më të hapura, janë më të hapura si natyrë e punës së tyre ndaj publikut. Ndërsa, për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës më pak, sepse puna e tyre është më larg syve të opinionit publik.

Cili është mandati i kësaj agjencie? Mbrojtja e sigurisë sonë kombëtare. A e kanë rrezikuar dy portalet tona sigurinë tonë kombëtare, që e kemi pasur të involvuar Agjencinë Kosovare të Inteligjencës? Kësaj duhet dhënë përgjigje një hetim penal në Republikën e Kosovës, një hetim penal i pavarur, ndoshta edhe me ndihmën nga jashtë.

Po dua të kthehem prapë te ambasadat QUINT-it.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e kemi pasur një mbështetje të madhe nga Ambasadat e QUINT-it në ndërtimin e kësaj agjencie. Edhe unë sot e kam një pyetje: qysh ndihen sot ambasadat e vendeve të QUINT-it, Gjermani, Francë, Britani, Itali, Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë investuar në këtë agjenci? Tash, nëse mjetet e tyre, apo njerëzit të cilët janë trajnuar nga ta përdoren nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pra për të shtypur një zë opozitar, për të minuar demokracinë në vendin tonë, qysh ndihen ata? Në rast se resurset e tyre e shteteve të QUINT-it përdoren sot për të cenuar zërin opozitar, për të cenuar e rrezikuar çdo zë, i cili është kritik ndaj pushtetit, qoftë ai gazetar, qoftë ai opozitë, qoftë kushdo tjetër, çfarëdo mediumi. Prandaj unë u kërkoj të gjithë këtyre që të marrin masa dhe të mos lejojnë që asetet e tyre të përdoren ta minojnë demokracinë tonë të brishtë.

Të nderuar kolegë deputetë,

U bëjmë thirrje të gjitha atyre ambasadave që të reagojnë. Pra, njerëzit të cilët janë trajnuar nga ta, mjetet të cilat janë sjellë nga ta, pra të mos lejojnë të përdoren ta minojnë demokracinë në vendin tonë. Kjo është e fundit me çka do të duhej të ndodhte në vendin tonë. Sot, normalisht pra gjithë këto vite pas çlirimit e pas shpalljes së pavarësisë e pas ndërtimit të institucioneve, asnjëherë s'kisha besuar që vjen një moment i tillë të kërkojmë një gjë të tillë. Mirëpo, sot po keqpërdoren asetet tona shtetërore për ta minuar një zë kritik në vendin tonë. Ky është minimi më i rëndë i demokracisë në vendin tonë.

Sa i përket kësaj punës së Agjencisë Kosovare të Inteligjencës...

A mundem edhe një minutë?

KRYETARI: Po ia shtoni pjesën e kohës së fjalën z. Tahiri, ju lutem, regjia, në foltore.

ABELARD TAHIRI: Ndërsa, sa i përket punës së Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, po ju them: nuk do të ndalemi derisa të kemi një hetim të thellë, të pavarur dhe të shohim involvimin e

kësaj agjencie në çështje të cilat janë ngritur në periudhën e fundit, në përcjelljen e gazetarëve, në prodhimin e këtij lajmi të rremë. Nëse janë të pavërteta, agjencia duhet të vazhdojë punën si institucion tepër i rëndësishëm, i pavarur dhe i pacenueshëm. Nëse janë të vërteta, agjencia nuk mund të vazhdojë të funksionojë kështu qysh është duke funksionuar, do t'i nënshtrohet, sot nëse jo, nesër pa çare do t'i nënshtrohet një riorganizimi. Njerëzit të cilët e kanë cenuar jetën e qytetarëve për shkak të kritikave të tyre ndaj pushtetit, për shkak që kanë ngritur çështje që kanë të bëjnë me abuzime nga pushteti, nuk e kanë vendin aty. Ata e kanë vendin para drejtësisë dhe drejtësia duhet të merret me ta. Faleminderit!

KRYETARI: Tash Lidhja Demokratike, kryetari i grupit, Arben Gashi flet.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Se cila është gjendja e Radiotelevizionit të Kosovës dhe e institucioneve publike në përgjithësi, dhe në veçanti e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe ligjore në Kosovë, e përshkruan më së miri fjalimi i kryetarit të Komisionit të Mediave. Ai doli e foli këtu dhjetë minuta e nuk e dinte çka është duke folur.

Pra, e mori fjalën të flasë në emër të komisionit parlamentar dhe prej fillimit në fund, fjalimin që ia kishin shkruar e kishte si anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje ose si përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje.

Por, le t'i kthehemi prapë pak se çka ka ndodhur me Radiotelevizionin e Kosovës në këto katër vjet. Me ardhjen në pushtet të Lëvizjes Vetëvendosje, me mentalitetin e tyre të kapjes së pushtetit dhe të shtetit, veprimin e parë që e bënë në këtë institucion të pavarur, ishte shkarkimi i Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

Normalisht, ky vendim ishte antikushtetues dhe u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga palët e dëmtuara. Gjykata Kushtetuese vendosi që shkarkimi është kundërkushtetues, por ata nuk u mërzitën për atë punë. Vazhduan me politizim dhe kapje të këtij institucioni, duke e çuar në Bordin e Radio Televizionit të Kosovës të gjithë personat me ngarkesë politike nga Lëvizja Vetëvendosje.

Si rezultat i politizimit dhe i nxjerrjes së lajmeve në Radio Televizionin e Kosovës me porosi nga Lëvizja Vetëvendosje dhe struktura jashtinstitucionale, të cilat e kontrollojnë Lëvizjen Vetëvendosje dhe pushtetin e saj, Radio Televizioni i Kosovës dështoi që të ofronte shërbimin e vet si institucion publik, dhënien e lajmeve dhe programit në interes publik.

Si rezultat i këtij dështimi, politizimi dhe kapjeje nga Lëvizja Vetëvendosje dhe personi kontrollues që kontrollon Lëvizjen Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës mori vendim

dhe refuzoi çdo pjesëmarrje në debate dhe emisione të Radiotelevizionit të Kosovës, një institucion publik.

Duke e pasur parasysh se ky institucion është institucion publik dhe ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik, pra është pronë e qytetarëve të Kosovës, do të duhej të mbronte dhe përfaqësonte interesin e qytetarëve të Kosovës.

Kur si rezultat i ndërhyrjes së Lëvizjes Vetëvendosje, kapjes së bordi, kapjes së politikës redaktuese dhe dhënies së lajmeve të pavërteta, u dëmtua interesi publik, u politizua institucioni, u shkatërrua besimi, ne refuzuam të jemi pjesë e kësaj ndërmarrjeje.

Prandaj, si grup parlamentar, si grup politik, si parti politike, si njerëz të përgjegjshëm të këtij vendi, ne vendosim që të mos marrim pjesë në programet e Radiotelevizionit të Kosovës, institucionit publik.

Por, ky institucion dhe këto vegla të tij nuk u ndalën. Vazhduan edhe më tej. Shkuan deri aty sa nuk kishte shkuar askush para tyre. Prodhuar informacione të rrejshme kundër kolegëve të tyre. Këto informacione të rrejshme kundër kolegëve të tyre u prodhuan dhe u shpërndanë në emër të një institucioni me rëndësi vitale për sigurinë e Kosovës, në emër të Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës.

Ky institucion, kjo agjenci nuk guxon dhe nuk duhet të përbaltet dhe të përfshihet në skandale të tilla. Ky problem i shkaktuar nga kjo qasje, i bazuar në këtë mentalitet të kapjes dhe të kontrollit, të prodhimit të informacionit të pavërtetë, ka rrezikuar jetën e qytetarëve të Kosovës, si gazetarë të Kosovës. Ka helmuar ambientin politik në Kosovë dhe ka dëmtuar rëndë dhe pariparueshëm besimin e qytetarëve të Kosovës dhe të partnerëve ndërkombëtarët, po e përsëris, të partnerëve ndërkombëtarë në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është institucion i cili mbledh informacion dhe këtë informacion e përpunon dhe e dërgon tek agjencitë e tjera ligjzbatuese, por punën e saj kryesore në aspektin e fushës së sigurisë nacionale e ka me partnerët ndërkombëtarë.

Imagjinojeni sa mund të jetë e besueshme një agjenci, e cila përfshihet në skandale të prodhimit të informacioneve të pasakta, qëllimshëm për dëmtimin e gazetarëve apo për krijimin e opinionit publik të rrejshëm. Një agjenci e tillë bëhet e pabesueshme për partnerët ndërkombëtarë, bëhet e pabesueshme për informatorët e mundshëm dhe bëhet e rrezikshme për qytetarët e Kosovës.

Si mund të lejohet që Agjencia e Kosovës për Inteligjencë të përdoret në interes të një grupi politik. Të prodhojë informacione të rrejshme në interes të një grupi politik. Të prodhojë informacione dhe të mbikëqyrë gazetarë dhe përfaqësues të mediave për interesa politike të një

grupi politik. Në këtë rast, të Vetëvendosjes, të kontrolluar nga personi i quajtur Dejona Mihali, person i cili tashmë është vërtetuar që kontrollon institucionet e pavarura ligjore dhe kushtetuese në Kosovë.

Por, këtu nuk ndalet ambicia e Lëvizjes Vetëvendosje dhe e veglave të saj për kontroll të informacionit dhe për përhapje të dezinformacionit. Në mbledhjen e fundit të Bordit, pa pasur kuorum, vendosi ta ndryshojë statutin e Radiotelevizionit të Kosovës për të emëruar një ushtrues detyre të drejtorit, sepse edhe zëvendës drejtori ka dhënë dorëheqje.

Përveç statutit, ndryshojnë pa pasur kuorumin e mundshëm, ndryshojnë edhe Rregulloret e Punës së Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, dhe aty paligjshmëria kap përmasa të frikshme. Paligjshmëria kap përmasa të kontrollit të informacionit dhe të kontrollit të programit të radiotelevizionit publik të Kosovës me qëllim të përdorimit të tij për interesa politike të një grupi politik, në këtë rast, të Lëvizjes Vetëvendosje.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuar gazetarë,

Ne e dimë se nuk ka më ekskluzivitet të lajmit vetëm në një institucion. Radio Televizioni i Kosovës është njeri prej institucioneve që prodhon lajme dhe programe, qoftë kulturore, artistike etj. në Kosovë. Por, përgjegjësia e tij është më e veçantë, sepse është institucion publik. Paguhet nga buxheti i shtetit. Është i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. I garantohet buxheti nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. E ka buxhetin më të madh se Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Dhe, e ka për detyrë ligjore dhe kushtetuese të mbrojë interesin publik, dhe jo interesin partiak të një partie politike. Mbrojtja e interesit partiak të një partie politike është e dëmshme për demokracinë. Përfshirja e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në prodhimin e informacionit dhe shpërndarjen e tij në favor dhe interes të një grupi politik, në këtë rast, të Lëvizjes Vetëvendosje, është e rrezikshme për demokracinë.

Humbja e kredibilitetit të kësaj agjencie përballë partnerëve ndërkombëtarë është e dëmshme për Kosovën. Dhe, mbi të gjitha, përcjellja e paligjshme nga kjo agjenci e gazetarëve në Kosovë është antikushtetuese, është antiligjore, është e dëmshme dhe duhet të ndalet menjëherë. Sepse koha po vjen, këto institucione do të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia shtoni edhe një minutë zotit Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm po e përfundoj. Koha po vjen, këto institucione do të mbajnë përgjegjësi penale. Personat përgjegjës që kanë monitoruar, prodhuar dhe shpërndarë informacione të pasakta dhe të pavërteta do të ndiqen penalisht. Do të shkojnë në burg.

Nuk është mirë të shkohet në burg për interesa të një partie politike apo të një individi që paligjshëm që i kontrollon këto. Ndërsa, Radio Televizioni i Kosovës është në paligjshmëri në totalin e tij dhe sidomos në funksionimin e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Kush flet në emër të AAK-së? Deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar,

Të nderur kolegë deputetë,

Media,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot dua t'ua rikujtoj që para katër vjetësh kur në qeverisje erdhi Qeveri Kurti, ky pushteti deshi që të rrënojë gjithçka që ishte ndërtuar për 20 vjet me mund dhe sakrificë nga të gjitha pushtetet, në koordinim edhe me faktorin ndërkombëtar.

Veprimet e para ishin shkarkimi, apo thënë ndryshe, gjuetia e Qeverisë Kurti ndaj të gjitha bordeve të institucioneve publike të shtetit të Kosovës. Një luftë të tillë të hapur ndaj institucioneve të Kosovës mund ta bënte vetëm një regjim, ku me apo pa arsye, qëllime, ishte shkatërrimi dhe përmbysja e çdo të arriture vetëm se ishte e popullit të Kosovës.

Ne po diskutojmë për RTK-në, institucionin publik më të rëndësishëm në Kosovë, i cili edhe pse i kaloi ditët më të vështira në kohën para dhe gjatë luftës me Serbinë, sot përballet me një luftë tjetër politike që i ka shpallur Qeveria Kurti. Po ua kujtojmë që Qeveria Kurti dhe ju si shumicë shkarkuat padrejtësisht Bordin e RTK-së më 8 korrik të vitit 2021, ku Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se Kuvendi ka vepruar pa bazë ligjore në kontekst të shkarkimi të bordit në tërësinë e tij, si pasojë e refuzimit të raportit përkatës vjetor dhe rrjedhimisht në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për RTK-në. Pra, Kuvendi ka tejkaluar kompetencat kur e ka shkarkuar Bordin e Radio Televizionit të Kosovës.

Madje, sipas Kushtetueses, Kuvendi me këtë vendim ka cenuar pavarësinë e transmetuesit publik, roli i të cilit thotë se është thelbësor për lirinë dhe pluralizmin e mediave në një shoqëri demokratike.

Nëse hyjmë në materie se ku gjendet dhe si funksionin RTK-ja nën qeverisjen Kurti, tani po numërojmë disa të vërteta të pamohueshme. Po jua kujtojmë që bordi dhe udhëheqja e emëruar nga ju dështoi në menaxhim, funksionimin dhe zhvillimin e RTK-së.

Po jua kujtojmë që kurrë RTK-ja nuk ka qenë më dobët. Po jua rikujtojmë që kurrë RTK-ja s'ka qenë më e kontrolluar nga politika dhe Lëvizja Vetëvendosje. Po jua rikujtojmë që kurrë raportet e auditimit s'e kanë nxjerrë më keq RTK-në se në Qeverinë Kurti.

Po jua rikujtojmë që kurrë punëtorët e RTK-së s'kanë qenë më të nëpërkëmbur e pa të drejtat e tyre. Po jua rikujtojmë që kurrë gratë punëtore të RTK-së s'kanë pasur më shumë presion, gjuhë kërcënuese dhe seksiste. Po jua rikujtojmë që RTK-ja nuk po punën me program të vet, por me program të Lëvizjes Vetëvendosje.

Po jua rikujtojmë që RTK nuk ka nxjerrë në ekran gjëra që kërkojnë dhe u duhen qytetarëve të vendit, por nxjerr gjerë që kërkohen dhe vijnë nga politika, e konkretisht nga Lëvizja Vetëvendosje.

Po jua rikujtojmë që në RTK kurrë nuk ka pasur më pak hapësirë për gazetarët profesionistë. Po ua rikujtojmë që RTK është televizioni i propagandës së Lëvizjes Vetëvendosje dhe nuk është i qytetarëve të Kosovës.

Po jua rikujtojmë që RTK që katër vjet nuk është është Radiotelevizioni i Kosovës, por është Radiotelevizioni i Kurtit. Mbi këto fakte e më shumë të tjera që nuk i përmenda, Kosovës, qytetarëve dhe RTK-së si institucion publik që paguhet dhe funksionon nga perceptimi i qytetarëve të Kosovës nuk i duhet një bord që kontrollohet dhe keqpërdor mediat, gazetarët, fjalën e lirë dhe lajmet e vërteta.

Ky bord dhe kjo udhëheqje e RTK-së, e dirigjuar nga Qeveria Kurti, me plot kuptimin e fjalës duhet të shkarkohet sa më parë, sepse nuk i bën mirë as medias dhe as demokracisë së vendit. Ne e kemi parë që edhe pse Kuvendi është themelues i RTK-së, kur kemi shkuar si deputetë për t'u treguar që "jeni politizuar", neve na është mbyllur dera dhe nuk ka ekzistuar asnjëherë një sjellje e tillë që nuk i lejon deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të hyjnë brenda. Ja ku e ka sjellë politika këtë institucion publik, prandaj ne me të drejtë jemi të shqetësuar për ndikimin politik në RTK. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Grupi Multietnik, fjalën e ka kërkuar deputetja Fidan Zhilla.

FIDAN JILTA: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë,

Fjalimin do ta bëj në gjuhën shqipe që të kuptohet nga të gjithë dhe të gjejmë një zgjidhje sa më shpejt.

Në fjalimin tim do të fokusohem që në mënyrë të detajuar t'ju prezantoj problemin dhe kërkesën e redaksisë turke në RTK, Radio Kosova. Problemi i redaksisë është që nga muaji janar deri në

qershor tre gazetarë bartës të kësaj redaksie do të dalin në pension, kurse kërkesa e redaksisë është që të punësohen së paku tre gazetarë të rinj, për të mundësuar vazhdimësinë e programeve në gjuhën turke në Radio Kosovë. Programi në gjuhën turke, i cili transmetohet çdo ditë të javës nga ora 16:00 deri në orën 18:00 në programin e dytë të Radio Kosovës, vazhdon të jetë burim më i besueshëm i lajmeve të komunitetit turk në Kosovë. Pavarësisht problemeve në mediat turke në Kosovë, programi në gjuhën turke në Radio Kosovë në vazhdimësi po hedh hapa të vendosur për t'u zhvilluar brenda kësaj kornize.

Nga vlerësimet e audiencës, e cila përcjell programin në gjuhën turke të Radio Kosovës, konkludohet se stafi i programit në gjuhën turke nuk bën kurrë kompromis për punën e tyre parimore dhe krijuese për të arritur të dëgjuesit me lajmet më të besueshme dhe transmetimet më cilësore. Siç mund të mbani mend, 25 vjet më parë Kosova hyri në një epokë krejt tjetër dhe të re si në aspektin mediatik, ashtu edhe në përgjegjësi. Me fillimin e një epoke krejt tjetër në kuptimin e gazetarisë dhe transmetimit, redaksia turke si shkollë e transmetimeve radiofonike turke në Kosovë ka ndërmarrë një mision shumë të rëndësishëm për të vazhduar transmetimin e radios turke, i cili ka qenë gjithmonë në nivelet më të larta në Kosovë që nga viti 1951.

Por, vazhdimësia e punës kualitative gjithherë ka qenë elementi kyç në relacion me audiencën. Nga janari deri në qershor këtë vit tre gazetarë të programit turk do të dalin në pension, për të vazhduar traditën 73-vjeçare të programit turk të Radio Kosovës, u bë e detyrueshme rekrutimi i gazetarëve të rinj, së paku tre gazetarë. Redaksia turke në RTK, Radio Kosovë, me shpresë që do të zgjidhet problemi, para disa muajve ka paraqitur gjendjen aktuale me stafin e redaksisë në të gjitha instancat e menaxhmentit të RTK-së, drejtorit të radios, drejtorit të përgjithshëm së Bordit të RTK-së, por zhvillimet në RTK, dorëheqjet e drejtorëve të përgjithshëm, dorëheqja e kryetarit dhe disa anëtarëve të bordit, me të gjitha parimet e të dorëhequrve, statusi i stafit të redaksisë turke në Radio Kosovë ka mbetur ende i pazgjidhur.

Pasi që Kuvendi i Kosovës është edhe themeluesi i RTK-së, kërkoj që të iniciojë me urgjencë që të mundësohet hapja e konkursit për pranimin e tre gazetarëve të rinj për redaksinë turke në RTK, Radio Kosovë. Kërkesë kjo, të cilën lirisht mund të definojmë si kërkesë e detyrueshme, me të cilën do të arrihet mundësia e vazhdimësisë së programit cilësor të redaksisë turke në RTK, Radio Kosova. Mendoj se pranimi i gazetarëve të rinj sa më shpejt do të ishte shumë e dobishme, për arsye që të kishin mundësinë të aftësohen me rrjedhën e menaxhimit të programit, me trajnimet nga ana e stafit, i cili është në largim. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Isak Shabani, nga PDK-ja.

ISAK SHABANI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur media,

Bordi i RTK-së ka lejuar që gjatë mandatit të tij të shfaqen një sërë problemesh të mëdha administrative dhe menaxheriale, të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme financiare dhe kanë ngritur shqetësime serioze për funksionimin e këtij institucioni.

Për ato që janë publike dhe për të mos i përsëritur parafolësit nga opozita, është e qartë që kjo qeveri jo vetëm që i “ka shti” duart në RTK, por i “ka shti duart deri në bërryla” në punën menaxheriale të RTK-së, edhe pse RTK-ja do të duhej të ishte institucion i pavarur. Kemi pasur shumë dorëheqje duke u nisur nga anëtarët e Bordit, kemi pasur dorëheqje të drejtorit të RTK-së, kemi pasur dorëheqje të zëvendës drejtorit dhe stafit tjetër, kemi pasur premtime për të dërguar në diplomaci drejtorin e RTK-së, kemi pasur emetime të lajmeve të rreme të paverifikuara, kemi pasur deklarime për përfshirjen e AKI-së, e shumë e shumë pakënaqësi të tjera të panumërta.

Të nderuar të pranishëm, këtu u përmend meritokracia, kam qenë disa herë pjesë e panelit intervistues të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, Vetëvendosja në zhargonin e saj gjithëherë thirret në parime, por në realitet kjo nuk ndodh pothuajse asnjëherë gjatë aktivitetit të tyre në praktikë. Po e përmend vetëm një rast absurditeti: anëtarët e panelit intervistues nga VV-ja kanë vlerësuar kandidaten më të përgatitur të intervistuar me vetëm një pikë, edhe pse ajo, për dallim nga të tjerët, kishte përvojën, përgatitjen më të lartë akademike dhe kishte punime të shumta në konferenca ndërkombëtare, certifikata të shumta të panumërta sa që po të lexonim CV-në e saj të plotë me siguri do të na merrte krejt kohën e planifikuar për intervistim. Kurse anëtarët nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes e vlerësonin këtë me njësh. Për çka? Për të vetmen arsye, sepse kur Bordi raportonte para Komisionit Parlamentar për Media, ajo tregonte për parregullsitë që po ndodhnin në RTK, që më vonë, të gjitha këto që i ka thënë ish-anëtarja e Bordit të RTK-së para komisionit, u vërtetuan edhe në raportin e auditimit.

Këta jo vetëm që shkelin parimet, ligjet, Kushtetutën, po këta edhe ofendojnë dhe luajnë me inteligjencën e qytetarëve të Kosovës. Po e përmend edhe një rast: ne si panel intervistues, kandidatët që faktikisht, anëtarët e Bordit që sot kanë dhënë dorëheqje njëherë nuk i kemi kaluar në komision. Çka ka ndodhur? Kanë ardhur anëtarë të tjerë dhe kur kanë ardhur këtu në Kuvend, mazhoranca nuk ka pranuar t’i zgjedhë, se nuk kanë shkuar të preferuarit e tyre.

Çka ka ndodhur? Përsëri është shpallur konkursi dhe herën e dytë kanë votuar, kanë ardhur këta kandidatë apo këta anëtarë të bordit, të cilët kanë dhënë dorëheqje. Shtrohet pyetja, pse gjithë ajo punë e angazhim për të çuar anëtarët e bordit, kurse në fund këta japin dorëheqje. S’kanë mundur me siguri t’u përballojnë presioneve.

Unë do të përmend tetë arsye pse duhet shkarkuar Bordi i RTK-së:

1. Në dështimin e Bordit të RTK-së, Inspektorati i Punës ka vendosur gjoba mbi tridhjetë mijë euro kundër menaxhmentit, të cilat janë shkaktuar gjatë mandatit të këtij bordi. Bordi ka lejuar

shkelje të tilla, duke mos marrë masa të duhura për të kontrolluar dhe parandaluar këto keqpërdorime nga ana e menaxhmentit.

2. Në menaxhimin e dobët të Bordit janë hapur shumë lëndë gjyqësore që vazhdojnë të jenë në proces, ndërsa disa prej tyre tashmë kanë përfunduar në favor të punonjësve në shkallën e parë. Këto raste dëshmojnë një dështim të qartë të Bordit për të mbikëqyrur dhe adresuar në kohë problemet menaxheriale brenda institucionit.

3. Bordi i RTK-së ka dështuar të sigurojë angazhimin e plotë të anëtarëve të tij, duke lejuar që një anëtar të qëndrojë më shumë se gjashtë muaj në Qipro dhe tre të tjerë në dorëheqje të vazhdojnë të marrin paga duke marrë ose jo pjesë në mbledhjet online.

Për t'iu përshtatur këtyre rrethanave, Bordi ka amendamentuar Rregulloren të paktën katër herë, edhe pse kjo bie në kundërshtim me Ligjin e RTK-së. Tash, së fundmi edhe statuti për t'ia përshtatur dikush vetvetes.

4. Bordi i RTK-së ka lejuar keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga menaxhmenti i lartë. Udhëheqësi i shërbimeve të përbashkëta, i emëruar më 13 tetor 2022, si udhëheqës i shërbimeve të përbashkëta përfitoi shumë prej 3 200 euro mëditje gjatë vizitave në Bruksel e Japoni. Përveç mbulimit të shpenzimeve e të tjera.

Bordi nuk ka treguar gatishmëri për të ndaluar keqpërdorimet e detyrës zyrtare të menaxhmentit të lartë. Ndërkohë që i apostrofuari ka dhënë dorëheqje pa kontribuar me ato njohuri në institucionin RTK, edhe pse trajnimi ishte i dedikuar për staf dhe jo për menaxhment.

5. Përmes mosrespektimit të procedurave dhe kriterëve, Bordi i ka lejuar emërimet e kontestuara në pozitat menaxheriale. Një zyrtar i lartë i Policisë së Kosovës është emëruar si udhëheqës i prokurimit, pavarësisht mungesës së përvojës menaxheriale të nevojshme, duke shkaktuar kundërshtime brenda RTK-së.

6. Bordi i RTK-së ka ndërhyrë në mënyrë të papërshtatshme në vendimmarrjen menaxheriale, përfshirë emërimet në pozita të larta dhe vendimet e tjera që tejkalojnë kompetencat e tij.

Ish-zv. drejtori i RTK-së, Adi Krasta, ka deklaruar publikisht se ishte i ftuar nga nënkryetarja e Bordit, znj. Arta Berisha, për të aplikuar në një pozitë menaxheriale, çka tregon për një interferim të drejtpërdrejtë nga ana e Bordit.

7. Bordi ka lejuar dhe favorizuar emërimet nepotike në pozitat e larta. Emërimi i ndihmësdrejtorit në RTK2, një pozitë fiktive, me pagë mujore 1 400 euro, ka treguar qartë mungesën e mbikëqyrjes efektive të procedurave dhe rregullave nga Bordi. Pasi që ky person u

pozicionua si drejtor i radios, pozita fiktive përsëri mbeti e paplotësuar. Kjo tregon se kjo pozitë, edhe pse ishte fiktive, e shpikur, ishte shfrytëzuar vetëm për atë që personi në fjalë të marrë një pozitë më të lartë menaxheriale.

8. Dështimi i Bordit për të mbikëqyrur menaxhimin e fondeve publike është evidentuar edhe në Raportin e Auditimit për vitet 2022 e 2023.

Keqpërdorimet e zbuluara në këto raporte përfshijnë shuma të mëdha që kapin vlerën qindra-mijëra euro, duke treguar nevojën urgjente për ndërhyrje dhe reforma në menaxhmentin e RTK-së.

Të nderuar të pranishëm,

Kur vendet me përgjegjësi mbushen nga ata që nuk kanë fituar me meritë, institucioni fillon të humbasë shpirtin e tij. RTK-ja ka humbur shpirtin. Kur parimet etike shkelen, media nuk është më gardian i të vërtetës, por bindëse e mashtrimit. Faleminderit!

KRYETARI: I japim tash fjalën deputetit Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Ne sot po flasim për Radiotelevizionin e Kosovës në bazë të kërkesës së deputetëve të PDK-së, por unë dua ta zgjeroj diskutimin edhe në disa çështje që lidhen me këtë temë që po e diskutojmë sot.

RTK-ja është institucion i pavarur që ka për mision informimin e drejtë dhe të paanshëm të publikut dhe financohet nga taksat e qytetarëve. Institucion tjetër me rëndësi, AKI-ja, që për qëllim të mbrojtë sigurinë kombëtare, prodhon informacionet e nevojshme për të gjitha institucionet shtetërore, që cenojnë, për situata që cenojnë sigurinë kombëtare. Institucioni i tretë, auditori i jashtëm, i cili tash mbikëqyr rregullsinë e shpenzimit të parasë publike.

Është fakt që në javët e fundit ka pasur informata të bazuara që puna e këtyre tri institucioneve vitale është cenuar. Është cenuar, po mendoj pavarësia e punës së këtyre tri institucioneve. Është komprometuar puna e këtyre tri institucioneve të pavarura. Te RTK-ja përmes informatave, në bazë të raportimeve, që AKI-ja e ka detyruar, i ka dërguar informata përmes kanaleve të tjera. Pra, siç është raportuar, të transmetohen në RTK.

Çka na jep kjo të kuptojmë? Na jep të kuptojmë që një institucion publik që ka për qëllim informimin e drejtë dhe të paanshëm, është bërë pjesë e agjendës me të drejtë ose pa të drejtë të AKI-së për luftën hibride etj.

Kjo formë e funksionimit të institucionit të RTK-së si institucion publik për informim të paanshëm, ka funksionuar vetëm në sistemet e kaluara. Prandaj, është cenuar dhe është komprometuar misioni i Radiotelevizionit të Kosovës. Mos të harrojmë, Radiotelevizioni Kosovës e ka buxhetin të përafërt ose më të madh sesa Kuvendi i Kosovës. Financohet nga taksat e qytetarëve. Nuk është bërë asnjë veprim për të pavarësuar financimin e RTK-së gjatë këtij mandati.

Edhe nëse e marrim si të mirëqenë që ka qenë keq edhe në të kaluarën, edhe në qeveritë e kaluara, s'kanë pasur mundësi ato Qeveri që të shkojnë përpara me pavarësimin financiar të RTK-së, asnjë hap s'është ndërmarrë gjatë këtyre katër vjetëve. Të rishikohet Ligji i RTK-së, të ndërtohet skema e financimit dhe të kalojë financimi i RTK-së jashtë buxhetit të Kosovës përmes pagesave që duhet t'i bëjnë drejtpërdrejtë qytetarët e vendit.

Te AKI-ja, është skandaloze të shihet drejtori i AKI-së duke ia pamundësuar raportimin e tij në komisionin parlamentar përkatës. Edhe për këtë çështje se si agjentë të saj ndoshta me të drejtë kanë përcjellë gazetarë të caktuar. Po ata duhet t'i tregojnë komisionit parlamentar që gazetari i caktuar e ka rrezikuar sigurinë kombëtare. Ose ndoshta janë duke ia mbrojtur jetën ai gazetari, po duhet treguar atij gazetari që ne po të përcjellim për të siguruar jetën tënde, sigurinë fizike të gazetarit. Publiku nuk e di. Ndoshta publiku edhe s'mund të dijë të gjitha veprimet e AKI-së, po komisioni përkatës parlamentar duhet t'i dijë. Është pamundësuar raportimi i drejtorit të AKI-së në këtë komision.

Skandali i fundit, që prapë lidhet me financat publike, edhe me buxhetin e RTK-së, javën që shkoi, me një e-mail apo mesazh është përmirësuar Raporti i Auditorit të jashtëm për buxhetin e shtetit. Raporti vjetor për auditimin e buxhetit të shtetit për vitin 2023. Merreni me mend, këto raporte të Auditorit nuk prodhohen nga një person i vetëm. Qysh në fillim të vitit bëhet komisioni i auditorëve të Zyrës së Auditorit të Jashtëm, që i marrin informatat e nevojshme. E prodhojnë një raport. Ai raport shkon në Zyrën e Auditorit të Jashtëm. Kur rishikohet, para se të nënshkruhet, ai raport i shkon Ministrisë së Financave për të dhënë opinionet para se të bëhet publik.

Pra, kalon nëpër tri-katër duar, jo vetëm të individëve, por të grupeve të individëve që janë përgjegjës. A mendoni ju që krejt këtyre grupeve u ka kaluar ky lëshim teknik pa e parë? Prandaj, po them është komprometuar puna e këtyre tri institucioneve të pavarura, te RTK-ja për informimin e drejtë, tek AKI-ja dhe tek Auditori i Jashtëm. Prandaj, bie besimi i publikut në punën e këtyre tri institucioneve dhe në tria këto institucione përgjegjësi ka ky Kuvend.

Sot nuk e kemi as Qeverinë, ministrat përkatës e kryeministrin për të dhënë përgjigje në këto çështje që ngrihen nga deputetët, po s'e kemi as mazhorancën këtu për të debatuar për këto çështje. Ja në çfarë gjendje kemi ardhur. Faleminderit!

KRYETARI: Besnik Tahiri e ka kërkuar fjalën kryetari i Grupit të AAK-së.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë nga tri partitë opozitare,

Qytetarë të Kosovës,

Më lejoni edhe një herë të sjell në rikujtim atë që po e themi në secilën seancë të jashtëzakonshme, në trajtimin e temave me interes jo vetëm qytetar e publik, por në rastin konkret edhe kombëtar, kemi një mungesë, kemi një zhvlerësim të temës, patëm një komunikim nga një deputet, i cili me detyrë e lëshoi seancën parlamentare dhe ne sot debatojmë dhe flasim me qytetarët e Kosovës, si subjekte politike tash të shumicës edhe nga të gjitha sondazhet, në mënyrë që të trajtojmë të vërtetën.

Kolegu Lekaj i përmendi disa çështje, të cilat nuk do të doja t'i ripërsëris, mirëpo dua t'i sjell tek vëmendja e secilit qytetar që beson në liri, në demokraci dhe që beson në shtetin e Republikës së Kosovës, si çështje të cilat janë rreziqe të mëdha, të cilat duhet t'i kemi parasysh.

E para, ka të bëjë me minimin e shtetit. Një shtet e bën të lirë dhe demokratik vetëm atëherë kur fjala e lirë respektohet dhe transmetohet përmes mediave dhe në veçanti përmes televizionit publik, i cili i jep llogari këtij Kuvendi, e ne u japim llogari qytetarëve të Kosovës. Është totalisht e papranueshme që lajmi i rrejshëm të bëhet normë në një institucion të pavarur të publikut, pra televizionit publik të Kosovës. Lajmi i rrejshëm, i cili për hir të së vërtetës ka mundur dhe mund të rrezikojë gazetarët, të cilët përfaqësojnë portale dhe agjenci të lajmeve, e të cilat për një kohë të gjatë ishin pjesë e linçimit publik. Për më keq, në bazë të dhënave që janë bërë publike pjesë e kësaj teme përfshihet edhe agjencia, i cili do të duhej të ishte siguresa e mbrojtjes kombëtare dhe plasimi i të vërtetës dhe po ashtu të paralajmërimit të hershëm për tema dhe jo të jetë burim i një informacioni të rremë.

Ndikimi në RTK nga institucione, të cilat nuk kanë asnjë lidhje as me gazetarinë, e as me fjalën e lirë dhe bërja e tyre pjesë e lajmit të rrejshëm, nuk ka as emër, as mbiemër tjetër, përveçse minimin e shtetit të Kosovës.

Çështja e dytë lidhet drejtpërdrejt me logjikën që ne e kemi trajtuar tash e sa kohë në këtë Kuvend, të logjikës parti-shtet. Shihet shumë qartë që tendenca për ta shkarkuar jashtëligjshëm Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës qëllimin kryesor e ka pasur ndërtimin e konceptit dhe logjikës parti-shtet, pra një dritare e informimit publik të kthehet në një platformë të një partie, e cila do ta mbyhtë zërin opozitar, duke e ndalur dhe seancën plenare dhe duke e zhvendosur në kanalet, të cilat jodomosdoshmërisht janë në interes të qytetarit.

Shkarkimi i bordit dhe ndikimi i politikave të institucionit për të cilin po flasim nga bordi tek menaxhmenti është çështja e dytë që e konfirmon logjikën parti-shtet. Të gjithë gazetarët,

profesionistë, të cilët mbi dy dekada apo edhe më herët janë pjesë e këtij institucioni publik janë përndjekur, larguar, zhvlerësuar dhe sot shkuarja në punë e njerëzve që punojnë në RTK është tortura më e madhe që i bëhet një punëtori të Radiotelevizionit të Kosovës, për shkak se ata po ndihen jo që janë duke shkuar në vendin e tyre të punës, në institucionin e pavarur të qytetarëve të transmetuesit publik të Radiotelevizionit të Kosovës, por janë duke u ndier që po shkojnë në një institucion që është dorë e zgjatur e partisë që sot udhëheq. Pra, logjika parti-shtet e rrezikon në esencë funksionimin e demokracisë.

Çështja e tretë dhe e fundit, por jo nga rëndësia që sot dua ta plasoj në Kuvend është sulmi dhe sulmet e njëpasnjëshme që u bëhen institucioneve të pavarura. Javën e kaluar në Komisionin për Legjislacion ishte për raportim Këshilli i Pavarur i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil dhe i shihja si flisnin kolegët deputetë nga Vetëvendosja, e ata ishin iniciuesit e shkarkimit të atij bordi kundërligjshëm.

Pra, sulmet ndaj institucioneve të pavarura kanë për qëllim zhvlerësimin e logjikës dhe kontrollit të një shteti ligjor, rrezikojnë në masë të madhe lirinë e fjalës së lirë dhe, së fundi, po ashtu sulmet ndaj institucioneve të pavarura i konfirmojnë edhe mosfinancimi i këtyre institucioneve. Në qoftë se shkoni dhe e vizitoni televizionin publik, shihni që aty nuk ka asnjë investim të vetëm, investimi i vetëm i kësaj qeverie me logjikën parti-shtet, që po e minon shtetin e Kosovës në lirinë dhe fjalën e lirë ka qenë vetëm në kapjen e këtij shteti përmes ndikimit politik dhe logjikës parti-shtet. Është për keqardhje dhe është e dënueshme fakti që sot nuk kemi as përfaqësuesin nga kryeministria, as nga ministria, as nga kolegët deputetë të thonë një fjalë ndryshe. Mirëpo, në secilën fatkeqësi, ka edhe një fat, dhe fati është që qytetarët e Kosovës ditë pas dite po e shohin se kulminacioni i mashtrimit dhe kulminacionit të logjikës parti-shtet po i vjen fundi, fundi është më 9 shkurt. Faleminderit!

KRYETARI: Rashit Qalaj flet tash.

RASHIT QALAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Të dashur qytetarë,

Shumë të nderuar dhe të respektuar punonjës të Radiotelevizionit të Kosovës, ju që me vite jeni pjesë e familjeve tona, juve që me zërin tuaj sollët në shtëpitë tona, në shtëpitë e qytetarëve të Kosovës lajme të shumta gëzimi, zhvillimi, lajme të ndryshme për punën, për institucionet, për vendin, po edhe lajme pikëllimi, meqenëse e tillë është jeta.

Juve që me vite e vite na informuat për të gjitha ato që ndodhën në Kosovë dhe rreth Kosovës, edhe në kohën kur u suprimua çdo gjë, e disa prej jush vazhduat të na informoni jo nga selia ku ishte vendi i punës tuaj, po kudo që mundet të gjeni një pajisje për të informuar qytetarin e

Kosovës, për zhvillimet e atëhershme, për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për bombardimet e NATO-s, e kështu me radhë. Juve që na informuat edhe nga kjo sallë kur u shpall Pavarësia e Kosovës, juve që në vazhdimësi në shtëpitë tona sollët lajmin për ndërtimin, zhvillimin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Dhe, sot fatkeqësisht duke ju kërkuar falje juve, që me mund e djersë e mbajtët Radiotelevizionin e Kosovës si njërin ndër institucionet më të besuara të këtij vendi, sot po flasim për dështimet, keqpërdorimet, keqmenaxhimin dhe, çka është më keq, shfrytëzimin e institucionit publik për një parti, e cila më së paku ia do të mirën këtij vendi. Këtë po e dëshmon me veprime, me vendime dhe me mospraninë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Fatkeqësisht, jo fort moti mediumi i Radiotelevizionit të Kosovës u përdor për të dhënë një lajm që na doli të ishte i rremë, për gjoja rrezikimin e jetës së Kryeministrit të Kosovës në vendin fqinj tonin, në Maqedoninë e Veriut. Dhe, kjo ndodhi menjëherë pas fiaskos që Kosova përjetoi në Këshillin e Sigurimit, ku për fat të keq, për herë të parë në historinë e Kosovës, në Këshill të Sigurimit u bënë bashkë Lindja dhe Perëndimi, miq dhe armiq të Kosovës në kritika ndaj Republikës së Kosovës për veprimet e njëanshme që ata i quajnë që Kosova i ndërmori në Kosovë. Është hera e parë që në Këshillin e Sigurimit Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe miqtë tanë folën me ton të ashpër dhe me kritika ndaj Republikës së Kosovës. Dhe të nesërmen ndodhi ajo që ndodhi nëpërmjet mediumit publik e me përfshirjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës u përhap lajmi që jeta e kryeministrit të Kosovës në Maqedoninë e Veriut është në rrezik vetëm për të mbuluar fiaskon, për të manipuluar me qytetarë dhe për të mbuluar turpin që përjetuam në Këshillin e Sigurimit.

Dhe, nuk mjaftoi kjo. Ky medium i shenjtë publik i Republikës së Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës, u përdor prapë për të sulmuar mediat e tjera e gazetarë të ndryshëm, prapë duke e përfshirë Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, duke e dëmtuar skajshmërisht një institucion të sigurisë, vital, shumë të rëndësishëm për këtë vend dhe, për fat të keq, për të bërë edhe më keq përdoret një burim i dyshimtë i një mediumi boshnjak të Republikës Srpska, të Miloran Dodikut, njeriut i cili është njëri ndër armiqtë më të mëdhenj të kombit shqiptar në përgjithësi. E paramendojeni mediumi ynë publik sulmon kolegët e saj, duke u bazuar fatkeqësisht në një burim armiqësor ndaj Republikës së Kosovës dhe për më keq përdoret prapë institucioni i cili duhet përdorur gjithmonë në mbrojtje të këtij shteti, Agjencia Kosovare e Inteligjencës dhe ky përdorim i AKI-së vazhdon fatkeqësisht edhe më tej nga zyrtarët e Radiotelevizionit të Kosovës, të cilët fatkeqësisht sot gjenden dhe menaxhojnë me RTK-në.

Ne si shoqëri në përgjithësi jemi duke parë që ky vend është duke shkuar drejt një humnere mediale, ku më nuk zgjidhen mjetet nga shtëpia kryesore publike, Radiotelevizioni i Kosovës, për të sulmuar, degraduar mediat tjera, të cilat ndoshta edhe mund të gabojnë. Absolutisht nuk ka një njeri sot i cili mund të mos gabojë, qoftë gazetar, qoftë politikan, qoftë polic, qoftë ushtar, qoftë punëtor, janë njerëz dhe njerëzit mund të gabojnë, ama të përdorësh mediumin kryesor

Radiotelevizionin e Kosovës që të shigjetosh, të targetosh gazetarë me emra të përveçëm, kjo është e pafalshme, e kundërligjshme dhe kjo duhet të dënohet nga të gjithë ne, nga gjithë populli i Kosovës. Dhe, çka sot? Sot mungon prapë partia në pushtet, mungon këtu në Parlamentin e Kosovës që të diskutojmë për diçka që është tepër, tepër e rëndësishme: informimin e drejtë të popullit të Kosovës.

Pra, po flasim për lirinë e shprehjes, lirinë e mediave, të cilën pushteti po e kufizon, po e rrezikon duke përdorur RTK-në dhe ajo që dëgjuam nga njëri nga deputetët që kinse foli në emër të komisionit, por në fakt foli në emër personal, është e papranueshme për shkak e nuk tha asgjë, foli të pavërteta, foli atë që flasin këta gjithë që kanë mbetur me këto karrige të zbrazura, karrige bosh, e që besoj që më 9 shkurt do të jenë edhe më bosh, për shkak se nuk do të jenë në Parlamentin e Kosovës. Ky popull ka hequr të zitë e ullirit që të ketë media të lira, të pavarura, të cilat informojnë drejt për atë që ndodh edhe kur është mirë, edhe kur është sukses, pa sukses, ne duhet ta dimë sidomos këtë e presim nga mediumi publik.

Dhe, nuk mjafton që të flitet vetëm kur e kemi kryeministrin në një aktivitet, por gjithmonë duhet të pasqyrohet puna e Kuvendit të Kosovës, për shkak se është obligim ligjor. Paramendojeni edhe pse këtu nuk u përmend që atë ditë u mbyllën edhe dyert e Radiotelevizionit të Kosovës për deputetët e opozitës, të cilët së bashku vendosëm të shkojmë dhe të protestojmë në hapësirat publike të radiotelevizionit publik të Kosovës.

U mbyllën nga menaxhmenti, duke i detyruar punëtorët, punonjësit fizikë që ta mbyllin derën. Po e mira është që pushtetet vijnë dhe shkojnë, besoj që pushteti do të shkojë shpejt dhe s'do të kthehet më kurrë, nuk do të jetë kurrë më udhëheqëse e këtij shteti kjo parti, e cila edhe ashtu po dëshmon që nuk dëshiron të qëndrojë në Kuvend, po dëshmon që asnjë ministër nuk ndjek punimet e Kuvendit, dhe po dëshmon që nuk ka qenë e denjë që të udhëheqë me këtë shtet për katër vjet gati sa është në pushtet.

Të dashur qytetarë, më lejoni që t'u bëj thirrje punonjësve të Radiotelevizionit të Kosovës, atyre që me mund e krijuan këtë shtëpi të informimit publik që të vazhdojnë dhe të punojnë me nder dhe të mos pranojnë që të bëhen pjesë e vendimeve, kërkesave të paligjshme, antikushtetuese të një pushteti që po e shkel Kushtetutën për çdo ditë të punës në këtë vend. Edhe një herë kërkoj që Radiotelevizioni i Kosovës të jetë në krye të detyrës dhe të informojë publikun për të gjitha ngjarjet që ndodhin në Kosovë dhe në mënyrë jo të njëanshme, po ashtu edhe siç duhet të informohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Tash po ia jap fjalën deputetes Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Singerisht vetë kjo pamje e sallës sot dhe jo vetëm sot, po prej që ka filluar ky sesion parlamentar tregon më së miri ikjen nga përgjegjësia të Lëvizjes Vetëvendosjes, sepse janë në ankthin dhe në frikën e dështimit që i ka kapluar ngado që shkojnë dhe kudo që ndalen.

Valon Ramadani i instruktuar nga Dejona Mihajli ndër të tjerash në këtë foltore tha “po mundoheni ju që ne të dukemi si ju”, se këta kanë qejf të luajnë kështu me lojë fjalësh, domethënë për qytetarët gjoja se po mundohet PDK-ja ta bëjë Vetëvendosjen të duket si PDK-ja. Po le të harrojmë Vetëvendosja, se e para, ne kurrë s’duam të dukemi si Vetëvendosja, e këta kërkojnë të duken si PDK-ja, por për t’u dukur si PDK-ja, duhet t’u bien rrobat tamam. Këta s’kanë bërë asnjë punë të vetme, për t’u dukur këta si PDK-ja, duhet folur për 2 mijë kilometra autostradë, e këta mund të flasin për urën e Saradranit, e për ata nuk mund të duken si PDK-ja. Për t’u dukur këta si PDK-ja, duhet të flasin për 160 çerdhe, e këta s’kanë mundur as 4 qysh duhet t’i bëjnë. Për t’u dukur si PDK-ja, këta duhet ndërtuar një 100 shkolla për një mandat qysh i ka bërë PDK-ja, e këta s’mund t’i bëjnë.

Për t’u dukur si PDK-ja, këta është dashur ta mbajnë premtimin që ua kanë dhënë të moshuarve që do t’i bëjnë pesë shtëpi të kujdesit për të moshuar, e që kurrë s’i kanë bërë, e për t’u dukur si PDK-ja, këta është dashur t’i bëjnë edhe 400 pedagogë, e psikolog, e punëtorë socialë nëpër shkolla që i kanë premtuar e nuk i kanë bërë. Për t’u dukur si PDK-ja, këta është dashur minimalisht një njohje për pesë vjet të garantonin për këtë shtet, e që s’kanë mundur ta bëjnë. Prandaj, këta kurrë s’mund të duken si PDK-ja. Do të duken gjithmonë si një qeveri shtetshkatërruese, si një qeveri e dështuar në fuqinë më të madhe politike që ia ka dhënë ky vend.

Të kthehemi në temë, skandali i drejtorit të Televizionit të Kosovës, Rilind Gërvalla, aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje që implikon AKI-në në rastin e sulmit të RTK-së, ndaj dy mediave në Kosovë, e dje doli e demantoi veten tha që AKI s’ka qenë e përfshirë, e ka dëmtuar jashtëzakonisht e tmerrësisht shumë AKI-në, këtë institucion vital për sigurinë e vendit tonë. Dhe, kjo gjë nuk guxon të lejohet të vazhdohet edhe më tutje, kjo praktikë duhet të ndërpritet njëherë e mirë dhe unë prej kësaj foltore pa u dashur të lëshohem në detaje, meqë kjo seancë është publike, dhe unë e di shumë mirë sensitivitetin që ka kjo çështje, dua vetëm një fjalë t’i them Lëvizjes Vetëvendosje, qoftë Dejona Mehalit, qoftë mashave të tjera: larg duart nga AKI-ja, sepse nuk ju garantoj që në seancën tjetër të dal të flas emër për emër për secilin dështim dhe për secilën ndërhyrje që po tenton Lëvizja Vetëvendosje ta kapë AKI-në. Informacionet që vijnë nga RTK-ja tregojnë që Dejona Mihali emëron e shkarkon stafin e RTK-së dhe udhëheq de facto RTK-në. Asnjë veprim në Radiotelevizionin e Kosovës nuk bëhet pa aprovimin e saj, e kur të themi pa aprovimin e saj, ta keni të qartë, pa aprovimin e Albin Kurtit, sepse ai e ka zgjedhur

rrugën më të lehtë e më të shkurtër për të mos pasur qasje ose të humbë kohë të merret me secilin, e ka emëruar një servile, e ka emëruar një njeri, i cili është e dyshimtë, një njeri të cilës ia ka ndaluar ky shtet të hyjë në Kosovë.

Presioni dhe ndërhyrja e kryetarit të bordit nëpër komisionet e rekrutimit të kandidatëve për pozita udhëheqëse, Besnik Boletini kishte detyruar të tërhiqet nga kandidaturat tri kandidate për tri pozita udhëheqëse, të cilat kishin marrë pikët maksimale nga komisionet vlerësuese, sepse direktivat nga Lëvizja Vetëvendosje ishin për të zgjedhur personat politikë në ato pozita. Kapitulli XIX i Kodit Penal të Republikës së Kosovës i ka paraparë disa nene që i kushtohen cenimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës, ku parashihen dënime me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Më saktësisht, neni 219 thotë: Kushdo që i mohon apo u kufizon personave të tjerë të drejtën në punësim në kushte të njëjta, ashtu siç është përcaktuar me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

RTK është paditur nga shumë punëtorë të RTK-së për degradime e largime të paligjshme nga puna. Po konstatojmë, ose po supozojmë, që ata do të dalin të pafajshëm dhe RTK është e detyruar që t'i kthejë ata persona në vendet e tyre të punës. Merreni me mend se sa do t'i kushtojë buxhetit të RTK-së ky degradim e ky keqmenaxhim që e ka bërë.

Raporti i Auditorit për vitin 2023 RTK-në e vlerëson me opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, për qytetarët, opinion i kualifikuar jepet kur janë keqmenaxhuar e keqpërdorur financat. Bazat për konkluzion të kualifikuar: RTK kishte lidhur kontratë për shërbime teknike për Festivalin e Këngës në RTK në vlerë 90 600 euro, me çmim jo siç kishte njoftuar në dosje të tenderit, si dhe ishte nënshkruar 43 ditë me vonesë pas njoftimit të autoritetit kontraktues. RTK në tri procedura të prokurimit, me vlerë së bashku 119 376 euro, kishte përdorur shkurtimin e afateve kohore për pranimin e dosjeve të tenderit, të cilat ishin në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 të Prokurimit Publik. RTK kishte lidhur kontrata për furnizim me kamera PTZ dhe pajisje përcjellëse në vlerë 53 090 euro, edhe pse operatori ekonomik nuk kishte ofruar dëshmi të qartë ashtu siç ishte kërkuar në dosje të tenderit. Nën katër, RTK kishte dobësi në kontratën për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese në kompensim në vlerë 55 mijë euro, duke ndryshuar kushtet dhe çmimin e kontratës.

Nën gjashtë, do të them disa nga pjesët e auditorit për vitin 2022: keqmenaxhimi i procedurave të prokurimit, RTK ka nënshkruar kontrata të paligjshme, të cilat së bashku kapin vlerën rreth 500 mijë euro gjatë vitit 2022. Në disa raste janë anashkaluar procedurat e prokurimit të parapara me Ligjin e Prokurimit Publik.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka konstatuar se procedurat janë kryer në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit, raste të tilla konkrete janë: kontrata për Lojërat Olimpike Pekini 2022, 92,354 euro. Menaxhmenti i RTK-së ka nënshkruar kontratë për blerjen e Lojërat Olimpike Pekini 2022 pa

respektuar asnjë procedurë të prokurimit, madje as procedurën e negocimit të paraparë me Ligjin e Prokurimit Publik.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka konstatuar se është anashkaluar në tërësi Ligji i Prokurimit Publik dhe Rregullorja e RTK-së për vepra audiovizuese, e cila në raste të tilla parasheh procedurën e negocimit.

Kontratën me Reuters, 171 540 euro. Në projeksionin buxhetor, RTK kishte paraparë vijë buxhetore shfrytëzimin e formave të lajmeve për nevojat e RTK-së vetëm 17 mijë euro. Nëse menaxhmenti i RTK-së e ka zhvilluar një procedurë prokurimi duke u bazuar në këtë vijë buxhetore për t'i marrë lajmet nga Reuters, e ka tejkaluar buxhetin për njëmijë për qind, pasi që kontrata me Reuters është 171 540 euro. Është zhvilluar procedurë e negociuar, kur dihet se ka pasur shumë agjenci të njohura që ofrojnë lajme.

Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e vet konstaton shkelje ligjore në këtë rast dhe kontrata për sigurimin e objekteve 174 mijë euro. Kontrata për sigurimin e objekteve të RTK-së nuk ka qenë e paraparë fare në projeksionin buxhetor. Kjo kontratë nuk ka qenë fare as në planin e prokurimit që paraqet shkelje ligjore. Janë shpenzuar 174 mijë euro për këtë kontratë, ndërsa sa është efikase kompania e jashtme në ruajtjen e objekteve të RTK-së, u pa në aksionin e PSD-së, ku personi hyri në RTK pa u vërejtur fare nga siguri dhe shkon drejt e një studion e lajmeve në kohën e lajmeve qendrore. Ndërsa, RTK ka shpenzuar 174 mijë euro për kompanitë e jashtme dhe i ka larguar nga puna sigurimin paraprak, në kohën e të cilëve nuk mbahet mend që dikush ka hyrë në RTK pa u identifikuar. Edhe këtu Zyra e Auditorit ka gjetur shkelje.

Për të gjitha këto...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia shtoni edhe një minutë znj. Musliu!

GANIMETE MUSLIU: ...Për të gjitha këto gjetje, Bordi i RTK-së nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, prandaj duhet të shkarkohet.

Unë dua edhe një herë të thërras qytetarët e Republikës së Kosovës, ta shohin sjelljen e Lëvizjes Vetëvendosje gjatë këtij sesi. I ka rrokur paniku dhe nuk kanë fytyrë të dalin as para deputetëve, as para mediave dhe as para qytetarëve. 9 shkurti është dje. Për Vetëvendosjen, 9 shkurti dje ka filluar, jo më 9 shkurt, siç është në kalendar.

KRYETARI: Fjalën tash e ka deputeti Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Para se të flas, dua ta them faktin që kjo mazhorancë ka zgjedhur një formë të pandershme dhe shumë të keqe për t'i ikur përballjes me temat që vetë i kanë prodhuar gjatë këtyre katër vjet qeverisjeje, duke filluar prej rezervave të shtetit, për të cilën i kanë ndërruar edhe hetuesit që të mos mund të japin efektin e duhur, pastaj energjisë që vazhdon edhe më tutje si krim i organizuar dhe nuk janë penalizuar personat e apostrofuari në këtë aferë. Përgjimet pastaj që janë faktuar në format me zë dhe me të gjitha faktet e mundshme. Bile, i kisha bërë thirrje Vetëvendosjes që Mimozen ta hetoni, se po më duket është duke koketuar me partitë e opozitës, sepse ajo ka thënë këtu se do të ketë fotografi kur këta kanë marrë dhurata e kanë shkëmbyer dhurata, e nuk janë duke u qitur. Fakti se nuk po i qet, është duke i ruajtur këto parti, me të cilat ka qeverisur pothuajse prej 2000 e këndej. Kështu që, keni kujdes, se është rrezik për ju.

Pastaj ushtria, e cila po ashtu vazhdon të mbetet në të njëjtën gjendje, duke improvizuar formën e përgatitjes së ushqimit, me atë sistemin e vetëqëndrueshmërisë, një ide revolucionare, e cila mendoj se nëse si e tillë vazhdon dhe është ndesh me analizën profesionale që e kanë bërë ekspertët amerikanë për rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë, atëherë shumë shpejt do të na detyrojë që të harxhohet rruga e zhvillimit të procesit të krijimit të Forcave të Armatosura të Kosovës dhe tani po vazhdohet me dëmtimin e shëndetit të tyre, duke improvizuar ushqim pa kalori, pa kualitet, besa duke cenuar edhe sigurinë e tyre shëndetësore.

Më herët, përfaqësuesi i VV-së i bëri do deklaratë që mua më befasuan, d.t.th. dëshmoi se ende kjo kastë politike nuk është e vetëdijshme se i ka fituar zgjedhjet dhe e ka pushtetin, që nga tetori 19 pra ka mundur ta ndryshojë komplet strukturat, siç i ka bërë dhe i ka kapur. Tash të arsyetohet se edhe te RTK-ja po u udhëheqka ende nga strukturat e Qeverisë së kaluar, është non sens. Unë nuk besoj që kjo kauzë do të pijë ujë sa u përket zgjedhjeve.

Ne jemi këtu sot për të diskutuar një çështje që shkon përtej vendimit për shkarkimin e Bordit, apo një ndryshimi strukturor që unë mendoj se Bordi duhet ta bëjë para se të shkarkohet, pra në menaxhmentin e televizionit.

Ne po diskutojmë për pavarësinë, integritetin dhe të ardhmen e mediumit publik të Kosovës, pra Radiotelevizionit të Kosovës. Ky institucion i cili ka detyrën të informojë qytetarët në mënyrë të paanshme, të pavarur, po vuan nga mungesa e përkrahjes dhe nga ndërhyrjet politike që kanë komprometuar punën e tij dhe kanë hyrë në një arenë të propagandës për përçarjen e shoqërisë deri te edhe cenimi i sigurisë kombëtare. Por, fajtor për këto abuzime mendoj se janë edhe institucionet e kontrollit të demokracisë, duke përfshirë edhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, edhe Ombudspersonin, por edhe Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut.

Më parë, kur kam qenë unë pjesë e Bordit diku 13-15, me përkrahjen e krejt partive që jeni këtu, përfshirë edhe LVV-në, se më kanë konsideruar shumë të mirë dhe korrekt në këtë punë, kishte një financim diku, mbaj mend ka qenë 11 milionë euro, edhe pse s'ka qenë i mjaftueshëm. Por, një buxhet i cili tashmë ishte zvogëluar në 8 milionë. Kjo ulje e financimit është një goditje e drejtpërdrejtë për profesionalizmin dhe pavarësinë editoriale të këtij mediumi. Më pak financim d.t.th. më pak burime për të mbështetur gazetarinë cilësore, për të avancuar në aspektin teknologjik dhe për të përmirësuar kapacitetet e transmetimit.

Si pasojë, RTK është bërë gjithnjë e më pak i aftë për t'i shërbyer si duhet publikut të Kosovës dhe për të ndjekur zhvillimet moderne në media, duke e humbur kështu besueshmërinë dhe shikueshmërinë.

Nga ana tjetër, zgjedhja e drejtorëve të RTK-së ka ndjekur një prirje alarmante të ndërhyrjeve politike dhe ndikimeve partiake. Drejtuesit e RTK-së nuk janë përzgjedhur për meritat profesionale apo për angazhimin e tyre ndaj gazetarisë së pavarur, por shpesh për lidhjet e tyre politike. Ky ndikim i drejtpërdrejtë e ka minuar funksionin e RTK-së si medium publik, duke e kthyer atë në zgjatim të interesave të grupeve të caktuara. Për pasojë, qytetarët ndihen gjithnjë e më të dekurajuar dhe e humbasin besimin në një institucion që e ka mision të informojë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Gjithashtu, RTK ka dështuar në avancimin e tij teknologjik, duke mbetur pa standarde moderne të transmetimit dhe duke e humbur konkurrencën me mediat e tjera. Në vend që të përqendrohet në rritjen e cilësisë dhe modernizim, RTK është bllokuar nga mungesa e burimeve nga ndikimet politike, duke e shndërruar në një institucion të stagnuar që nuk arrin të përmbushë misionin e tij publik.

Mungesa e investimeve dhe modernizimi ka sjellë rënie të shikueshmërisë dhe besueshmërisë në institucionin kryesor medial. Stërkeqja më e madhe është luftimi i mediave të pavarura publike me lajme intriguese, inteligjente dhe konspirative. Kjo po lexohet si tendencë e dhunimit të fjalës së lirë edhe mediale, një standard i kërkuar në botën demokratike. Por, mua kjo nuk më ka befasuar, sepse unë e shoh si doktrinë qeverisëse të qeverive të majta e totalitare, që mjet për arritjen, kapjen dhe mbajtjen e pushtetit e kanë propagandën. Aq më tepër, se kjo politikë që prej hyrjes në qeverisje, në çdo veprim dhe vendim politik, që prej hyrjes në qeverisje, d.m.th. tetor i vitit 2019 e deri më sot e ka falimentuar shtetin e Kosovës në çdo fushë, edhe ekonomike, edhe zhvillimore, edhe politike, por edhe të sigurisë.

U dëshmuar dhe u demonstrua para të gjithë qytetarëve dhe aleatëve se qeverisjen e kanë të koordinuar me Beogradin. Në agjendën e tyre politike për ta zhbërë institucionalisht dhe kushtetutshmërisht shtetin e Kosovës. Këta tani po e pranojnë edhe vetë me patriotizmin patetik që po e shfaqin në raport me detyrimet që kanë marrë në dialog, përmes të cilit e kanë kthyer

Serbinë në Kosovë, thoshte ish-kryetari i partisë dhe i Kuvendit, z. Veseli, qoftë me pasaportat paralele, qoftë me këtë departamentin ligjor në Beograd për ndjekjen e neve që nuk e pranuam Serbinë si okupatore. Për këtë, secili nga ne dhe nga këta që janë në Qeveri dhe në Kuvend, mos të harrojnë se koketimet tradicionale me shërbimin e Serbisë janë të evidentuara dhe mbajnë dosje.

Veprimi i koordinuar me segmente të inteligjencës institucionale të Kosovës është një alarm i kuq për sigurinë kombëtare, andaj këtu duhet veprim institucional.

Të gjitha këto çështje janë arsye pse ky Kuvend duhet ta mbështesë propozimin për shkarkimin e anëtarëve aktualë të Bordit të RTK-së. Nuk është thjesht një ndryshim në struktura, por një përpjekje për të rikthyer integritetin, profesionalizmin, transparencën e këtij institucioni. Ne kemi nevojë për një RTK të pavarur, që t'u shërbejë qytetarëve e jo grupeve politike. Për një RTK që nuk kufizohet nga mungesa e financimit, por që mbështetet në burime të qëndrueshme për të garantuar gazetari cilësor me teknologji moderne.

Ftoj të gjithë kolegët, edhe ata që s'janë këtu, që të mbështesim këtë ndryshim si një hap përpara për të siguruar që RTK të rikthehet në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe të përmbushë misionin e tij si një burim i besueshëm dhe i paanshëm i informimit publik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën po ia jap tash deputetes Albana Bytyqi.

ALBANA BYTYQI: I nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Sot jemi mbledhur këtu për të adresuar një situatë të papranueshme dhe shqetësuese, transmetuesi publik, RTK, po transformohet në një armë propagande të partisë në pushtet, në shërbim të Lëvizjes Vetëvendosje dhe jo të qytetarëve të këtij vendi.

RTK-ja, një institucion që duhet të jetë gardian i të vërtetës, sot është kthyer në një makinë shpifjesh që kërcënon gazetarinë e lirë dhe që përpiket t'u mbyllë gojën mediave të pavarura.

Çfarë po ndodh? Në vend që RTK të sjellë lajme të besueshme, shërben për të përhapur dezinformata të orkestruara nga pushteti për të sulmuar e diskredituar mediat e respektuara të këtij vendi, duke i paraqitur pa turp si instrumente të huaja.

E dini çfarë ndodh kur fjala e lirë shkatërrohet nga politika? Ndodh që qytetari nuk ka më besim. Ndodh që i gjithë vendi, ky popull që ka kaluar kaq shumë për liri e drejtësi, mbetet pa zë dhe pa një platformë të vërtetë për të dëgjuar të vërtetën.

Bordi i RTK-së nuk ka bërë asgjë për të ndalur këtë kapje të pamëshirshme. Ata janë pajtuar në heshtje me këtë përdorim të turpshëm të RTK-së, duke e lejuar Qeverinë, gjegjësisht Lëvizjen Vetëvendosje të kontrollojë një institucion që duhet t'u përkasë qytetarëve.

Kjo nuk është vetëm një shkelje e ligjit. Është abuzim me besimin tuaj, me paratë tuaja, me të drejtën tuaj për informim.

Qytetarët e Kosovës,

Është momenti të kuptoni se çfarëdo që po ndodh në këtë vend dhe m 9 shkurt ta vlerësoni vetë. Ky transmetues publik nuk është më zëri juaj, është bërë mjeti i propagandës së Qeverisë. Ju paguani për një RTK që duhet t'ju shërbejë juve, por në realitet është kthyer në një megafon të atyre që nuk duan ta dëgjojnë zërin e së vërtetës.

Si përfaqësuese e qytetarëve, i kërkoj Kuvendit dhe çdo deputeti këtu që të mbrojmë fjalën e lirë dhe t'i japim fund këtij abuzimi të paprecedent. Shkarkimi i Bordit të RTK-së është vetëm hapi i parë. Nuk do të ndalemi derisa RTK të kthehet te qytetarët, aty ku e ka vendin dhe t'u shërbejë vetëm atyre, jo partive politike, jo interesave të ngushta, por të vërtetës dhe publikut të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Hajdar Beqa tash e ka radhën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot kjo seancë, respektivisht kjo pikë që është propozuar për shkarkimin e Bordit të Radiotelevizionit të RTK-së, konsideroj se është e rëndësishë së veçantë, duke e pasur parasysh se Radiotelevizioni i Kosovës është institucion publik me rëndësi të posaçme kulturore dhe kombëtare, i cili ofron shërbime publike në fushën e veprimtarisë së Radiotelevizionit të Kosovës.

Ne e dimë, por duhet ta dinë edhe qytetarët, por edhe menaxhmenti aktual, edhe Bordi i drejtorëve që Radiotelevizioni i Kosovës është themeluar nga institucioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është institucion publik. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka obligime për të mbështetur Radiotelevizionin e Kosovës edhe me buxhet, edhe për t'i siguruar kushte për të vepruar, po në të njëjtën kohë edhe për ta mbikëqyrur përmes trupave të saj, që mos të ketë interferime politike, siç e patëm rastin kur e merr guximin një bord, një menaxhment, dhe e mbyll derën që të mos lejojë të hyjnë në oborrin e Radiotelevizionit të RTK-së themeluesit e saj, në këtë rast që është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Unë mendoj që kjo përveçse është e turpshme, është e papranueshme dhe asgjë tjetër të mos ndodhë atje, ata duhet të shkarkohen dhe duhet të japin përgjegjësi edhe morale, edhe juridike, edhe penale.

Përveç kësaj që thashë që atje kanë bërë veprime jo të mençura, për mendimin tim, e tha kolegja paraprake Ganimete Musliu një pjesë të Raportit të Auditimit, pasqyrat financiare për 2023, kam pasur rastin dhe ende nuk e kemi diskutuar në Komision për Mbikëqyrje të Financave, por ka ardhur Raporti i auditorit dhe e kemi parë me vëmendje. E ka një opinion, është opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2023, që i bie që është një raport i keq, është një menaxhim i keq atje.

Auditori, ndër të tjera, nuk dua t'i ngarkoj tani qytetarët, e ka arsyetuar bazën për opinion të kualifikuar, ka shumë çështje që kanë ndikuar në opinionin e kualifikuar, por RTK nuk ka bërë as rivlerësimin e pasurive për të siguruar se vlera e atyre punëtorëve nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë e rivlerësimit në fund. Për 134 pasuri në vlerë prej 677 767 euro e kanë regjistruar me vlerë zero, edhe pse ato asete ende janë aktive dhe janë në përdorim që i shërbejnë RTK-së dhe nuk ka pasur një komision të mirëfilltë që ta bëjë një regjistrim të mirëfilltë të pasurive. Ka edhe pasuri të tjera. Po e përmenda një pjesë me një vlerë më të madhe.

I përmendi deputetja Musliu dobësitë gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, d.t.th. vetëm në pesë raste janë mbi gjysmë milioni keqpërdorim dhe keqmenaxhim i parasë publike. Nuk do t'i përmend tash cilët janë tenderët, sepse s'dua të përsëris Ganimeten, por ka dobësi edhe te pronësia e padefinuar e RTK-së. Këtë e ka edhe në vitet paraprake.

Ne e dimë që RTK-ja e kryen veprimtarinë e vet në një objekt, i cili i bie përfitime RTK-së, por nuk ka asnjë dokument. Thuhet që ka një marrëveshje me AKP-në, te AKP-ja nuk ekziston asnjë dokument që AKP-ja ia ka dhënë në shfrytëzim RTK-së për ta shfrytëzuar këtë objekt. Nuk paguan qira për askënd dhe mendoj që këtu ka obligim edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës që t'ia sigurojë një objekt RTK-së apo këtë objekt ta bëjë zyrtar, që mos ta lejojë që RTK-ja të jetë si uzurpatore, derisa nuk ka dokumente, nuk paguan qira, nuk e qet në libra të aseteve këtë dokument, atëherë i bie që është duke e shfrytëzuar ilegalisht dhe për këtë konsiderohet se është përgjegjës edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, si themelues i institucionit përkatës, Radiotelevizionit të Kosovës.

Unë desha në vija të trasha t'i them edhe disa mangësi të cilat i ka thënë auditori. Kemi mangësi shumë në procesin e rekrutimit për stafin e rregullt. Të gjitha këto ndodhin për shkak që komisioni përgjegjës nuk i ka përfillur me kujdes procedurat e seleksionimit, verifikimit dhe dokumentacionit të aplikuesve, vlerësimin dhe përzgjedhjen e tyre. Kemi raste kur një kandidat është ftuar për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit, edhe pse data e formularit nuk i përkiste

periudhës së procesit të rekrutimit. D.m.th. është ftuar në intervistë, edhe pse s'ka qenë pjesë e konkursit dhe është zgjedhur.

Kemi raste në bazë të testit, kur për një pikë vlerësohet me dhjetë poenë, edhe pse ka qenë e përmbushur ajo pikë e saktë, komisioni për ta favorizuar një kandidat tjetër, e ka vlerësuar me notën zero, me poenin zero. Kemi shumë raste d.m.th. nuk është vlerësuar, është njëfarë te testi aty sipas çelësit, te testi me shkrim, te përgjigjet e sakta me nga dhjetë pikë, d.m.th. ka dallim te kandidatët të cilët kanë qenë të preferuar të Bordit dhe të atyre që kanë qenë jo të preferuar. Nuk po dua t'i përmend cilat pozita, po në disa raste kur auditori është marrë me shqyrtimin e dosjeve sheh parregullsi shumë në rekrutim të stafit. Nuk po flas për ushtrues detyre, sepse kemi shumë ushtrues detyre. Ka presion politik nga bordi, edhe nga ish-kryetari që ka dhënë dorëheqje, që edhe më herët, do të thotë edhe për vetin 2022 ka qenë një gjendje prapë e keqe e menaxhimit të RTK-së.

Unë kam komunikim edhe me shumë punëtorë atje, që me të vërtetë kanë një presion të paparë nga bordi përmes individëve të caktuar që tash po i shohim dhe në fytyrat e tyre po shfaqet edhe përmes përgjimeve, siç e patëm rastin e Dejonës e të tjerëve që janë direkt të ndikuar nga kryeministri në shkuarje, zoti Albin Kurti.

Dhe, ka shumë të gjetura të tjera atje që mendoj që pasi tani publikohet edhe zyrtarisht, Zyra e Auditimit e ka publikuar Raportin e Auditimit për vitin 2023 për RTK-në. Këtu përveçse ka keqmenaxhim të parasë publike, ka vend për vepra penale. Ka vend që të merren institucionet përkatëse. Të merren krimet ekonomike. Të merret Prokurori i Shtetit edhe sipas detyrës ex officio, sepse me të vërtetë kemi shumë shkelje.

Ishte një rast i tenderit që e shpjegoi deputetja paraprake, ku përfituesi, pasi ta lidhë kontratën, i rritet vlera për shkak se thonë ia shton edhe TVSH-në, e cila do të duhej të ishte e kalkuluar para se të fitohet tenderi dhe ka shumë të gjetura të tjera.

Andaj, unë mendoj që më së paku që duhet të bëhet është të shkarkohet ky bord, apo fillimisht, po të ishin pak më kredibilë dhe me integritet, ata do të duhej të jepnin dorëheqje. Shkarkimi i tyre i bën nder institucionit në të cilin janë atje, Radiotelevizionit të Kosovës, por në të njëjtën kohë i bën nder edhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ne po e shohim që mazhoranca aktuale ka ikur nga përgjegjësitë që i ka marrë në zgjedhjet e kaluara dhe jam shumë optimist që qytetarët do të ikin nga këta njerëz, të cilët nuk mund të bartin përgjegjësi më tutje.

Edhe një herë, kërkoj që nëse nuk vijnë deputetët e mazhorancës që ta shkarkojnë bordin aktual, kërkoj prej anëtarëve, nëse kanë vetëm pak kredibilitet dhe integritet, të japin të paktën

dorëheqje, ta lirojnë vendin dhe të mos fshihen pastaj sikur të tjerët, pasi po japin dorëheqje po tregojnë për presionin që e kanë nga Qeveria aktuale. Faleminderit!

KRYETARI: Tash flet Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë të cilët jeni të zëshëm në këtë pjesë,

E pamë edhe kolegët tanë deputetë që ikin nga përgjegjësia, fatkeqësisht dhe nuk është hera e parë. Janë me dhjetëra raste që i ikin përgjegjësisë, ndoshta edhe me qindra raste që i ikën përgjegjësisë Vetëvendosja, duke mos u ballafaquar me kritikën dhe duke i ikur debatit dhe përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Fatkeqësisht, ne po duhet t'i gremë këto tema të cilat ndoshta nuk janë të këndshme për Vetëvendosjen. Nuk janë të këndshme për Qeverinë. Por, besoj që më të vështirë e kanë vetë qytetarët që ballafaqohen me këto probleme. Më të vështirë e kanë edhe vetë gazetarët, stafi i RTK-së që ballafaqohet me këto skandale.

Sigurisht, edhe shumë institucione të tjera, siç është Ushtria e Kosovës që e ka të vështirë të ballafaqohet me sfidat që i shfaqen, si në rastet kur ushtarët e kësaj ushtrie e kanë të vështirë të punojnë në institucionin e tyre kur nuk ka uniformë, veshmbathje, çizme apo ushqime që nevojiten për të punuar në atë institucion.

Ashtu e ka të vështirë çdo institucion, ku neve si Kuvend na raportojnë dhe ankohen që ka shkelje të jashtëzakonshme edhe të të drejtave të njeriut. Ka shkelje të jashtëzakonshme edhe të ligjit, edhe të Kushtetutës.

Çfarë të flas kur shumica e deputetëve i ngritën shumicën e temave. Po e ngre zërin sidomos për ata deputetët e Vetëvendosjes që na dëgjojnë përmes ekranit të televizionit, e që i ikin ballafaqimit, që të vijnë dhe të ballafaqohen këtu, sepse ata janë votuar këtu për të dhënë llogari dhe për ta përmirësuar jetesën në Kosovë.

Nuk janë votuar në Kuvendin e Kosovës që t'i ikin debatit dhe të fshihen pas skutave të ndryshme të Kuvendit të Kosovës. Ata janë votuar në Kuvend të Kosovës, nuk është votuar Dejana Mihali. Nuk është votuar Dejana, e as nuk është emëruar nga Kuvendi i Kosovës. Nuk është emëruar as nga Qeveria që të marrë përgjegjësinë dhe të emërojë dhe të zgjidhë çështje të ndryshme që u takojnë institucioneve legjitime të vendit.

Kjo është një parapolitikë. Kjo është një vepër kriminale që duhet të japin llogari të gjitha institucionet që janë involvuar dhe sidomos përgjegjësitë apo krerët e këtyre institucioneve.

Fatkeqësisht, ne e dimë shumë mirë se sa është dëmtuar RTK-ja. Meqenëse jam edhe anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media, e di mjaft mirë dhe jam i informuar shumë sa u përket shkeljeve të mëdha të RTK-së.

Paramendojeni se si tenton ta rrisë frikën dhe kërcënimin ndaj RTK-së, duke ia zvogëluar edhe buxhetin e saj. Duke e shtypur edhe atë zërin kritik brenda RTK-së, që kur ta largojë buxhetin i largoi disa profesionistë gazetarë nga puna, sigurisht që edhe shumë të tjerë e kanë frikën që ta ngrenë zërin.

Por, besoj që ne e dimë shumë mirë që gjithmonë aty ku është bërë zullum dhe është munduar t'i tërhiqet vërejtja dhe të shtypet një popull, vazhdimisht ka pasur njerëz, ka pasur karaktere të fuqishme, profesionistë të guximshëm që e kanë ngritur zërin dhe kanë dalë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, së pari të drejtës ligjore dhe kushtetuese.

Ne e dimë shumë mirë që RTK-ja ka shkelur të drejtat e shumë punëtorëve aty brenda, por e dimë edhe një gjë që vetë Qeveria, siç thashë edhe më herët, përveç largimit të buxhetit, ku nga 14 milionë, 13 milionë sa ka qenë, e ka sjellë në 8,5 milionë, sigurisht që e ka lënë anash këtë medium, duke e bërë që të jetë i varur nga politika dhe kryesisht nga pushteti i Vetëvendosjes.

Televizioni i Kosovës po shihet qartë që është kthyer në televizion të Albin Kurtit dhe Dejana Mihalit. Sigurisht që ne si përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, si zë i qytetarëve, nuk i lejojmë dhe ne do t'i mbajmë për llogari të gjithë ata që janë të përzier në këto marrëveshje antikushtetuese antiligjore.

RTK-ja edhe ashtu nuk ka menaxhuar mirë me situatën brenda RTK-së, ku përmes degradimit i ka marrë shumë dënime nga Inspektorati i Kosovës, dhe jo vetëm, por edhe nga institucione të tjera dhe të gjykatës së Kosovës.

Ne, sigurisht që edhe për këto gjëra kërkojmë llogaridhënie dhe nuk do të ndalemi derisa të japin përgjegjësi.

E përmendën edhe deputetët parafolës çështjen e implikimit të institucionit të Inteligjencies së Kosovës. Është e turpshme. Është antikushtetuese dhe sigurisht që duhet të japin llogari, nëse jo sot, nesër gjithsesi.

Prandaj, ne u bëjmë thirrje të gjithë atyre që janë në këto institucione të japin dorëheqje, por më e mira e së mirës do të ishte që vetë si Kuvend i Kosovës të votojmë shkarkimin e tyre dhe t'ia kthejmë legjitimitetin RTK-së, si pushtet i katërt që duhet të ishte në shërbim të qytetarëve, e jo në shërbim të pushtetit.

Prandaj, edhe një herë i bëj thirrjes shumicës së Kuvendit, mazhorancës së Kuvendit që t'u kthehen ulëseve të tyre, të debatojnë me neve këtu dhe t'ia kthejnë dinjitetin, por kur e dimë që vetë nuk kanë dinjitet, ne nuk e presim këtë gjë në këtë drejtim.

KRYETARI: Tash flet deputetja Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Po e shfrytëzoj rastin t'i marr edhe minutat e mi si deputete meqë më herët fola në emër të grupit parlamentar, që thjesht t'i bëj edhe ca sqarime, meqë kolegu i mazhorancës nga Komisioni për Media, Valoni, i tha ca pasaktësi qëllimshëm apo jo.

E para, edhe kryetari i Kuvendi, edhe në fjalimin tim e theksuam që kërkesa për këtë debat për RTK-në ka ardhur në Kuvendin e Kosovës më 2 gusht, në fund të Sesionit pranveror. Më 16 gusht, presidentja Vjosa Osmani e ka shpallur datën e zgjedhjeve që nënkupton që ky debat nuk ka lidhje as me fushatë zgjedhje, e as me pretendime të tjera të partive që u përmendën këtu.

E dyta, më erdhi keq në fakt ta dëgjoj një fjalim të tillë nga një udhëheqës i një komisioni me shumë peshë që do të duhej të ishte gardian i publikes bashkë me RTK-në dhe aty ku llogaridhënia e RTK-së dhe e bordit në këtë rast, vjen në plan të parë.

Nëse kolegu ynë dhe përfaqësuesit nga mazhoranca, të cilët nuk janë këtu prapë, mendojnë që RTK-ja është mirë, atëherë unë do të doja t'i dëgjoja prej tyre argumentet dhe sukseset që ky bord, i cili është emëruar dhe ka marrë mandat në këtë Kuvend, i ka sjellë në këto vite për RTK-në dhe për publikun si medium i të gjithëve.

Ideja që të mundohemi t'i tejkalojmë vështirësitë, problemet, sfidat, implikimet politike, ndikimet dhe abuzimet dhe përndjekjet e aktorëve brenda RTK-së, apo trysnitë që të japin dorëheqje njerëzit dhe të zhvendosen nga pozicionet e tyre në emër të së kaluar, mendoj që, e kam thënë disa herë dhe po e ripërsëris, jo vetëm për RTK-në, po për çdo institucion të Kosovës, kjo gjuhë dhe kjo mënyrë e argumentimit nuk i bën nder as Kuvendit, e as kësaj mazhorance.

Po dua të flas për RTK-në si dikush që jam rritur me RTK-në, që i njoh sfidat nga brenda prej fëmijë kur kam qenë, e edhe nga jashtë, sepse rrita ime ka qenë e lidhur me të. Prandaj, edhe emocioni im është edhe personal sot, edhe civil, edhe politik, në të njëjtën kohë.

Sado që i ka pasur uljet dhe ngritjet e saj në faza të ndryshme, qoftë para pavarësisë e qoftë pas saj, gjithsesi, ka pasur edhe të arritura, edhe emisione, edhe programe për të cilat jemi gëzuar dhe i kemi përqaftuar sukseset e saj. Por, probleme dhe sfida ka pasur gjithmonë. E mbështetur teknikisht për shumë kohë nga operatorë të shumtë ndërkombëtarë, por edhe nga emra e

personalitete të shumta që kanë qenë pjesë e bordeve të kaluara, njerëz me integritet dhe të kaluar të ndritur.

Sot, me gjithë etiketimet që mund t'i jenë bërë dikur nga Lëvizja Vetëvendosje, kur ajo ishte në opozitë, megjithatë, hapësira e Lëvizjes Vetëvendosje dhe në atë kohë ka qenë pjesë e emisioneve dhe hapësirave të RTK-së.

Sot kur janë në pushtet i akuzojnë partitë e tjera që janë në opozitë, duke harruar që janë pushtet dhe duke harruar që kanë përgjegjësi për atë se çfarë po ndodh në RTK.

Neni 7, kreu 3, parimet programore i përcaktojnë nevojat dhe standardet programore gjithëpërfshirëse që RTK si institucion publik kryesor medial në Kosovë, i themeluar nga ky Kuvend, duhet t'i përmbushë. Dhe, kur jemi këtu, është pikërisht detyrë e Bordit të RTK-së të përkujdeset në skemat programore dhe në përmbajtjen dhe cilësinë e asaj se çfarë reprezenton mediumi publik për qytetarët.

Kontributi i bordit këtu mund të ketë qenë sipërfaqësor, duke ndryshuar skema programore, duke limituar programet për fëmijë, duke limituar programet e muzikës popullore në gjuhën shqipe dhe të folklorit, duke u dhënë rëndësi vetëm programeve muzikore në gjuhë të huaja, dhe këtu kemi shumë për çfarë të flasim në aspektin përmbajtjesor.

Meqë u përmend shumë aspekti i ndërhyrjes së AKI-së dhe përndjekja, instrumentalizimi i RTK-së karshi gazetarëve dhe mediave të tjera, nuk dua të ndalem këtu, sepse e theksova në fjalimin e kaluar. Por, dua të ndalem vetëm të ligjshmëria dhe te përgjegjësitë që bordi i ka, por edhe RTK-ja si institucion.

Neni 13 flet për transmetimin e lajmeve të veçanta që të parat janë të nivelit politik, të ngjarjeve politike me rëndësi, pastaj vijnë kulturore, sociale e të tjera. U tha edhe më herët nga kolegët e mi këtu, çfarë ngjarje më e rëndësishme mund të ketë, kur në Parlamentin e Kosovës, në institucionin më të lartë të Kosovës, deputetët e zgjedhur nga populli i Kosovës debatojnë për çështje dhe për probleme të kësaj shoqërie dhe abuzime të kësaj Qeverie.

E kuptueshme që në skemën programore kur ka edhe ngjarje të tjera që RTK ka marrëveshje për transmetim, seancat transmetohen në kanal 3, por ama ka një gjë që ka ndodhur atë kur ne kemi protestuar para derës së RTK-së. Zakonisht kur seancat barten në kanal 3, në kanal 1 çfarëdolloj programocioni që ka vazhdojnë të qarkullojnë titrat për vazhdimin e seancën në kanal 3. Kjo nuk ka ndodhur në seancën, e cila është mbajtur për abuzimin e ujit të pijes dhe për faljen e borxheve.

Neni 32 e përcakton zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm. E theksova edhe më herët, u. d. i drejtorit të përgjithshëm është zgjedhur në proces joligjor. Nuk mundet që statuti i RTK-së si dokument më i ulët sesa Ligji për RTK-në dhe rregulloret e brendshme të RTK-së të ndryshohen në mënyrë që të zgjidhet një u. d. i RTK-së. Domethënë, kjo është shkelje e pastër ligjore dhe besoj që për këtë organet kompetente duhet të merren në vijim.

Po ashtu, ky bord është perkujdesur që asnjë grua e vetme, ama asnjë grua e vetme të mos jetë në menaxhment të radiotelevizionit publik, e këndej flasim për barazi gjinore tërë ditën dhe për votën e rëndësishme dhe përfshirjen e gruas në procese politike e institucionale gjatë gjithë kohës.

Çfarë pune ka bordi nëse buxhetin që zakonisht vjen nga ky Kuvend, nuk e konstrukton fillimisht brenda RTK-së për nevojat që RTK-ja i ka bazuar në skemën programore, e përfshirë këtu edhe festivalin që po mbahet, e që unë jam e lumtur që po mbahet dhe që nuk do të ndalem tek ai, por do të ndalem te fakti se si është financuar festivali.

Domethënë, ky Kuvend me këtë mazhorancë ia ka ulur RTK-së 2,7 milionë buxhetin, përderisa ministri i Kulturës është perkujdesur që të bëjë memorandum të mirëkuptimit me RTK-në që t'ia japë 750 mijë euro për festivalin dhe aktivitetet kulturore që i bën ministria dhe ministri.

Më vjen keq, por tek ai kreu 3, neni 7 që e përmenda dhe skemat programore, kultura dhe aktivitetet kulturore janë pjesë e saj. RTK-ja e ka për obligim që aktivitetet kulturore t'i përcjellë pa dallim kush është në Qeveri, ose kush është ministër. Kjo është puro mënyrë e interferimit politik. Bile-bile kemi shkuar aq larg, sa ministri të përcaktojë që duhet të hapet një kanal i ri, që është kanali numër 4, dhe të jetë vetëm për kulturë.

E kam theksuar edhe më herët në një seancë të kaluar që dikush mund të çohet nesër në mëngjes dhe të thotë që bujqësia është prioritet në Kosovë dhe ta hapim një kanal edhe për bujqësi. Një ministër tjetër thotë që është ekonomia, një kanal veç për ekonomi. Ky është interferim puro politik, sepse për këtë çështje merret bordi dhe raportimi bëhet në Kuvend. Nuk vendosin ministrat se çfarë kanali hapet në RTK.

Por, përtej kësaj, po dua të kthehem edhe një herë te puna që do të kishte pasur mundësi ta bëjë bordi, e që nuk e bën. RTK është pa prona të saj, e theksoi edhe kolegu im më herët, dhe nevoja për t'u rehabilituar ose për të pasur një hapësirë të dinjitetshme ku njerëzit punojnë dhe kanë hapësirat e tyre të dinjitetshme të punës dhe veprimit, duhet të ketë një përgjigje. Asnjë aktivitet nga bordi në këtë drejtim, asnjë ide, asnjë vizion.

E njëjta ndodh me pronën intelektuale, as nuk e dimë ku kemi mbërri me digjitalizimin. As nuk e dimë nëse RTK-ja është trashëgimtare e TVP-së, ku janë, a janë digjitalizuar krejt ato materiale dhe ku gjenden, ku janë të arkivuara.

Këta kanë shkuar aq larg saqë edhe logon e kanë ndryshuar. Nëse e merrni ta shikoni logon e Radio Kosovës, është e kuqe me të bardhë. Krejt logot e RTK-së janë me të kaltër e të bardhë, logoja e radios tash është kuq e bardhë. Domethënë, edhe aspektin vizual kanë nisur ta ndryshojnë kur kanë ardhur në pushtet.

Bordi ka bërë edhe një gjë që shumë pak është folur në këto seancat tona, por edhe në raportimet të paktën në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që përtej që nuk është marrë në mënyrën e duhur me menaxhmentin e lartë, ka bërë presion të jashtëzakonshëm te menaxhmenti i ulët, ku nuk ka fare kompetencë. Ka ftuar në raportim drejtor të departamenteve që nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, lirisht zonja Hoxha e përfundoni fjalën. Regjia, në foltore, ju lutem!

ELIZA HOXHA: ...bordi ka ftuar në raportim drejtorë të menaxhmentit të ulët e të departamenteve, që nuk është kompetencë e tij fare. Ka bërë trysni në punëtorë dhe ka kërkuar raport nga punëtorët e dikastereve të caktuara. Kjo është ndërhyrje direkte pastaj në mënyrën se si funksionin ky institucion.

Andaj, nëse ky bord mendon që RTK-ja mund ta ngre cilësinë në këso lloj mënyre sikur në masa të dhunshme, për besë, kjo është për çka po flasim sot.

Një televizion i cili i nënshtrohet një vullneti partiak, jopolitik, sepse këtu kemi ngjyra të ndryshme politike, prandaj edhe është e mira që televizioni publik është i themeluar nga Kuvendi i Kosovës që të mos ketë ndikime të tilla. Këtu do ta mbyll me dëshirën e madhe që edhe Valoni si kryetar i Komisionit të Mediave, por edhe kolegët e tij të mazhorancës të vijnë këtu dhe të debatojmë sinqerisht për nevojën e këtij shteti që të ketë një televizion publik të dinjitetshmën që na përfaqëson të gjithëve. Faleminderit!

KRYETARI: Meqenëse tash është kjo pjesa ku detyrohemi t'i hedhim në votim një nga një, ta konstatoj që Kuvendi nuk i ka numrat që t'ia japë një epilog kësaj çështjeje, kështu që mbetet për një ditë tjetër. Këtu e ndërpresim. Faleminderit!

* * *

E enjte, më 5 dhjetor 2024

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 31 tetor 2024

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kam një vërejtje për komisionet, kjo që keni bërë vërtet është joserioze, do ta precizoni dhe të disiplinoheni sa i përket përgjegjësisë që e keni dhe mbajtjes së mbledhjeve të komisioneve. Nuk mund të ndërhyni në seanca kur janë kështu të caktuara nga Kryesia, pikërisht të na e caktoni në atë orë edhe mbajtjen e mbledhjeve të komisionit, sepse kështu na e bllokoni punën e Kuvendit.

I ftoj të vijnë deputetët në sallë, sepse tash e kemi pikën e tetë, është kjo pjesë e një seance, e cila ka mbetur e papërfunduar nga e kaluara, kemi disa pika që t'i trajtojmë.

8. Shqyrtimi i propozimit të gjashtë (6) deputetëve nga GP të PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar zëvendëskryeministre,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Diskutimet sa i përket shkarkimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së kanë përfunduar, ky është një mocion për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, prej atëherë gjendja ka ndryshuar, sepse siç e dini tashmë tre anëtarë veçse kanë dhënë dorëheqje, këta janë: Besnik Boletini, Arta Berisha dhe Safet Kabashaj. Kështu që ne do të procedojmë me të tjerët që janë aktualisht anëtarë.

Urdhëroni, fjalën ma ka kërkuar kryetari i Komisionit të Administratës dhe Mediave, deputeti Ramadani, Urdhëro, Valon Ramadani!

VALON RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Veç sa për informacion, edhe dy anëtarëve të tjerë u ka skaduar mandati para dy ditësh.

KRYETARI: Pardje domethënë qenka kryer edhe mandati i tyre, a? Cilët janë ata, më fal?

VALON RAMADANI: Është Fatime Lumi-Qehaja dhe Albulena Mehmeti.

KRYETARI: Atëherë, kjo objektivisht na kërkon që t'i heqim ata. Këto dy anëtare janë pa mandat, kështu që mund të vazhdojmë me të tjerët. Uluni!

Edhe tre të tjerë i kemi që t'i trajtojmë. Së pari po e hedh në votim Birol Urgjan, i cili ka mandat deri në maj të vitit 2025. Përgatituni për votim, domethënë vendimin që duhet ta marrim ne është a ta shkarkojmë apo jo, votojmë tash!

Vetëm 59 deputetë po votojnë, ju lutem uluni!

Provojmë edhe një herë. E hedhim në votim, përgatituni për votim, është çështja për shkarkimin apo jo të anëtarit të Bordit të RTK-së, Birol Urgjan. Votojmë tash!

4 vota për, kundër 56, 2 abstenime. 62 në total. Nuk shkarkohet Birol Urgjan.

Kalojmë te anëtari tjetër, Dardan Beqiri, votojmë tash!

3 për, 54 kundër, 5 abstenime, 62 vota në total. Nuk shkarkohet Dardan Beqiri.

Anëtarja tjetër është Radoica Mërgjinac. Votojmë tash!

5 për, 42 kundër, 15 abstenime. 62 total. Nuk shkarkohet Radoica Mërgjinac.

Kalojmë te pika tjetër e kësaj seance, e cila është:

9. Zgjedhja e tre drejtorëve të Bordit të ndërmarrjes publike “Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut”

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin e panelit përzgjedhës për zgjedhjen e drejtorëve të Bordit të ndërmarrjes “Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut”. Kuvendit ia ka rekomanduar zgjedhjen e tre drejtorëve nga këta kandidatë që i kemi të propozuar.

Po ashtu, të nderuar deputetë, komisioni ka propozuar që kandidati, i cili merr më së shumti vota të zgjidhet njëkohësisht edhe kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it. Kjo do të jetë procedura që do ta ndjekim, tash i kam edhe disa këshilla të tjera.

Procedura për emërimin e Bordit të drejtorëve fillon edhe me shpalljen e konkursit në të cilën theksohen edhe kriteret për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit.

Kryesuesi dhe pesë anëtarë të tjerë të Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, e zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar për secilën pozitë përkatëse të Bordit.

Nuk e paskemi kryetarin e Komisionit për Ekonomi, zonja Statovci, si nënkryetare, a dëshironi ta jepni një raport në emër të komisionit sa i përket kësaj? Është pra për zgjedhjen e drejtorëve të KOSTT-it.

JETA STATOVCI: I nderuar kryetar Konjufca,

Ndërmarrja publike KOSTT është operatori i sistemit të transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike të Kosovës, ndërmarrje publike me 100% të aksioneve shtetërore sipas Ligjit për energji elektrike dhe funksionon si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për ndërmarrje publike dhe legjislacioni përkrahës në fuqi.

Të drejtat e aksionarit për KOSTT-in udhëhiqen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i drejtorëve të KOSTT-it përbëhet prej shtatë anëtarëve, njëri prej të cilëve është kryesues i Bordit, si dhe pesë anëtarë të tjerë të Bordit të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat katërvjeçar. Si dhe, mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Ndërsa, anëtari i shtatë është kryeshefi ekzekutiv sipas detyrave zyrtare. Në bazë të ligjit, Ministria e Punëve të Brendshme shpall konkurs për drejtorë të Bordit për plotësimin e tri pozitave me afat aplikimi nga 06. 6. 2024 deri më 08. 7. 2024, ku gjatë këtij afati kohor kanë aplikuar 24 aplikantë. Në bazë të nenit 14, të paragrafit të Ligjit për energjinë elektrike, Komisioni parlamentar përkatës për Energji, pas pranimit të dosjes së aplikantëve i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku dy kandidatë për një pozitë të lirë.

Paneli pas shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve konstatoi se nga 24 aplikantë, 21 plotësuan kushtet formale ligjore për t'u ftuar në intervistë, ndërkaq tre kandidatë para intervistës njoftuan se tërhiqen nga gara.

Paneli përzgjedhës zhvilloi procedurën e intervistimit të kandidatëve, ku u paraqitën 18 kandidatë, pas zhvillimit të procedurave të intervistimit dhe poentimit bazuar në performansën e tyre, paneli propozoi komisionit gjashtë kandidatë si në vijim:

Rejhane Zylfija, Gëzim Tosuni, Gazmend Mejzini, Jeton Mehmeti, Lumnije Zeka, Pranvera Dobruna-Kryeziu.

Komisioni Funkcional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, në bazë të nenit 110 të Rregullores së Kuvendit dhe në përputhje me nenin 14 të Ligjit për energjinë elektrike, në mbledhjen e mbajtur më 1. 10. 2024, pasi shqyrtoi raportin e panelit përzgjedhës për drejtorë të Bordit të ndërmarrjes publike të operatorit të sistemit transmisionit dhe tregut pranë ndërmarrjes publike KOSTT për plotësimin e këtyre tri pozitave, vendosi ta paraqesë këtë rekomandim:

-Kuvendi të zgjedhë me votim të fshehtë tre kandidatë të propozuar për plotësimin e tri pozitave për drejtorë të Bordit të ndërmarrjes publike KOSTT me mandat katërvjeçar, si në vijim:

Rejhane Zylfija, Gëzim Tosuni, Gazmend Mejzini, Jeton Mehmeti, Lumnije Zeka, Pranvera Dobruna-Kryeziu.

Kandidati që merr më së shumti vota nga Kuvendi zgjidhet kryesues i Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike KOSTT. Faleminderit!

KRYETARI: Këta ishin pra gjashtë propozimet, ne do t'i votojmë tre prej tyre, kush merr më së shumti vota, zgjidhet po ashtu edhe kryesues i bordit.

Tash disa këshilla për ju, të nderuar deputetë: nëse në raundin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk i merr votat e nevojshme përsëritet konkursi. Nëse në raundin e parë vetëm një kandidat i merr votat e nevojshme, kandidati me më së paku vota nga lista e gjithë kandidatëve hiqet nga lista dhe pastaj përsëritet votimi me katër kandidatë për dy pozita dhe votimi përsëritet varësisht nga numri i kandidatëve që marrin votat e mjaftueshme.

Për zbatimin e procedurës së fshehtë kërkohet formimi i një komisioni zgjedhor me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar. Kënd e propozon VV-ja? Kush e merr fjalën?

Kryetare Kusari-Lila, duhet ta propozojë Vetëvendosja një anëtar.

MIMOZA KUSARI-LILA: Po, faleminderit, kryetar!

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje propozojmë deputetin Agon Batusha.

KRYETARI: Grupi Multietnik.

DUDA BALJE: Faleminderit, kryetar! Grupi Multietnik propozon deputetin Bekim Arifi.

KRYETARI: Partia Demokratike, më fal, se nuk ju vëreja, kërkoj ndjesë.

HAJDAR BEQA: Kryetar, përshëndetje, realisht është dashur të jetë sipas Rregullores, partisë së dytë fjalën paraprakisht. Ne nuk do të marrim pjesë në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkoj ndjesë! Partia Demokratike nuk merr pjesë në këtë komision, e votojmë komisionin, uluni nëpër vendet tuaja.

Tash, votojmë!

Pra, po votojmë për përbërjen e Komisionit të votimit, votojmë tash!

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Miratohet Komisioni i votimit.

Ju lutem, zini vendet dhe pastaj fillojmë procedurën.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Tani do t'i thërras deputetët për votim sipas radhës:

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Albana Bytyqi, Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj...

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Arianë Musliu-Shoshi, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralija, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Behgjet Pacolli, Bekë Berisha, Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri...

Biljana Maksiq, Blerta Deliu-Kodra, Burim Meta, Cvetko Veljković, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili, Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enis Kervan, Enver Dugolli, Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi...

Fadil Gashi, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri, Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Glauk Konjufca, Gramoz Agusholli, Hajdar Beqa, Haki Abazi...

Halil Thaçi, Haxhi Avdyli, Hisen Berisha, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Isak Shabani, Jahja Kokaj, Jeta Statovci, Jetmire Vrenezi, Ksenija Bozhović, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku...

Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Milan Joksimović, Milan Kostiq, Milazim Salihaj, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku-Tishukaj, Mirsad Shkreta, Nenad Radenković, Nasuf Bejta, Njazi Isaku, Olivera Zdravković, Pal Lekaj, Radosh Mihajloviq, Ramush Haradinaj...

Rashit Qalaj, Rrezarta Krasniqi, Salih Zyba, Samra Iljaz, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Svetislav Jokiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vendenis Lahu, Visar Korenica, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Yllza Hoti, Zoran Maksimović.

I ftoj të gjithë deputetët që ende nuk kanë votuar, të votojnë!

Të nderuar deputetë, ju njoftoj edhe një herë që kushdo që nuk ka votuar, të shfrytëzojë të drejtën e tyre për të votuar, pasi që mbas kësaj thirrje do ta mbyllim procesin e votimit.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Komisioni është gati, na i jep rezultatet e votimit ose së paku secilën votë se si kanë votuar deputetët. Urdhëroni!

Po e prezantojnë rezultatin e votimit.

AGON BATUSHA: Atëherë, fillojmë me numërimin e votave:

Gëzim Tosuni

Jeton Mehmeti,

Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Jeton Mehmeti

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Pranvera Dobruna-Kryeziu

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Gazmend Mejzini
Lumnije Zeka
Pranvera Dobruna-Kryeziu
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Pranvera Dobruna-Kryeziu
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka

Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Jeton Mehmeti
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Pranvera Dobruna-Kryeziu
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Gazmend Mejzini
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumniye Zeka
Rejhane Zylfijaj

Gëzim Tosuni
Jeton Mehmeti
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Gazmend Mejjini
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni

Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Gazmend Mejzini
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Lumnije Zeka
Jeton Mehmeti
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka
Rejhane Zylfijaj
Gëzim Tosuni
Lumnije Zeka

KRYETARI: Kjo është sa u përket votave të secilit deputet. Tash besoj që komisioni e ka kohën e tij të mjaftueshme që të na informojë për rezultatin përfundimtar dhe pastaj e shohim nëse kemi arritur të zgjedhim tre drejtorë të Bordit të KOSTT-it.

Po, komisioni, urdhëroni për rezultatin përfundimtar.

AGON BATUSHA: Komisioni zgjedhor, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e tre drejtorëve të Bordit të ndërmarrjes publike

Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, në seancën plenare të mbajtur më 5. 12. 2024 konstaton se votat e fituara për kandidatët e propozuar për tre drejtorë të Bordit të KOSTT janë:

- gjithsej kanë marrë pjesë 62 deputetë, të pavlefshme asnjë.

1. Rejhane Zylfijaj ka marrë 57 vota,
2. Gëzim Tosuni 58 vota,
3. Gazmend Mejzini 4 vota,
4. Jeton Mehmeti 5 vota,
5. Lumnije Zeka 55 vota dhe
6. Pranvera Dobruna-Kryeziu 3 vota.

KRYETARI: Pra, drejtorë të Bordit të KOSTT-it zgjidhen Rejhane Zylfijaj, Gëzim Tosuni dhe Lumnije Zeka. Kurse me 58 vota, si kryesues i Bordit të KOSTT-it zgjidhet Gëzim Tosuni.

Këto ishin rezultatet. Tash kalojmë te një pikë tjetër:

10. Emërimi i anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditimin nga radhët e studentëve

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtarit nga radhët e studentëve në Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Është pra ky Këshilli i Agjencisë Kosovare të Akreditimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emërimin e zonjës Shkurta Bajgora nga Universiteti “Hasan Prishtina”, anëtare për Këshillin e lartpërmendur.

Nuk e paskemi, me sa po e shoh, ministren këtu, por ajo ia ka deleguar këtë përgjegjësi ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Urdhëroni, na jepni propozimin, zonja Haxhiu.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Më lejoni që të paraqes para jush anëtarin student në Këshillin Shtetëror të Cilësisë me autorizimin e ministres Nagavci, pra po e paraqes këtë propozim dhe ky propozim vjen pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komisioni ka bërë propozimin e listës së ngushtë dhe nga ajo listë është propozuar zonja Shkurtë Bajgora si anëtare, studente në Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Zonja Bajgora është kandidate për doktoraturë në Universitetin e Lubjanës, në fushën e Edukimit dhe të gjithpërfshirjes, në vijim të studimeve themelore dhe atyre master në psikologji. Studentja në fjalë plotëson të gjitha kriteret për të qenë anëtare në KSHC, të cilat janë të përfshirë në dokumentacionin përkatës, të cilën e

kanë edhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Prandaj, edhe bazuar mbi këto të dhëna Qeveria e Kosovës e ka aprovuar propozimin dhe e ka marrë vendimin që t'ia propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës Shkurtë Bajgorën për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Ky është propozimi. Urdhëroni, zoti kryetar i Komisionit për Arsim, Ardian Gola.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryekuvendar.

Po, Komisioni Funkcional ka mbajtur mbledhjen e rregullt dhe ka proceduar edhe çështjen e anëtarit student në kuadër të përbërjes së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vendimit, rekomandimit të ardhur nga Qeveria, kemi konstatuar që kandidatja për anëtare student në këtë Këshill, Shkurta Bajgora, i plotëson të gjitha kriteret dhe mendojmë se është vlerë e shtuar e këtij Këshilli.

Andaj, kërkojmë nga deputetët që ta votojnë për anëtare, ashtu që ta plotësojmë si përbërje këtë Këshill dhe të vazhdojmë tutje me plotësimin e kriterëve të radhës për rikthim të KSHC-së dhe agjencisë në përgjithësi në strukturat e cilësisë dhe akreditimit, në EQUAR sidomos. Faleminderit!

KRYETARI: Ky ishte propozimi, e hedhim në votim. Kthehuni, po përgatitemi për votim, bëhuni gati.

A jemi gati? Jo!

Uluni, votojmë tash!

Vetëm 60 keni votuar.

Votojmë për herë të dytë, votojmë tash!

62 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kuvendi mori vendim që të zgjidhet anëtare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga ana e studentëve zonja Shkurta Bajgora. Mandati i saj është dyvjeçar, ne i dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë zonjës Bajgora në Këshillin e Cilësisë.

Tri marrëveshje ndërkombëtare i kemi tash, siç po e shihni, të nderuar deputetë. Për asnjërën prej tyre nuk ka kuorum Kuvendi që t'i trajtojë, kështu që pikat 11, 12 dhe 13, sipas numrave rendorë që i kemi këtu në agjendë të Kuvendit, të barten për një seancë tjetër. Kurdo që kemi mundësi ta mbajmë në Kuvendin e Republikës, atëherë i trajtojmë kur të krijohen kushtet objektive. Nuk i kemi 80 deputetë, janë më pak.

Kështu që kalojmë në pikën e 14-të, e cila është:

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-312 për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat e moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç

Të nderuar deputetë, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin, neve na e ka rekomanduar miratimin e tij. Ia japim fjalën propozueses së këtij projektligji, që edhe në emër të deputetëve të tjerë ta propozojë këtë projektligj. Është Fitore Pacolli-Dalipi, urdhëro!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji nr. 08/L-312, për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat nën moshën 18 vjeç ka për qëllim të mbrojë shëndetin e fëmijëve dhe grupeve të ndjeshme ndaj efekteve negative që sjellin pijet energjike.

Ky projektligj synon të mbrojë shëndetin publik, si dhe përfshin ndalimin e konsumimit të këtyre pijeve nga të miturit dhe përfshin kontrolle të rrepta në prodhimin, shpërndarjen dhe reklamimin e këtyre produkteve. Gjithashtu, përmes këtij projektligji synojmë që të arrihet ndërgjegjësimi dhe edukimi për rreziqet që lidhen me këto pije, veçanërisht për grupet më të ndjeshme, siç janë gratë shtatzëna dhe gjidhënese.

Ky projektligj nuk bie ndesh me ndonjë akt primar apo sekondar të Bashkimit Evropian dhe është në përputhshmëri me legjislacionin tjetër që kemi në fuqi që ka të bëjë me mbrojtjen e konsumatorit. Për këtë projektligj janë zhvilluar konsultime të ndryshme dhe dëgjime publike me institucionet publike, shoqërinë civile dhe të gjithë aktorët relevantë dhe është konstatuar që është tejet i nevojshëm që të procedojmë tutje.

Komisioni për Mjedis e ka shqyrtuar në bazuar në nenin 74, të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar këtë projektligj në mbledhjen që kemi mbajtur më 17. 9. 2024 dhe propozojmë që ky projektligj të votohet parimisht në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit FunkSIONAL a fole, Fitore, a jo?

E përfundove krejt, e hedhim në votim, pra. Përgatitemi për votim, votojmë për Projektligjin për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat nën 18 vjeç, votojmë tash!

62 vota për, zero kundër, zero abstenime. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndalimin e përdorimit të pijeve energjike për personat e moshës nën 18 vjeç. Kërkojmë nga Komisioni FunkSIONAL, edhe komisionet e përhershme le ta trajtojnë këtë projektligj dhe pastaj, sipas afateve që i kemi këtu në Kuvend, të na e sjellin në shqyrtim të dytë.

Të nderuar deputetë, tash e kemi një projektligj tjetër. E kemi edhe ministrin këtu.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-315 për banim social dhe të përballueshëm

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin, na e ka rekomanduar miratimin e tij. Ia japim fjalën ministrit Aliu për ta prezantuar këtë projektligj.

MINISTRI LIBURN ALIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni të paraqes rëndësinë dhe qëllimin e këtij projektligji që është hartuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në përputhje me përgjegjësitë dhe objektivat e saj, qëllimi i tij është krijimi i mundësive për banim social dhe të përballueshëm për qytetarët e Kosovës, duke siguruar kushte adekuate të banimit për ata që kanë nevojë për të.

Është instrument thelbësor për të ndihmuar individët dhe familjet me gjendje ekonomike të vështirë, duke siguruar që ata të mund të banojnë në kushte të pranueshme dhe të përballueshme.

Kjo iniciativë ligjore përcakton rregullat dhe procedurat e nevojshme për planifikimin, administrimin dhe zbatimin e programeve të banimit në nivelet qendrore dhe komunale, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit, efikasitetin ekonomik dhe respektimin e diversitetit kulturor.

Projektligji zbatohet për të gjitha institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe komunal që menaxhojnë programe të banimit social dhe të përballueshëm. Ai gjithashtu përfshin individë dhe familje që janë përfitues të këtyre programeve, duke siguruar përfshirjen e grupeve të cenueshme dhe kategorive të tjera me nevojë.

Ky ligj do të mbulojë gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe të sigurojë një mbështetje të barabartë për qytetarët në nevojë, pavarësisht nga vendbanimi i tyre.

Ligji parashikon disa programe të banimit. Banimi social që ofron mundësi qiraje për ata që nuk mund të paguajnë çmimin e tregut, zhvillimin e lagjeve adekuate, që krijon kushte për lagje të qëndrueshme dhe vetëshërbime të plota dhe të sigurta. Rindërtimin dhe renovimin për ata që jetojnë në kushte nën normat minimale të banimit dhe banimin e përballueshëm që ofron banesa për çifte të reja dhe individë me të ardhura të ulëta dhe mesatare, duke e bërë banimin e përballueshëm.

Dua t'ju njoftoj që pas thirrjes që e kemi bërë për komunat, tashmë i kemi identifikuar lokacionet për trembëdhjetë komuna dhe për komunat e tjera të cilat nuk kanë aplikuar, do të ketë thirrje nga mesi i shkurtit. Po ashtu, në kuadër të banimit social, do të bëjmë së shpejti thirrjen për komunat, mbase brenda kësaj jave, që të aplikojnë për programin e krijimit të mekanizmave

komunalë në nivel lokal për asistencën për banimin social. Pra, do t'u ofrohet ndihmë a asistencë që të krijojnë mekanizmat e banimit social nëpër komuna, e që do të jenë po ashtu përfitues edhe të programit që jemi në zhvillim e sipër të kombinuar me banimin e përballueshëm.

Banimi i përballueshëm dhe social do të jenë të kombinuar, në mënyrë që t'i ikim getoizimit çfarë ka qenë në të kaluarën.

Unë ju falënderoj dhe ju ftoj që ta votojmë.

KRYETARI: A dëshiron të flasësh, Fitore? Fitore Pacolli-Dalipi, në emër të Komisionit.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Mjedis, Bujqësi, Ushqim, Planifikim dhe Zhvillim, bazuar në nenin 74 të Rregullore së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17. 9. 2024

Kërkoj falje, është pjesa tjetër, një sekondë.

KRYETARI: Po, urdhëro!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Në mbledhjen që e kemi mbajtur më 17. 9. 2024, e kemi shqyrtuar në parim Projektligjin 08/L-315 për banim social dhe të përballueshëm.

Pas shqyrtimit të detajuar, Komisioni ka konstatuar se ky ligj i përmbush kriteret ligjore dhe kushtet e parapara me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit dhe i propozon Kuvendit që ta miratojë këtë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Përgatituni! Me elektronikë po votojmë.

Bëhuni gati, të nderuar deputetë. Gati më duket që jeni. Edhe Fridoni atje. Mirë!

Tash, më duket që u kompletua mazhoranca. E hedhim në votim këtë projektligj të rëndësishëm.

Votojmë tash!

63 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për banim social dhe të përballueshëm.

I obligojmë edhe Komisionin FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme ta trajtojnë projektligjin dhe pastaj na e sjellin për leximin e dytë kurdo që të krijohet mundësia.

Fitore Pacolli e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, Fitore!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Faleminderit, kryetar!

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 123 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, parashtroj mocion procedural për shmangie nga afatet e përcaktuara në nenin 76 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e këtij projektligji.

Propozojmë që amendamentet e Projektligjit nr. 08/L-315 për banim social dhe të përballueshëm mund t'i adresohen Komisionit Funksional deri në orën 13:30 sot, Komisioni Funksional deri në orën 16:00, pra po ashtu sot duhet ta shqyrtojë Projektligjin për banim social dhe të përballueshëm dhe raportin me rekomandime t'ua paraqesë komisioneve të përhershme. Komisionet e përhershme deri në orën 16:30 ta shqyrtojnë Projektligjin për banim social dhe të përballueshëm dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional. Komisioni Funksional deri në orën 17:00 të kësaj date, pra sot, duhet të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për banim social dhe të përballueshëm për shqyrtimin e dytë në seancë plenare. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për banim social dhe të përballueshëm të bëhet në seancën plenare, sot pra në ora 18:30. Faleminderit!

KRYETARI: Sa s'e kemi hedhur në votim, mazhoranca e ka edhe një propozim tjetër, që ndoshta duhet të përmirësohet. Qysh na e ke thënë znj. Pacolli-Dalipi, kjo interferon pastaj edhe në seancën tjetër. I kemi dy seanca sot, duhet ta keni parasysh si mazhorancë. Kështu që, nëse doni ta trajtoni këtë projektligj.

Propozimi i Grupit Parlamentar të mazhorancës, Vetëvendosja, Fitore Pacolli-Dalipi.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Po, kryetar!

Po, e ndryshojmë kohën kur mund të shqyrtohen këto amendamente. Pra, amendamentet për projektligjin shqyrtohen në ora 13:20, pastaj Komisioni Funksional mblidhet në ora 13:30, komisionet e përhershme mblidhen në 13:40, Komisioni Funksional në 13:45, ndërsa shqyrtimi i dytë i këtij projektligji bëhet në ora 13:50. Faleminderit!

KRYETARI: Ky është propozimi. E hedhim në votim. Uluni!

E qesim në votim. është votim për shmangie, trajtim të projektligjeve përmes shmangies së afateve të Rregullores. Orën dhe procedurat i dëgjuam.

Votojmë tash!

62 vota për, zero vota kundër, zero abstenime. Miratohet kjo shmangie, pra projektligji trajtohet sipas afateve të parapara.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor

Ministër, ky është projektligji më i rëndësishëm siç na ke thënë, kështu shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Të nderuar deputetë,
Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar dhe ka rekomanduar miratimin e tij.

Ia japim fjalën ministrit Vitia që ta paraqesë këtë projektligj para Kuvendit.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Po është ligji më i rëndësishëm. Kërkoj ndjesë, por vrap erdha prej një takimi të rëndësishëm po ashtu.

I nderuar kryetar i Parlamentit të Republikës, z. Konjufca!
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë që para jush po paraqes sot për miratim Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor. Kjo nismë ligjore është paraprirë nga një proces i detajuar i planifikimit, analizimit dhe diskutimit.

Ky projektligj është hapi themelor drejt krijimit të sigurimeve shëndetësore në vendin tonë. Ky proces tashmë është i pakthyeshëm dhe si të tillë jemi duke nisur edhe sot në këtë mbledhje. Me këtë nismë themelohet Fondi i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor i Republikës së Kosovës.

Për herë të parë po përcaktohen rregulla për listën e barnave të rimbursuara që do të transformojë rrënjësisht mbështetjen që shteti jep për qytetarët, e veçanërisht për ata që vuajnë nga sëmundje të ndryshme.

Me këtë projektligj po rregullohen edhe çështjet e mbledhjes së kontributeve nga qytetarët për fondin e sigurimeve dhe këto kontribute do të jenë një nga burimet e rëndësishme të financimit të shëndetësisë në të ardhmen e afërt. Kësi lloj, buxheti që ndahet për shëndetësinë do t'i shtohet edhe kontributi i secilit prej nesh nga të hyrat personale.

Konsideroj që ky është një moment vendimtar për vendin tonë, për marrëdhënien qytetar-shtet, dhe për ngritjen e sistemit shëndetësor në një nivel të ri. Zbatimi i këtij ligji do të jetë një nga sfidat më domethënëse të Qeverisë sonë dhe me të po i japim në të tashmen mbështetjen më të madhe për shëndetësinë dhe për të ardhmen, qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë e shpenzimeve për çështje të shëndetit.

Me sigurimin e detyrueshëm çdo qytetar do të ketë qasje në shërbimet bazë shëndetësore, duke reduktuar ndjeshëm barrën financiare, individuale dhe familjare. Me këtë ligj shtohet edhe një burim i qëndrueshëm i rritjes së buxhetit të shëndetësisë publike. Kjo do të na japë një frymëmarrje për investime afatgjata në pajisje inovative, në infrastrukturë moderne të avancuar konform standardeve dhe mbi të gjitha, jo m pak e rëndësishmja, edukimit të vazhdueshëm dhe promovimit në punën e personelit mjekësor.

Në vend të kostove të papritura dhe shpesh të papërballueshme për trajtime shëndetësore, sigurimi i detyrueshëm do të ndihmojë në krijimin e një mbrojtjeje financiare për çdo qytetar dhe qytetare dhe do të reduktojë rrezikun e rënien nën pragun e varfërisë, për shkak të shpenzimeve shëndetësore.

Ligji për sigurimin e detyrueshëm do të mundësojë një fokus më të madh në parandalimin e sëmundjeve dhe promovimin e shëndetit publik. Me një bazë financimi të përbashkët, do të ketë mundësi për të investuar më shumë në programe parandaluese dhe ndërgjegjësuere. Kjo politikë është një hap thelbësor drejt një sistemi shëndetësor më të barabartë dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët tanë.

Mbështetja dhe miratimi juaj janë të domosdoshme për t'i ofruar popullit një sistem shëndetësor më të sigurt dhe më të përballueshëm.

Me këtë projektligj rregullohet sistemi i sigurimit të kujdesit shëndetësor të detyrueshëm, duke përfshirë parimet, funksionet, të drejtat e përgjegjësitë e palëve të përfshira, personat e siguruar, modalitetet e kontributit, pakoja e përfitimeve që mbulohet nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm, marrëdhëniet kontraktuale me institucionet e kujdesit shëndetësor dhe barnatoret në lidhje me ofrimin, përdorimin dhe pagesën e shërbimeve shëndetësore dhe produkteve të dispenzuara.

Me këtë ligj, themelohet Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor të Republikës së Kosovës, përfshirë funksionimin dhe financimin e Fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor të Republikës.

Projektligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor synon disa ndryshime të rëndësishme. Ministria e Shëndetësisë synon të transformojë mekanizmin e financimit të sistemit shëndetësor dhe ta përshpejtojë arritjen e mbulimit shëndetësor universal. Përkatësisht, Ministria e Shëndetësisë synon që të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë dhe ta zvogëlojë varfërinë dhe pabarazinë e shkaktuar nga shpenzimet shëndetësore, duke siguruar një qasje universale për të gjithë qytetarët dhe banorët në shërbime cilësore të kujdesit bazë shëndetësor.

Prezantimi i kontributeve për sigurim shëndetësor si një burim i ri i financimit për kujdesin shëndetësor, i cili do të plotësojë pjesërisht financimin aktual mbizotërues të bazuar në buxhetin e ndarë të Republikës.

Pajisja e Fondit sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor me fuqi blerëse nga institucionet shëndetësore, e cila synon jo vetëm blerjen e shërbime të përfshira në paketën e përfitimeve të Fondit në sasinë e nevojshme, por edhe stimulimin, matjen dhe kontrollin e shërbimit të bazuar në performansë, duke e mbajtur nën kontroll edhe shpenzimet shëndetësore.

Për ta bërë shpërndarjen e burimeve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore sa më strategjike dhe të bazuar në performansë, përmes këtij Projektligji është planifikuar të prezantohet tre, përkatësisht katër metoda prioritare të pagesës për shërbimet e kujdesit shëndetësor, e që do të mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor.

Pagesa për kokë banori për një pako të përcaktuar shërbimesh ambulatorë për një të siguruar në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor, për një periudhë kohore, pagesën e tarifës për shërbimin për çdo individ, ose një paketë shërbimesh sipas një plani të paracaktuar tarifash dhe pagesa e bazuar në rast për sa i përket kostos mesatare për pranim si dhe në afatgjatë.

Grupeve të lidhura me diagnozën DRG, të cilat grupohen sipas diagnozës së pacientit dhe procedurave kryesore të kërkuara, si dhe vazhdimi i financimit nga buxheti i shtetit, si dhe eventualisht pagesa për çdo ditë spitalore për pacientët e shtruar.

Duke qenë se zbatimi i ligjit do të përfaqësojë një zhvendosje të konsiderueshme nga financimi aktual i bazuar në buxhet, janë bërë propozime për paketën e përfitimeve më gjithëpërfshirëse dhe më të gjerë në krahasim me sistemin aktual, duke përfaqësuar kështu një vlerë të shtuar dhe të dukshme për popullatën.

Skema e rimbursimit të barnave jashtëspitalore është identifikuar si alternativa më e mirë për këtë shërbim shtesë dhe si vlerë e shtuar.

Projektligji me qëllim të zgjerimit të kategorisë së siguruarve aktivë dhe bazës materiale të Fondit, ka përfshirë përpos të punësuarve, edhe kategoritë e popullatës që duhet të marrin pjesë në kontribut për sigurimin shëndetësor siç vijon. Të vetëpunësuarit, personat që marrin pension nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës ose çfarëdolloj pensioni plotësues ndaj të cilit është i detyrueshëm tatimi në të ardhurat personal nëse banojnë në Republikën e Kosovës dhe të gjithë banorët e tjerë të Republikës së Kosovës që kanë së paku tetëmbëdhjetë vjet dhe që nuk janë të lidhur detyrimisht në asnjë cilësi tjetër me sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe të cilët nuk i plotësojnë ose më tutje nuk i plotësojnë kriteret si i siguruar joaktiv.

Projektligji parashikon kompensimin e performancës së mjekëve në institucionet shëndetësore si një mjet i rëndësishëm i stimulimit të cilësisë dhe produktivitetit të shërbimeve shëndetësore, si dhe mundësinë e furnizimit direkt nga prodhuesi apo distributori me autorizim-marketing të medikamentit për të siguruar çmime sa më të ulëta dhe cilësi sa më të mirë të medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore.

Projektligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor synon të sigurojë mbulimin shëndetësor universal të të gjithë popullatës brenda mundësive, me një sqarim më të mirë të statusit të ndryshëm të banorëve të siguruar të detyrueshëm, duke e bërë dallimin midis të siguruarve aktivë, ata që janë pra të detyruar të paguajnë kontributet, dhe të siguruarve joaktivë, anëtarëve të varur të familjes dhe grupeve të tjera të përjashtuara dhe duke përcaktuar detyrat dhe të drejtat e tyre në lidhje me nivelin e kontributeve të pagueshme, të drejtat për përfitime, bashkëpagesat e zbatueshme ose procedurat për qasje në institucionet shëndetësore.

Sipas parimit të barazisë, nuk do të bëhet asnjë ndryshim për sa i përket vëllimit, cilësisë dhe përparësive që qasjes së përfitimit të kujdesit shëndetësor ndërmjet të siguruarve aktivë, vetëkontribues dhe personave që gëzojnë mbulim si anëtarë të varur të familjes ose kontributit, e të cilëve për sigurimin shëndetësor do të paguhet nga shteti, qoftë si pjesëtar i një grupi që përjashtohet kategorikisht nga pagesa e kontributeve ose si person i identifikuar me një test të veçantë si në rrezik varfërie dhe vulnerabiliteti ekonomik, i cili gjithashtu do ta përjashtojë atë nga detyrimi për të paguar kontributet.

Arsyet e plotësimit-ndryshimit të politikës ekzistuese, Ligji aktual për sigurimet shëndetësore i vitit 2014 përbën kornizën aktuale ligjore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, çdo minutë që e humbim për këtë projektligj është e paarsyeshme.

Lirisht!

MINISTRI ARBEN VITIA: Ligji aktual për sigurimet shëndetësore i vitit 2014 përbën kornizën aktuale ligjore për reformën e parashikuar në sektorin e shëndetësisë. Mungesa e neneve të cilat e sqarojnë dhe mundësojnë funksionimin bazik të këtij ligji, prioriteti i ulët politik që i është dhënë reformës së financimit të shëndetësisë dhe mungesa e krijimit të një liste të gjatë të parakushteve të rëndësishme të domosdoshme për funksionimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore çuan në një vonesë, përkatësisht dështim thuajse të plotë të këtij ligji.

Prandaj, deputetë të nderuar, kërkoj që të votohet ky ligj.

KRYETARI: Deputetja Kollçaku, në emër të Komisionit.

FATMIRE KOLLÇAKU: Po, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Komisioni Funkcional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe me kënaqësi i fton deputetët që ta votojnë në parim.

KRYETARI: A keni nevojë si grup apo e hedhim në votim?

Ma ka kërkuar fjalën deputeti Meta për të diskutuar për këtë projektligj.

BURIM META: Faleminderit, kryetar!

Ministër,

Përgëzime për këtë ligj të jashtëzakonshëm e shumë të rëndësishëm. Me këtë ligj, natyrisht edhe Fondi i sigurimeve merr drejtimin dhe kahen e duhur për t'u implementuar. Shpresojmë sa më herët. Por, më duhet të them që ky projektligj ka të përcaktuar kategoritë e personave të cilët lirohen nga pagesa e sigurimit shëndetësor, të cilët disa nga ta i thatë, duke përfshirë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë, si invalidët e luftës dhe familjarët e tyre, viktimat e dhunës në familje gjatë vitit të parë të regjistrimit të tyre në Ministrinë përgjegjëse, personat përfitues të asistencës sociale etj.

Gjithsesi, Projektligji në fjalë ka përjashtuar nga mbulueshmëria e plotë e sigurimit të një kategorie jashtëzakonisht të ndjeshme të shoqërisë, siç janë viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës. Ata, ato sot kanë nevojë për ne. Ju po e shihni, është kërkesë edhe e KRCT-së, ka qenë kërkesë e jashtëzakonshme edhe e Presidentes së Republikës së Kosovës.

Për këtë fundvit, projektligji ka përcaktuar që pagesa e kontributit nuk do të realizohet me automatizëm si për kategoritë e caktuara më lart, por varësisht nga statusi i varfërisë së individit. D.m.th. këtë kategori ne njëherë po kërkojmë të varfërohet e më pastaj ta mbulojmë, siç është në nenin 9, pika 2.3 dhe pika 2.2 e këtij ligji. Duke njohur ndjeshmërinë e kësaj kategorie, njëherësh pasojat afatgjate të dhunës seksuale të përjetuara gjatë luftës në shëndetin fizik dhe mendor të viktimave në fjalë, gjatë shqyrtimit të mëtejshëm të këtij projektligji në Kuvend të kësaj kategorie, duhet t'i mundësohet siguri i plotë shëndetësor i financuar nga shteti.

Bazuar në këto që u thanë më lart, është thelbësore që pikat 2.3 e nenit 9 të Projektligjit të zhvendoset në nënparagrafin 2.8 të nenit 9 të këtij projektligji. Konkretisht, në kuadër të kategorive të personave të cilët lirohen nga pagesa e sigurimit shëndetësor.

Ministër, unë e di që e keni vullnetin edhe këtë e keni thënë, prandaj ju lutem përfshijeni këtë çështje këtu, përndryshe do të kemi vështirësi për ta marrë edhe votën tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjala e ministrit.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit i nderuar deputet Meta,

Ashtu edhe siç kemi biseduar, tashmë një temë e ndjeshme si kjo është adresuar dhe tashmë Qeveria veçse e ka përgatitur amendamentin dhe po kjo kategori kaq e ndjeshme do të jetë e mbuluar nga shteti. Dhe tash po besoj se në mbledhjen e Komisionit i cili do të paraqitet ky amendament, po shpresoj shumë që edhe anëtarët e nderuar të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do ta votojnë këtë amendament dhe do të procedojmë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Meta!

BURIM META: Faleminderit, ministër!

Të përgëzoj për këtë pranueshmëri jashtëzakonisht të nevojshme. Faleminderit!

KRYETARI: E hedhim në votim!

Bëhuni gati! Regjia, thashë bëhuni gati, nuk thashë votojmë.

Nuk thashë votojmë.

A jeni gati?

Nuk jemi gati. Një deputet mungon atje i mazhorancës. Tash është komplet mendoj grupi parlamentar.

Votojmë tash, regjia!

61 vota për, asnjë votë kundër, një votë abstenuese.

Konstatohet që Kuvendi përmes këtij votimi e miratoi Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor.

Kërkojmë nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme...

Urdhëro! E ka kërkuar fjalën Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes për një propozim.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj kryetar!

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 123 të Rregullores së Punës së Kuvendit, parashtroj këtë mocion procedural për shmangie nga afatet e përcaktuara. Në

nenin 76 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, propozoj në emër të grupit parlamentar që amendamentet për Projektligjit 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor mund t'i adresohen komisionit funksional deri në ora 13:25 të datës 5. 12. 2024. Komisioni Funksional deri në orën 13:35 të datës 5.12. duhet të shqyrtojë Projektligjit 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe raportin me rekomandime.

KRYETARI: Më fal, deputete, një ndërhyrje. Mos ishte propozimi i parë i juaj 15:00. Mos the 15:00, mos nuk the 13:00?

FATMIRE KOLLÇAKU: Jo, në fakt ne i kemi pasur disa afate, por tashmë janë tejkaluar me disa ndryshime të vogla kohore. E para që deri 13:25...

KRYETARI: Vazhdo!

FATMIRE KOLLÇAKU: Atëherë, i dyti 13:35. Dhe, vazhdojmë me komisionin e përhershëm deri në orën 13:40 të datës 5. 12. 2024 duhet të shqyrtojmë Projektligjin nr. 08/L-320 për sigurimin të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe raportin me rekomandime t'i paraqesin Komisionit Funksional.

Pastaj, Komisioni Funksional deri në orën 13:45 të datës 5. 12. 2024 të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin nr. 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, për shqyrtim të dytë në seancë plenare, si dhe që shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor të bëhet në seance plenare të datës 5. 12. 2024 nga ora 13:50.

A ka nevojë ta lexoj arsyetimin? OK! Atëherë, propozoj që të miratohet ky propozim për këtë mocion procedural.

KRYETARI: E hedhim në votim. Ky është mocion për shmangie. Uluni! Përgatituni për votim. Votojmë tash, regjia! 62 deputetë votuan. Të gjitha votat për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që miratohen këto afate të trajtimit të projektligjit.

17. Shqyrtimi i parë Projektligjit nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funksional për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj. Na e ka rekomanduar miratimin e tij. Këtu e kemi ministren e Drejtësisë, Haxhiu.

Albulena Haxhiu e paraqet dhe e arsyeton para Kuvendit projektligjin.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Ministër Vitia,

Ministër Krasniqi,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të dashur qytetarë,

Sot po prezantoj edhe një herë Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin, Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar, tashmë me ndryshimet e adresuara sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Për të sqaruar, Qeveria nuk ka përpiluar një projektligj të ri, por vetëm janë adresuar në mënyrë specifike çështjet që Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dhe, këto ndryshime janë përfshirë në pjesë të caktuara të katër neneve bazuar, siç thashë, në konstatimet e gjykatës. Fillimisht, duhet theksuar se një ndër çështjet më të rëndësishme është konfirmimi i kushtetutshmërisë së konfiskimit civil, si një instrument legjitim dhe proporcional për luftën kundër korrupsionit në sektorin publik. Pra, një arritje e madhe e shtetit të së drejtës.

Çështjet kryesore të adresuara përfshinë retroaktivitetin e ligjit. Pastaj nevojën për qartësi në lidhje me periudhat kohore brenda të cilave Byroja Shtetërore mund të verifikojë pasurinë e fituar kundërligjshëm. Por, gjithashtu përfshinë edhe përbërjen e komisionit mbikëqyrës në dritën e garantimit dhe të respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve.

Sa i përket çështjes së retroaktivitetit të ligjit, si një nga një çështjet kryesore të kësaj nisme, Gjykata Kushtetuese nuk e ka refuzuar parimisht retroaktivitetin, por ka theksuar se ai duhet të zbatohet me kujdes, duke respektuar parimin e proporcionalitetit.

Në këtë drejtim, në linjë me konstatimet e gjykatës, në projektligj është përfshirë koncepti i pamundësisë objektive të normuara përmes nenit 35 të këtij projektligji.

Çështje tjetër është ajo që ndërlidhet me periudhat kohore brenda të cilave Byroja Shtetërore mund të verifikojë pasurinë e fituar, dhe është adresuar periudha e verifikimit. Pra, që do të lidhet ekskluzivisht me periudhën kur zyrtari publik ka qenë në funksion. Përfundimisht, verifikimi mund të zgjatet deri në 5 vjet pas përfundimit të detyrës publike nëse ka prova të dukshme që pasuria është më e madhe sesa të ardhurat e ligjshme.

Këto ndryshime janë adresuar përmes neneve 2, 19 dhe 23 të projektligjit. Ndërsa, iniciimi i procedurës së verifikimit të pasurisë së pajustificueshme mund të bëhet gjatë kohës kur personi zyrtar është ende në funksion, ose më së voni deri në 10 vjet pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik nga ai person.

Ndërsa sa i përket komisionit mbikëqyrës dhe adresimit në përputhje me konstatimet e gjykatës, në versionin e ri të projektligjit, komisioni do të përbëhet nga 3 anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe në këtë drejtim drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe drejtori i Njësitit të Inteligjencës Financiare. Për këtë qëllim është ndryshuar neni 10 që rregullon përbërjen e komisionit mbikëqyrës dhe është shtuar një nen i ri, neni 11, i cili e rregullon mënyrën e përzgjedhjes së 3 anëtarëve të komisionit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky projektligj, unë ju ftoj që sot ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Po ia japim fjalën fillimisht komisionit. Ia japim fjalën komisionit, kryetarit Rustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 74, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25. 9. 2024 e shqyrtoi në parim Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Komisioni konstaton se i plotëson kushtet për t'u shqyrtuar dhe për t'u miratuar në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Grupet parlamentare. Vetëvendosja në rregull është. LDK-ja? Driton Selmanajn e kemi këtu, deputetin, i cili në emër të grupit dëshiron ta thotë qëndrimin e tij. Urdhëroni, zoti Selmanaj! Regjia, në foltore, ju lutem!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju e dini që LDK-ja edhe në rastin paraprak e ka dhënë votën pro themelimit të Byrosë, paçka që ne kishim dilemat tona për frymën e kushtetutshmërisë së atij dokumenti.

E kishim edhe një rekomandim të Komisionit të Venecias, por për fatin e keq Gjykata Kushtetuese vlerësoi që nuk janë adresuar të gjitha çështjet për të ruajtur sistemin kushtetues dhe institucional që kemi ndërtuar në Kosovë.

Tani ne kemi një draft tjetër dhe e kemi lexuar me kujdes. Dhe, themi përsëri që ky dokument është me elemente kundër kushtetuese. Pse? Mendojmë në tri çështje kryesore. E para ka të bëjë me drejtorin e këtij institucioni, këtij mekanizmi. Përkundër që Komisioni i Venecias ka thënë që është mirë të mendohet për një udhëheqje kolegjiale, jo nga një person i vetëm, megjithatë, Qeveria insiston përsëri që të jetë një person i vetëm.

Por, ku e kemi dilemën tonë kushtetuese. Neni 16, paragrafi 16 thotë kështu, domethënë, vijnë kandidaturat këtu në Kuvend, dhe nëse eventualisht dështon herën e parë, atëherë shpallet konkursi për herën e dytë. Por, çka ndodh në herën e tretë? Në herën e tretë thotë kështu: “Në rast se dhe pas përsëritjes së konkursit, Kuvendi dështon në zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm në dy raunde, atëherë komisioni shpall konkursin dhe zhvillon procedurat sipas këtij neni, me përjashtimin e vetëm se komisioni në fund të procesit e zgjedh kandidatin me më së shumti pikë si drejtor të përgjithshëm”.

Çka i bie? Suprimohet roli i Kuvendit. Domethënë, nëse Kuvendi nuk arrin ta zgjedhë drejtorin e Byrosë, atëherë komisioni atje, e zgjedh vetë. Domethënë, ky është atak kushtetues ndaj rolit të Kuvendit të Kosovës. Domethënë, nëse nuk arrini ju deputetë ose deputetët e shumicës që ta zgjidhni drejtorin, përkundër që edhe për këtë kemi dilema, sepse duhet me shumicë të thjeshtë të zgjidhet drejtori, atëherë i dërgohet e drejta një institucioni krejtësisht tjetër që është komisioni mbikëqyrës atje.

Tani unë ju flas për elementin e dytë që mendojmë që e cenon rëndë pavarësinë e këtij institucioni. Është përbërja e ekipit mbikëqyrës. Kush e përbën komisionin mbikëqyrës? 3 anëtarë që i zgjedh Kuvendi. Që i zgjedh shumica e thjeshtë parlamentare në Kuvend të Kosovës.

Që i bie në rastin konkret, Lëvizja Vetëvendosje dhe lista Guxo. Nesër nuk e di kush. Në rastin konkret Lëvizja Vetëvendosje dhe lista Guxo.

Anëtari i katërt është drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit që po ashtu e zgjedh Kuvendi me shumicë të thjeshtë të votave. Që i bie edhe drejtorin që e ka zgjedh shumica e thjeshtë, është anëtar në komisionin mbikëqyrës. Dhe, anëtar i fundit është drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare, që e zgjedh Qeveria, kryeministri.

Domethënë, 3 anëtarë i zgjedh Kuvendi. Drejtorin e agjencisë po ashtu e zgjedh Kuvendi me shumicë të thjeshtë, dhe shefin e Agjencisë së Inteligjencës Financiare që e zgjedh kryeministri, këta e zgjedhin me emërim atje drejtorin nëse Kuvendi dështon.

Të më besoni, është deformim serioz, substancial i sistemit institucional kushtetues që e kemi ndërtuar në Kosovë. Kjo i bie që një parti politike që do t'i fitojë zgjedhjet nesër e kurdoherë, këtë institucion me lehtësinë më të madhe e kthen në instrument krejtësisht të persekutimit të kundërshtarëve politikë. Kjo nuk iu duhet as juve dhe nuk i duhet vendit.

Por, duhet të bëjmë çmos që vërtet këtë ta ndalojmë. E fundit ka të bëjë me dispozitat kalimtare. Shihni çka thotë këtu, thotë: “ Deri në funksionalizimin e Byrosë, funksionin administrativ të Byrosë e ushtron Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, së cilës i ndahen mjete buxhetore shtesë për kryerjen e këtij funksioni.

Merreni mend, po e miratoni një ligj që do ta themeloni një Byro, por derisa të krijohet kjo, do t'ia jepni disa para shtesë Agjencisë për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për luftimin e korrupsionit, që ata ta kryejnë funksionin e këtij institucioni. Veprim krejtësisht i kundërligjshëm, në kolizion mes ligjeve.

Prandaj, unë po ju them në emër të LDK-së; kjo nuk është qasja. Përkundër, po e përsëris, që LDK-ja e ka mbështetur idenë që Instituti i konfiskimit civil në Kosovë të aplikohet, sepse jemi të vetëdijshëm dhe jemi të bindur për këtë që ka pasur në faza të ndryshme, përfshirë edhe këtë fazë abuzim me paranë publike. Por, asnjëherë, unë mendoj që nuk askush të lejojë që për kinse qëllime të mëdha për vendin, ta deformatojmë substancialisht funksionimin kushtetues dhe ligjor të institucioneve.

Po e them, ju lutem, në emër të LDK-së, të mos ia delegoni, të mos ia suprimoni kompetencat Kuvendit në asnjë rast, sepse ka një përpjekje për të thënë që, po kështu ka qenë edhe në draftin e parë.

Por, po ju them kështu, Gjykata Kushtetuese i ka trajtuar vetëm çështjet që janë ngritur nga parashtruesi i kërkesës, jo të gjitha dispozitat e ligjit. Zakonisht kompetencë e Gjykatës Kushtetuese janë çështjet që ngritën. Nuk trajtohet ligji në tërësi, por çështjet që ngritën. Dhe, për çështjet e ngritura, ata kanë dhënë vlerësim dhe në fund e kanë shpallë kundër kushtetues gjithë ligjin.

Unë jam i bindur që tash kur të dërgohet në Gjykatë Kushtetuese çështja e suprimimit të mandatit kushtetues të Kuvendit, ku një komision e zgjedh drejtorin me kompetenca të mëdha që ka për ndjekjen e njerëzve me dyshime eventuale për abuzim me paranë publike, është tërësisht jokushtetues. Fundamentalisht kundër kushtetues dhe shumë i rrezikshëm për vendin.

Prandaj, unë mendoj që ndoshta është mirë, zoti kryetar, siç kemi vepruar herën e parë, ta referoni në Komisionin e Venecias edhe një herë. Dhe, Komisioni i Venecias meqenëse e ka trajtuar këtë temë, mund të kthejë përgjigje shumë shpejt, dhe ju t'i adresoni këto, dhe më pas shteti ynë ta ketë të rregulluar edhe Institutin e Konfiskimit Civil si instrument që për herë të parë mund të ndodh në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Që dy vjet mbetëm me këtë projektligj. Ministrja Haxhiu e ka fjalën.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Lidhur me Ligjin për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Tashmë, siç e përmendi edhe kryetari i Kuvendit, po diskutojmë, po debatojmë, po argumentojmë për vite me radhë, që dy vjet.

Madje, shumë vite më herët, sepse edhe si opozitës, siç e kam thënë, ne e kemi propozuar këtë ligj në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Por, situata është e qartë; LDK-ja dhe e gjithë opozita nuk e do konceptin e konfiskimit civil. Kjo është e vërteta. Çdo gjë tjetër që thuhet në këtë foltore është vetëm një fasadë në të cilën unë fare nuk kam interes që të merrem sot.

Ju na lutët që të mos e votojmë. Gjegjësisht, i bëtë thirrje dhe lutje Kuvendit që të mos e votojmë këtë ligj. Ndërsa, unë në emër të Qeverisë, po ju lutem si deputetë meqë vetëm ju nga LDK-ja jeni këtu, që ta votoni këtë projektligj dhe ta çlirojmë Kosovën nga të korrumpuarit dhe nga ana të cilët kanë abuzuar me detyrën zyrtare, dhe nga ata të cilët kanë krijuar pasuri të pajustificueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Kemi replikë, apo zoti Selmanaj?

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë prita që replika të jetë, ose diskutimi i ministres në kuptimin profesional, por po e shoh që për fatin e keq po ju them, kolegë deputetë, jemi në fund të mandatit, por padituria është këmbëkryq në Ministrinë e Drejtësisë.

Nuk kanë argumente profesionale për t'i diskutuar. Unë prita për argumente profesionale. Dhe, çfarë thotë? LDK-ja, thotë, është e pa interesuar që të vendoset ky institutit në Kosovës, Institutin e Konfiskimit Civil. Po, ia kemi dhënë votën dy herë, edhe në leximin e parë edhe në leximin dytë.

Por, çka kemi thënë, reflektoni. Dhe, kundër kushtetutshmëria më pas nga Gjykata Kushtetuese na ka dhënë të drejtë neve, përkundër që e kemi votuar.

Dhe, çka po nxjerr përfundimi? Përfundimi po nxjerr kështu; o nuk dinë të lexojnë dhe të kuptojnë se çka ka thënë Komisioni i Venecias dhe Gjykata Kushtetuese, ose në të vërtetë nuk e doni reformën në Kosovë, por e keni për çështje elektorale. Ose, krejt në fund, e keni qëllimshëm ta demoloni sistemin kushtetues dhe institucional në Kosovë.

LDK-ja e ka pjesë të programit të saj dhe është për, për, për, po e them për të disatën herë që konfiskimi civil si institut juridik të aplikohet në Kosovë. Por, në këtë formë se si është menduar që Kuvendi të suprimohet nga zgjedhja e drejtorit, merreni me mend. Domethënë, ai komision atje mund ta vendos një person të një partie politike kurdo për të të udhëhequr dhe për të iniciuar procese për konfiskim të pasurisë së njerëzve, të më besoni që është deformim substancial i vetë ekzistencës së këtij sistemi kushtetues që e kemi ndërtuar.

Unë po ju them, nesër mund të mos jeni ju fare në pushtet. Mund të vijë dikush tjetër. Merreni me mend çfarë instrumenti po i jepni në duar dikujt për t'ju ndjekur juve. Ky është i rrezikshëm për vendin si sistem. Duhet të vendosim sistem të konfiskimit civil. Po. Por, në bazë të praktikave ndërkombëtare. Po më vjen, në aspektin profesional, unë nuk mund të diskutoj me këtë ministër.

KRYETARI: A ka të tjerë të paraqitur? E hedhim në votim këtë. Uluni! Votojmë tash. 60 vota për, asnjë kundër, 1 votë abstenuese. Kështu që, konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

A keni ndonjë propozim? Urdhëro, kryetari i komisionit! Në emër të mazhorancës kësaj radhe a? Grupi Parlamentar i VV-së.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Në përputhje me nenin 123 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, parashtrojmë këtë mocion procedural për shmangie nga afatet të përcaktuar me nenin 76, që Projektligji nr.08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, propozojmë të shqyrtohet në këtë afat:

Amendamentet për Projektligjin për Byronë të dërgon deri në orën 13:45. Komisioni Funkcional të trajtojë amendamentet deri në orën 13:50. Komisionet e përhershme të trajtojnë projektligjin dhe raportin me amendamente deri në 13:55. Dhe, Komisioni Funkcional të trajtojë raportin me amendamente deri në orën 14:00, dhe t'i rekomandojë seancës për shqyrtim të dytë në 14:10.

KRYETARI: Këto janë afatet që na i ka kërkuar për shqyrtim në këtë projektligj. Mirëpo, kjo kërkohet me 2/3. Uluni! Është shmangie nga Rregullorja për trajtim më të shpejtë të këtyre projektligjeve. Përgatituni për votim. Votojmë tash për shmangie.

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Miratohet kjo. Kjo është për sa i përket trajtimit të projektligjit.

Tash dalin në pikën e radhës:

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-316 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Çështje të Sigurisë, neve na e ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji. Por, ministri Maqedonci e ka deleguar këtë përgjegjësi te ministrja e Drejtësisë, Haxhiu. E ftojmë ministren Haxhiu që ta prezantojë këtë Projektligj të FSK-së.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Me autorizimin e ministrit Maqedonci po e bëj këtë paraqitje. Pra, më lejoni që në emër të Ministrisë së Mbrojtjes si Propozues të këtij Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-036 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Pra, duke marrë për bazë misionin aktual të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe procesin e zhvillimit të FSK-së në forcë që është e gatshme për pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare, si dhe rritja e interesimit për bashkëpunim me vendet mike, është e nevojshme që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit sipas propozimit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky projektligj është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, por po ashtu edhe me legjislacionin në fuqi.

Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e tij, ju ftoj për miratim.

KRYETARI: E do fjalën dikush nga komisioni apo jo? Zoti Dugolli, ta hedhim në votim a po? Mirë. Uluni! Bëhuni gati për të votuar. Pra, përmes këtij ligji ndryshohet Ligji paraprak për dërgimin e FSK-së jashtë vendit. Uluni! Përgatituni për votim. Votojmë tash!

62 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatohet që Kuvendi e miraton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dërgimin e FSK-së jashtë vendit. Pastaj komisionet i trajtojnë të gjitha dhe na e sjellin me kohë edhe shqyrtimin e dytë të këtij projektligji.

Para se kalojmë në fazën e trajtimit të afateve që e keni kërkuar nga komisionit, e trajtojmë edhe këtë dhe e ndërpresim seancën këtu.

19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Ministrin Murati nuk e kemi këtu, por e ka autorizuar ministrin Krasniqi që ta paraqesë këtë projektligj para neve këtu në Kuvend. Urdhëroni, ministër!

MINISTRI ELBERT KRASNIQI: I nderuar kryetar,

Të nderur deputetë,

Sot, para jush prezantoj Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, përmes së cilit synojmë forcimin e integritetit dhe transparencës së praktikave tona financiare, duke i ofruar ato më ngushtë me standardet ndërkombëtare.

Projektligji i riformuluar, emërtimin e shoqatave joprofesionale të kontabilitetit dhe të auditimit, si dhe entitetet jo fitim prurëse joqeveritare që zbatojnë standardet e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Kjo siguron që praktikat tona kombëtare të përmbushin pritshmëritë globale, duke rritur besimin si në nivelin kombëtar, ashtu edhe atë ndërkombëtar. Andaj, duke e pasur parasysh nevojat dhe rëndësinë e këtyre ndryshimeve, ju ftoj që ta mbështesni këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Komisioni a ka nevojë të sqarohet. Raporti i komisionit. Zoti Muja e ka fjalën.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Komisioni për Buxhet e ka trajtuar këtë projektligj dhe të njëjtit i ka dhënë mbështetje. Gjithashtu, edhe në emër të grupit parlamentar e mbështesim këtë projektligj.

KRYETARI: Përgatituni për votim. E votojmë edhe Projektligjin për kontabilitet. Projektligji i kontabilitetit, i raportimit financiar dhe i auditimit. Uluni! Përgatituni për votim. Votojmë tash!

62 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. I ngarkojmë komisionet. Edhe për këtë me shmangie. Pse kjo?

Urdhëro!

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar,

Është një grup, një pako e ligjeve sa i përket anëtarësimit në SEP-a dhe për shkak të prioritizimit na duhet.

KRYETARI: Ok!

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar!

Unë dëshiroj të propozoj një mocion që amendamentet për Projektligjin nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim duhet t'i paraqiten Komisionit Funksional deri në orën 13:50. Më fal! Deri në orën 13:45.

Komisioni Funksional deri në orën 13:45 duhet t'i shqyrtojë projektligjet.

KRYETARI: Nëse mund të thoni ndonjë afat tjetër, sepse ora është 13:50 tash.

ARMEND MUJA: Një moment! Më lejo ta korrigjoj.

KRYETARI: Mund të fillosh veç prej orës 13:55 për t'i trajtuar.

ARMEND MUJA: Amendamentet për projektligjin në fjalë duhet të vijnë deri në orën 13:55. Komisioni Funksional deri në orën 13:56 duhet ta trajtojë të njëjtin. Pastaj komisionet e përhershme deri në orën 13:57, po ashtu t'i paraqesin raportet, dhe Komisioni Funksional për Buxhet deri në orën 13:58 të njëjtin do ta përmbyllë dhe do t'ia dërgojë Kuvendit.

Shqyrtimi i dytë duhet të bëhet në seancën para orës 14:00. Pra, 13:59. Këto janë afatet e disponueshme. E kam parasysh kufizimin logjistik. Faleminderit!

KRYETARI: Mua një minutë një gotë ujë më nevojitet për ta pirë, e ju po mbani mbledhje të komisioneve. Ku mundesh ashtu?! Jo, se deri në orën 14:10 e morët kohën me këtë komisionin tjetër, kështu që lirisht shfrytëzoheni atë kohë.

Bëjeni një propozim tjetër me tjetër orar, 14:10, 14:15. Se mos po ju mbetet uji në fyt, se nuk e kam për diçka tjetër! Urdhëro!

ARMEND MUJA: Kryetar, ora 13:55 duhet t'i pranojmë amendamentet. Në orën 14:00, Komisioni Funksional duhet ta shqyrtojë raportin. Në orën 14:10 komisionet e përhershme, po ashtu duhet ta dorëzojnë raportin te Komisioni Funksional.

Komisioni Funksional i përhershëm deri në orën 14:40 do ta trajtojë raportin 14:30, ndjesë! Dhe, në orën 14:40 duhet ta trajtojë seanca këtë projektligj. Këto janë afatet e disponueshme. S'kemi të tjera.

KRYETARI: E hedhim në votim. Bëhuni gati! Votojmë tash shmangien. Nuk kemi kuorum. Nuk kemi kuorum për të marrë vendim. Kthehuni! Deputetja Balje nuk ka votuar.

Nëse doni ta shfrytëzoni të drejtën e votimit, e shfrytëzojmë tash. Votojmë tash. 63 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Miratohet shmangia. Tash i lus komisionet që mblidhen më shpejt e t'i trajtojnë këto që i ka në caktuar vetë.

Besoj që për 30 minuta i përfundoni të gjitha dhe shihemi. Faleminderit!

* * *

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë